PËRMBAJTJA


5 Tensionohet gjendja në R.M.



12 Procesi gjyqësor ndaj Albin Kurtit...


20 Intervistë me Justina Shiroka


23 Roli i shoqërisë civile në mirë...


37 Kulturë

Portreti i muajit: Kotraversi 2
Dr. Milazim Krasniqi: Rrugët e ndara shtetërore, korridoret e bashkuara panevropiane 3-4
Mr. Milazim Mustafa: Tensionohet gjendja në Republikën e Maqedonisë 5-7
Avni Avdiu: Bunkerët dhe çadrat 8-9
Muhamet Jahiri: Institucionet vendore nuk i njohin zgjedhjet serbe në Kosovë 10-11
Qendresa Mustafa: Procesi gjyqësor ndaj Albin Kurtit si seri televizive 12
Astrit Veliqi: 'Pluhuri i bardhë' që vret në heshtje rininë kosovare! 13-14
Fatos Shala: Trafikimi i qenieve njerëzore – në rritje 14-15
Shkelzen Nuza: Paqja Studentore ngadhënjen në zgjedhjet studentore 16
Drita Vitia: Ideali për studim 17-19
Intervistë me ministren e Energjisë dhe Minierave, Justina Shiroka – Pula 20-22
Iljasa Salihu: Roli i shoqërisë civile në mirëqenien e qytetarëve 23-25
Mr. Muhamed J. Kajolli: Arbitrazhi 26-28
Arsim Jonuzi: Një zonë e harruar edhe nga lajmet 28-29
Dr. Jusuf el Kardavi: Parimet e dialogut dhe afrimi ndërmjet rrymave islame 29
Emine A. Vezaj: Gruaja muslimane – shqiptare dhe kontakti i saj me Kur'anin 30-32
Hekuran Avdyli: Ministria e Arsimit nuk i njeh ligjet për të drejtat e njeriut 33
Agim Avdiu: Vullkanet më rrezik se tërmetet 34-35
Imer Topanica: Kurorëzimi i një artisteje 36
Flamur Maloku: Lajme nga kultura 37
Alban Bilalli: "Afrika e Jugut 2010" 38-39
Vëllezërit me profesion dhe besim të njëjtë 39
Fjalëkryqi 40



REVISTË MUJORE PËR AKTUALITET, KULTURË, ARSIM, ETIKË
Viti V / Nr. 42
19 maj 2010 - 19 qershor 2010
Botues
Zëri Ynë
O.J.Q. "Zëri Ynë"

Drejtor
Muhamed Jusufi - KAJOLLI
kajolli5@hotmail.com

Redaktor përgjegjës
Avni AVDIU
avni.avdiu@gmail.com

Redaktor i kulturës
Flamur MALOKU
flamurmaloku@hotmail.com

Redaktor teknik/Grafika
Osman D. GASHI
osmangashi@msn.com

Redaktore gjuhësore
Mimoza SINANI

e-mail:
revistapaqja@gmail.com
revistapaqja@hotmail.com
http://www.zeri-yne.org

Adresa:
Rr. Xhavit Mitrovica, nr. 14, përballë teatrit Dodona, Prishtinë, Kosovë

Njoftojmë bashkëpunëtorët se do të merren në konsiderim për botim vetëm ato shkrime që arrijnë në redaksi deri me datën 8 të muajit!

Portreti i muajit

Kontraversi

I pakënaqur me zgjedhjet e fundit parlamentare në Shqipëri, por edhe i revoltuar tej mase nga koalicioni i Sali Berishës me Ilir Metën, kryetari socialist Edi Rama vendosi të kundërshtojë rezultatin e zgjedhjeve me të gjitha mënyrat. Pasi i neutralizoi kundërshtarët e tij politikë brendapartiakë (Blushi, Malaj etj), sërish u rizgjodh në kongres si kryetar partie, ndonëse moralisht do të duhej të jepte dorëheqje për shkak të humbjes. Megjithatë, ai nuk e pranoi humbjen dhe vazhdon t'i mbajë peng socialistët me premtimin se do të vijnë në pushtet duke i përdorur të gjitha metodat. Meqë bojkoti nuk i solli rezultatet e dëshiruara, vendosi me protesta dhe pas tyre edhe me organizimin e grevës së urisë, duke bllokuar bulevardin që nga 30 prilli. Punimet në sheshin Skënderbej dhe, së fundmi, bllokimi i bulevardit "Dëshmorët e Kombit" nga greva e urisë së deputetëve socialistë, e kanë rënduar gjendjen në kryeqytet dhe kanë shkaktuar një ngërç politik të pashembullt. Rama vetë nuk është futur në grevë, por ka instrumentalizuar disa përkrahës të flaktë të tij. I gjithë ky presion i pashembullt i tij ndodh në momentet kyçe për Shqipërinë, duke penguar proceset integruese të vendit dhe duke e vënë në pikëpyetje edhe procesin e liberalizimit të vizave që është parashikuar të ndodhë gjatë kësaj vere.

Rreth personalitetit të tij kanë folur edhe disa figura të shquara publike. Kur është vënë në Ministrinë e Kulturës, Dritëro Agolli pat deklaruar: "Ky çoban do e shkatërrojë fare kulturën shqiptare". Një nga analistët më të shquar shqiptar, Fatos Lubonja, në një diskutim publik me këtë njeri, midis të tjerash i tha: "Ti je psikopat, sa kohë ke pa i pirë ilaçet?" ■

BIOGRAFIA: **Edi Rama** lindi më 4 korrik 1964. Është piktor, basketbollist, politikan, kryetar i Bashkisë së Tiranës dhe kryetar i Partisë Socialiste të Shqipërisë. Bir i artistit Kristaq Rama, ish-spiun komunist, i njohur për linçime dhe likuidime politike. Edi Rama ka kryer liceun artistik (shkollë e mesme) dhe studimet në Institutin e Arteve për pikturë. Më 12 shkurt 1991 u nda nga artistja Matilda Makoçi, me të cilën ka djalin Gregorin. Sipas medieve, Rama në gjykatë, pas ndarjes ka refuzuar të paguajë për ushqimin e të birit. Ka të publikuara në media dhe internet disa foto skandaloze ku shihet lakuriq në plazhet nudiste, duke folur me një të mitur. Më 2003 u bë publike lidhja e tij me prezantuesen e njohur Rudina Magjistari. Mbas katër vitesh, lidhja e tyre merr fund. Mediat shqiptare kanë pohuar se pamundësia e tij për t'i mbajtur lidhjet bashkëshortore rrjedh nga karakteri i tij kontraverz. Prej vitit 2000 Edi Rama udhëheq Bashkinë e Tiranës.







Dr. Milazim KRASNIQI

Rrugët e ndara shtetërore, korridoret e bashkuara panevropiane

Luftërat në ish-Jugosllavi kanë pasur nevojë për një proces të ngjashëm si ai i Nurembergut, ku do të adresohej qartë fajësia për agresion dhe ku fajtorët do të dënoheshin me dënim kapital. Ashtu do të hapej procesi i denacifikimit të Serbisë, me çka Serbia do të pushonte së qeni në të ardhmen rrezik potencial për fqinjët e vet, veçmas për shqiptarët e Kosovës, po edhe për boshnjakët



Kosova para disa ditësh filloi ndërtimin e autostradës Morinë -Merdar, e cila e bashkuar me autostradën e Shqipërisë Durrës- Morinë, e lidh Kosovën me korridorin VIII, i cili krijon lidhje të reja me Italinë dhe me Europën. Kjo arritje u bë e mundur falë pavarësisë së Kosovës, çka tregon se ndryshimi në Kosovë është i qartë në aspektin e orientimit të saj strategjik për integrim me Shqipërinë dhe për dalje më të shpejtë në Europë. Pra, ndryshimi i madh 20 vjet pas eskalimit të krizës në ish-federatën jugosllave, është se më rruga e Kosovës për në Europë nuk i bie nëpër Beograd as gjeografikisht. Kulturalisht nuk i ka rënë kurrë, ndërsa politikisht një kohë i ka rënë andej, por me dhunë.

Rruga e Kosovës për në Beograd dhe prej Beogradi drejt Europës, vërtet gjithmonë ka qenë e dhunshme dhe e panatyrshme. Kurrë nuk ka ekzistuar vullneti i popullit shumicë të Kosovës për jetë të përbashkët në një shtet serb e as jugosllav.

Në fakt, as te vetë popujt sllavë, sllovenët, kroatët e boshnjakët, kurrë nuk ka ekzistuar një shtresë e identitetit jugosllav, e cila do të ngjiste për jetë të përbashkët të vullnetshme, në një strukturë shtetërore të quajtur Mbretëria SKS, përkatësisht Jugosllavi. E aq më pak Serbi e Madhe. Prandaj, në momentin kur u vërejtën shenjat e para të dobësimit të shtetit totalitar jugosllav, shpërtheu kriza, sepse të gjithë synuan të iknin nga përqafimi i hekurt serb, i ambalazhuar si përqafim "vëllazëror" jugosllav.

Pra, mungesa e një shtrese të qartë të identitetit jugosllav gjithsesi do të përfundonte me ndarje. Por, ndarja do të mund të ishte paqësore si ajo në Çekosllovaki, e pjesërisht edhe në BRSS, po të mos dominonte në Serbi politika nacionalsocialiste e Millosheviqit.

Fatkeqësisht, ajo politikë e diktoi mënyrën e ndarjes, duke e bërë atë ndarje të përgjakshme dhe duke mbjellë farën e urrejtjes edhe për gjeneratat që vijnë. Dhe duke i ndarë rrugë shtetërore për jetë të jetëve.

Edhe Serbia, nga ana e vet, po e ndërton korridorin 10 dhe ashtu po bëhet e rëndësishme në dy korridore paneuropiane, atë të 9 dhe 10, të cilat e lidhin Europën me Lindjen. Pra edhe Serbia po e gjen veten në një ndryshim të madh strategjik, duke hequr dorë duket përfundimisht nga iluzionet e marra për konfederatë me Bjellorusinë.

Por, ky ndryshim në Serbi ende nuk është krejtësisht i pazbythshëm. E ardhmja europiane e Serbisë ende mbetet e rrezikuar seriozisht nga retorika politike e tipit të asaj që ka ministri i jashtëm serb, Vuk Jeremiq dhe shumica e elitës politike e intelektuale serbe, që thonë se nëse Serbia duhet të zgjedhë ndërmjet Europës dhe Kosovës, do të zgjedhë Kosovën. Ndërsa, nëse zgjedhin Kosovën, është e sigurt se do të mbesin edhe pa Europën e natyrisht edhe pa Kosovën.

Megjithatë, ndryshime kulturore



ka edhe në Serbi. Kënga "Kush thotë kush gënjen se Serbia është e vogël", tash këndohet më rrallë. Edhe kur këndohet, këndohet pa emocione të forta, sepse Serbia tash vërtet është e vogël se para njëzet vjetëve dhe është humbëse e tri luftërave vetëm në vitet 90.

Fatkeqësisht, ndryshimi politik në Serbi nuk është i plotë dhe nuk do të jetë asnjëherë i plotë, por kësaj here jo për fajin e Serbisë, por të komunitetit ndërkombëtar. Pse?

Tribunali i Hagës nuk arriti ta adresojë fajësinë e agresorit të luftërave në ish-Jugosllavi. Përkundrazi, bëri njëfarë barazimi të fajeve, me çka e ka të hapur mundësinë e manipulimeve edhe në të ardhmen. Vetë fakti që Kroacia dhe Serbia e kanë lënë të hapur mundësinë që me marrëveshje të ndërsjellë të tërheqin akuzat nga Gjykata e Drejtësisë, tregon se drejtësia nuk ia ka dhënë satiskafsionin të vërtetës. Po ashtu, fakti që Kosova nuk e ka paditur Serbinë për gjenocid, tregon se çmimi që është paguar për pavarësinë e sponsorizuar nga komuniteti ndërkombëtar, është shumë më i shtrenjtë se sa duket në shikim të parë, sepse në këtë çmim kalkulohet edhe mbyllja e gojës për spastrimin etnik dhe gjenocidin që ka bërë Serbia në vitet 1998/1999.

Luftërat në ish-Jugosllavi kanë pasur nevojë për një proces të ngjashëm si ai i Nurembergut, ku do të adresohej qartë fajësia për agresion dhe ku fajtorët do të dënoheshin me dënim kapital. Ashtu do të hapej procesi i denacifikimit të Serbisë, me çka Serbia do të pushonte së qeni në të ardhmen rrezik potencial për fqinjët e vet, veçmas për shqiptarët e Kosovës, po edhe për boshnjakët.

Në fakt, sot 20 vjet pas, Serbia është rrezik direkt për shqiptarët e Kosovës dhe boshnjakët e Bosnjës dhe kjo gjë evitohet vetëm falë pranisë ushtarake dhe civile ndërkombëtare në këto dy vende. Dhe veçmas në Kosovë. Kosova sot është e pasigurt nga agresioni serb, po aq sa në vitet 1989/1990, kur tanket serbe ndihmuan në ndryshimin e Kushtetutës së Kosovës dhe në instalimin e pushtetit kukull të Millosheviqit. Pra, në raportet Kosovë- Serbi ndryshime janë imponuar nga jashtë, me intervenimin ushtarak të NATO-s në vitin 1999 dhe me prezencën ndërkombëtare në gjithë këto vite, e jo me evoluimin e marrëdhënieve në mes të dy vendeve.

Serbia, edhe pas njëzet vjetëve të eskalimit të konflikteve në ish-Jugosllavi, po e mban peng të ardhmen e Kosovës, me mospranimin e shtetit të ri, me pengimin e njohjes ndërkombëtare dhe me intervenimin në territorin e Kosovës, me anën e strukturave të veta parashtetërore. Por, në këtë mënyrë Serbia po e mban peng edhe veten, sepse Kosova gjithmonë ka pasur dhe ka potenciale të mjaftueshme për ta mbajtur peng Serbinë në të kaluarën e errët të saj.

Ashtu si u shkaktua ftohja dhe mandej konflikti i Serbisë me republikat e ish-Jugollavisë në vitet 1989/1990 për shkak të Kosovës, po ashtu u shkaktua ftohja dhe mandej konflikti i Serbisë edhe me bashkësinë ndërkombëtare në vitet 1998/1999. Prandaj, zgjidhja e vetme për të ardhmen është ndërtimi i rrugëve të ndara shtetërore dhe bashkimi i korridoreve paneuropiane 8, 9 e 10, që të shpien të gjitha në Europë, sado që nga anë të ndryshme. Në të vërtetë, shtrati ballkanik nuk mjafton as për pajtim e as për zhvillim. Mes kombeve ballkanike nuk ekziston solidaritet. Por, nuk as ndonjë shtresë të përbashkët të identitetit as historik, as kulturor as fetar e as politik. Prandaj, bashkëpunimi dhe integrimi duhet të synohet në një kontekst më të gjerë, në atë europian, atje ku pretendimet e mëdha të kombeve të vogla marrin përgjigje adekuate.

Kriza e fundit e Greqisë është ilustruese për këtë gjë. Një shtet që në Ballkan luan rolin e njëfarë xhandari, duke penguar integrimin e Maqedonisë, duke i bërë shantazh herë pas here Shqipërisë e duke denoncuar Turqinë, në kontekstin europian është shndërruar në një lypsar. Pra, korridoret paneuropiane janë përgjigje ndaj armiqësive të sedimentuara të këtyre dy fqinjëve ballkanikë, Kosovës dhe Serbisë. E shtrirë në më shumë se 4 milionë e gjysmë km² dhe me rreth 500.000 milionë banorë, Europa e bashkuar është testi më serioz i këtyre kombeve, që të dëshmojnë vitalitet dhe vlera.

Deviza lapidare serbe "da komsiji crkne krava", (që fqinjit t'i ngordhë lopa" nuk çmontohet ndryshe. Sepse nga lopa e ngordhur mund të përfitohet vetëm shija e padurueshme kundërmuese. ■

(Fjalë e paraqitur në Tryezën me temë "Njëzet vjet pas", të organizuar nga PEN Qendra e Kosovës në Prishtinë më 29 prill 2010)



Tensionohet gjendja në Republikën e Maqedonisë





Mr. Milazim MUSTAFA

Gjendja në vendin me më pak perspektivë në Ballkan edhe këçsaj here, sikurse shumë herëve të tjera, po lëkundet. Moszgjidhja e problemeve të identitetit, rëndimi i problemeve të mëtejme ndëretnike, si dhe nxitja e problemeve ndërkonfesionale, vetëm se sa e vërtetojnë këtë. Përkundër thirrjeve të shumta të faktorëve vendorë dhe ndërkombëtarë që veprojnë në Maqedoni, garnitura qeveritare maqedonase, me kokëfortësi të paparë, vazhdon avazin e saj për realizimin e politikave të saj mono etnike dhe mono religjioze.

Incidente të vazhdueshme në zonën kufitare me Kosovën

Kohëve të fundit, publikisht, të zhveshur nga zhargoni diplomatik dolën edhe ambasadorët e SHBA-ve, Bashkimit Evropian dhe i OSBE-së në Maqedoni, duke treguar se ardhmëria e këtij vendi varet nga zgjidhja e problemit të emrit me Greqinë. Një ditë pas kësaj deklarate, në kufirin mes Kosovës dhe Maqedonisë u zunë një sasi e madhe armatimi, duke njoftuar edhe për konflikt të armatosur midis "një njësiti të Ushtrisë Çlirimtare Kombëtare dhe forcave policore maqedonase". Pas kësaj, në mediat në Maqedoni arriti edhe "Komunikata nr. 1" e UÇK-së, ku thuhet se kjo ushtri është prezent në të gjitha trojet shqiptare.

Përkundër tentativa për deklarimin e këtij rasti "si incident i izoluar", ndodhi një incident tjetër në fshatin Radushë të Shkupit, vend në afërsi të kufirit me Kosovën. Nga informata e lëshuar nga Ministria e Punëve të Brendshme, njoftohet se ka pasur një konflikt të armatosur midis policisë dhe "një grupi të armatosur", ku sipas policisë, janë vrarë katër persona prej këtij grupi: Shaban Zenuni nga Merova e Tetovës, Kemal Mustafa nga Gërçeci i Shkupit, Xhafer Shalë, shtetas i Kosovës dhe Harun Aliu, emri i të cilit u bë i ditur një ditë më vonë. Zaten kjo është për t'u dyshuar sepse Aliu ka qenë figurë e njohur politike (kryetar i partisë Alternativa Kombëtare dhe njëri ndër themeluesit



e Ushtrisë Çlirimtare Kombëtare, i njohur si Komandant Kushtrimi). Ai ishte i dënuar me burgim të përjetshëm për shkak se u ngarkua me akuzën për vrasjen e policit Zoran Markovski në afërsi të pompës së benzinës Makpetroll në Autokomandë, në shenjë hakmarrje ndaj aksionit policor kundër popullatës civile në Brodec. Tekefundit, arsye plotësuese për të hedhur dyshime është ekspozimi në media i furgonit të bërë shoshë nga breshëria e plumbave. Sikur të kishte pasur aty arsenal të atillë eksplozivi siç thuhet ("gjashtë thasë me TNT, tre thasë me granata, bomba dore, mina këmbësorie dhe municion të llojeve të tjera të armëve"), atëherë si shpëtoi furgoni nga eksplodimi? Pa mëdyshje ky ishte vetëm një skenar i kurdisur, i përgatitur me prapavijë antishqiptare, që rëndon situatën edhe ashtu të tensionuar.

Duke pasur parasysh këto rrethana, morëm mendimin e disa analistëve të pavarur në Republikën e Maqedonisë, të cilët u prononcuan rreth situatës së krijuar në këtë vend, duke refuzuar që të japin përgjigje konkrete dhe të drejtpërdrejta në lidhje me këtë situatë.

Prof. dr. Mersel Bilalli, prof. universitar në Universitetin Fon, ish-deputet dhe njohës i mirë i rrethanave ne Republikën e Maqedonisë dhe prof. dr. Biljana Vankovska, profesoreshë në Institutin për studime paqësore në Shkup.

Fajtorë janë partitë politike shqiptare në vend dhe ekzistimi i një numri të madh armësh ilegale

Z. Bilalli thotë se situata është një produkt i keqmenaxhimit të situatës politike në vend, por para së gjithash i pozitës nënçmuese të shqiptarëve në Republikën e Maqedonisë. Gjithashtu, ai tha se kemi të bëjmë me një problem të llojit ndëretnik, d.m.th midis dy komuniteteve që ekzistojnë në RM. Kjo vjen si rezultat i pozitës inferiore në të cilën


Mersel Bilalli


Biljana Vankovska

ndodhen shqiptarët si rezultat i mosluajtjes së lojërave politike të partive shqiptare në vend, - tha ai, - duke ua hedhur fajin kryesor partive politike shqiptare, për mosndërmarrjen e veprimeve të caktuara në kohë të caktuar. Sepse është një rregull i pashkruar se nëse politika nuk i zgjidh çështjet, atëherë në skenë dalin grupe të ndryshme asociale, të cilat tentojnë të marrin situatën nën kontroll për zgjidhjen e çështjeve të caktuara.

Ndryshe prej tij mendon zonja Vankovska, e cila theksoi se e gjithë kjo situatë është si pasojë e prezencës së madhe të armëve të paligjshme në regjion, por edhe për shkak të prezencës akoma aktive të radikalëve dhe shumë ish-komandantëve ushtarakë, të cilët tanimë janë bartës të funksioneve politike. Faktikisht, të gjithë elementet e dhunës janë prezent. Për këtë, krejt varet se kur politika do ta shprehë dëshirën për përdorimin e këtyre mjeteve dhe për të nxitur konflikte të tilla, - deklaroi ajo. Fajtorë për këtë janë edhe disa nga liderët që vazhdimisht e frikësojnë popullatën se nëse nuk zgjidhet problemi i emrit me Greqinë dhe bllokohet procesi i integrimeve, atëherë do të shkohet drejt destabilizimit të vendit, - shtoi Vankovska, - duke mbështetur tezën se deklaratat e tilla kanë kontribuuar në një masë të madhe në situatën aktuale.

Moszgjidhja e problemit të emrit me Greqinë dhe shqiptarët

Kriza aktuale në Maqedoni, para së gjithash, është edhe rezultat i dështimit ekonomik të kësaj garniture qeveritare. Kampanja e bujshme për antikizimin e vendit të Partisë maqedonase në pushtet dhe mega projekti prej afro 200 milionë eurosh për Shkupin 2014 në krizën ekonomike që ka kapluar gjithë botën, janë vetëm disa nga faktorët që ndihmojnë këtë situatë. Përveç këtyre, z. Bilalli deklaroi se këto vijnë si rezultat i injorancës së pushtetit që ta zgjidhë problemin e emrit me Greqinë, d.m.th këto kërcënime janë si rezultat i moszgjidhjes së problemit me emrin.



USHTRIA ÇLIRIMTARE KOMBËTARE

KOMUNIKATA NR.1

Njoftohet opinioni mbarë shqiptarë në IRJM se më datë 28.04.2010 në vendin e quajtur Studenë në Karadakun e Shkupit ku dhe ndodhej një pikë e furnizimit të Ushtrisë Çlirimtare Kombëtare, ushtarët tanë hasën në një pritë nga forcat e armatosura qeveritare sllavomaqedone, epilogu i së cilës ishte një i vrarë nga pala armike si dhe një i plagosur lehtë nga ushtarët e njësitit për mbështetje logjiistike të Ushtrisë Çlirimtare Kombëtare.

Ia bëjmë me dije gjithë opinionit shqiptarë se Ushtria Çlirimtare Kombëtare vazhdon me aktivitetin e sajë në mbarë hapësirën shqiptare në IJRM.

Shkup
01.05.2010



Sektori për informim i U.Ç.K-së
Arben Selimi
A. Selimi



Një konflikt i mundshëm do të dëmtonte edhe më shumë pozitën e shqiptarëve në RM, para së gjithash duke pasur parasysh se akoma nuk janë shëruar plagët e luftës së 2001-shit, ku në masë të madhe u devalvua jeta e qytetarëve shqiptarë në RM, para së gjithash në aspektin e qetësisë dhe rehatisë së qytetarëve, deklaroi z. Bilalli.

Të njëjtën gjë e deklaroi edhe znj. Vankovska, duke shtuar se, gjithsesi, popullata shqiptare në Maqedoni nuk është e interesuar për një konflikt të ri të armatosur, duke pasur parasysh akoma plagët e pashëruara të vitit 2001, ku në mënyrë direkte shqiptarët ishin edhe përjetuesit e atij tmerri.

Gati i gjithë opinioni publik në Maqedoni, fajin më të madh ia hedh faktorit politik shqiptar në Maqedoni, duke e akuzuar për moskoordinim e punëve për çështjet madhore për interesat e shqiptarëve. “Ne kemi dëshmi të shumta se partitë politike shqiptare janë përgjegjëset më të mëdha për këtë situatë, sepse po të kishte një koordinim midis partive politike gjithçka do të ishte ndryshe”, - shtoi z. Bilalli. Po të ekzistonte një marrëveshje e tillë, kryeministri nuk do të mund të luante siç po luan sot. Edhe përkundër asaj se ka arritur shumicën në parlament, ne mund t’i bllokonim planet e tij me metoda të ndryshme demokratike, si mitingjet politike paqësore e të ngjashme, sepse po të mblidhnin 50 mijë vetë në sheshin e Shkupit dhe t’ia tregonim forcën tonë pushtetit, gjithçka do të ishte ndryshe, si për enciklopedinë maqedonase, ashtu edhe për projektet e tjera nënçmuese. Sot kemi zëra se Gruevski po përgatitet për zgjedhje të parakohshme, duke dëshiruar që t’i ikë marrjes së vendimit madhor për ndryshimin e emrit të shtetit. Këtu partitë shqiptare, përfundimisht, duhet të koordinohen dhe ta bllokojnë këtë nismë. Pa zgjidhjen e çështjes së emrit, s’ka zgjedhje. Nëse nuk përfillet kjo kërkesë, atëherë po i njëjti të kërcënohet me bojkotim të zgjedhjeve nga shqiptarët - porositi Bilalli.

Në kufirin me Kosovën kemi shtim të forcave speciale maqedonase

Përkundër shumicës së deklaratave shpresëdhënëse, se këto janë vetëm incidente të izoluara, prapë se prapë, shenjat që duken dëshmojnë për diçka tjetër. Kohëve të fundit, nëpër mediat e Maqedonisë u plasuan lajme për shtimin e forcave speciale maqedonase në kufirin me Kosovën. Pak ditë më parë, zëdhënësi i MPB e mohoi këtë, ndërsa më vonë e përgënjeshtroi po të njëjtën deklaratë të tij.

Në pyetjen se a vërehen elemente për destabilizimin e vendit, prof. Bilalli deklaroi se elementet ekzistojnë. Këtë pushteti e di shumë mirë. Nuk kemi njohuri sa seriozë janë këta faktorë, por jemi shumë të vetëdijshëm se për destabilizim nuk nevojiten forca të mëdha.

E të njëjtit mendim ishte edhe zonja Vankovska. Ajo tha se pas kësaj mund të qëndrojë “gjithkush, por edhe ndonjë anonim që dëshiron të luajë rolin e heroit”. Nuk mund të jap mendim për forcën reale të këtij grupacioni ose kërcënimi, por kjo sipas meje nuk është edhe shumë e rëndësishme.

Sipas të dy të anketuarve, një konflikt i tillë nuk do të shkonte në dobi të askujt. Sipas z. Bilallit, e vetja “dobi” mund të ishte se Gruevski do të fitonte kohë. Megjithatë edhe ajo kohë do të ishte shumë e shkurtër, mund të themi se do të ishte kohë me ditë, javë a muaj, sepse problemit të emrit nuk mund t’i ikë aspak. Ai është ndërtues i një politike destabilizuese. Nëse do të kishte një konflikt të tillë, me siguri se do të dëmtohej edhe imazhi i shqiptarëve në Ballkan. Jam i mendimit se shqiptarët duhet ta shfrytëzojnë kapacitetin e tyre politik dhe t’i avancojnë problemet e tyre nëpërmjet rrugëve politike, d.m.th të flasë politika në vend që të flasin armët. Vankovska, në këtë rast, tha se duhet t’i jepet rasti të zhvillohet demokracia dhe paqja e jo ato vetëm të aktrohen para faktorit ndërkombëtar. Sipas saj, bashkësia ndërkombëtare nuk ka dëshirë për destabilizim të vendit, por vetëm për kontroll më të madh, për shkak se është e vetëdijshme për të arriturat e shumta që kanë korrur në këtë rajon. ■





Bunkerët dhe çadrat



Avni AVDIU

Kanë kaluar 8 muaj nga zgjedhjet parlamentare në Shqipëri dhe situata vazhdon të mbetet e tensionuar në mes pozitës dhe opozitës. Kriza vazhdon, protestat po ashtu dhe qeveria me opozitën ndodhen në minimumin historik të komunikimit të arritur që prej shumë vitesh. Greva e urisë e 21 deputetëve të Partisë Socialiste dhe mbështetësve të tyre në betejën për transparencën e zgjedhjeve të 28 qershorit, vazhdon në 28 çadrat e ngritura në bulevardin "Dëshmorët e Kombit", para godinës së Kryeministrisë. 'Grevë dhe shfaqje', ky është teatri me emrin Shqipëri.

Greva e parë e urisë e njohur në vend ishte ajo e shkurtit të vitit 1991, kur studentët ishin ngujuar me kërkesën për t'i hequr Universitetit emrin e Enver Hoxhës. Atëherë Shqipëria në botë njihej si vendi i bunkerëve. Sot socialistët (trashëgimtarët e PPSH-së) e kanë popullarizuar Shqipërinë si vendi i çadrave. Dikur Enveri ngriti bunkerë kundër armiqve imagjinarë, sot Edvini ka ngritur çadra kundër pozitës në pushtet. Me bunkerët synohej ruajtja e pushtetit diktatorial, me çadra synohet marrja e pushtetit me forma puçiste. Është një mentalitet i njëjtë që ka për objektiv dhunën. Dikur komunistë, tashmë socialistë të riformatizuar, të moderuar dhe të kamufluar.

Kryetari i Partisë Socialiste është shprehur se nuk do të ketë tërheqje nga protesta dhe greva e urisë, deri në plotësimin e kauzës për transparencën e zgjedhjeve. Protesta e opozitës socialiste për hapjen e kutive është zhvendosur nga Tirana në disa zona të vendit, nga jugu në veri, por grevat e urisë po zëvendësohen me një strategji të re, atë të bllokimit të arterieve kryesore kombëtare. Kjo grevë jep mesazhet e një dhune mjaft aktive, kurse të ngujuarit mund të bëhen pretekst për nxitje emocionale të turmës për të bërë që kjo të humbasë më në fund durimin dhe të kalohet, kësisoj, në akte dhune e destabilizimi. Ky "agjërim" djallëzor për fatet e demokracisë ka ardhur si mllef personal humbësish dhe mbart vlera tepër të dyshimta, pasi vetë frymëzimi për këtë radikalizim të situatës është një vogëlsi cinike e një grushti individësh. Panorama e vetme që arrihet të shihet përmes retorikës ekstreme dhe gjuhës së kërcënimit, është ajo e një bllokade të vërtetë të negociatave për gjetjen e një kompromisi. Okupimi i bulevardit me çadrat edhe tribunat e vendosura atje, oratorët jashtë grevës që mbajnë vazhdimisht fjalime revolucionare; njerëzit që vijnë nga rrethet të protestojnë; media dhe gazetarë që i fryjnë zjarrit; të gjithë kanë një mision: reprizimin e anarkisë së '97. Opozita kurdisi një protestë, e cila krejt papritur, (papritur edhe për vetë kurdisësit e këtij aktiviteti) agravohet në një grevë urie, e cila nuk ka as limite, as grafik dhe ajo çka është më e rëndësishmja: as kërkesa të qarta. Kundërpërgjigjja nga ana e mazhorancës ishte e menjëhershme: edhe mazhoranca or-







ganizoi një koncert-miting, në të cilin nuk kishte asnjë rëndësi, as repertori, as cilësia e fjalimeve: vetëm numri i pjesëmarrësve. Demonstrim "i pashmangshëm" forcash? Përse? Përpara kujt?

Politikë naivësh, inatesh, cirku...politikë cinike, bajate.

Askush s'mund ta bind Edin se ka humbur, madje as certifikimi i zgjedhjeve (të 28 qershorit) me notë pozitive nga vetë komisionerët socialistë, e lëre më nga dikush tjetër. Rama duhet të vetëdijesohet për faktin se greva e urisë mund të vijojë sa të dojë, por nuk mund të imponojë asgjë politikisht. Zgjedhjet janë kryer dhe zgjedhjet e reja, në bazë të Kushtetutës, janë në vitin 2013. Kryeministri nuk mund të ikë me grevë urie dhe as me ndonjë formë tjetër presioni jashtë sistemit. Nuk është zgjidhje imponimi politik dhe asnjë lloj forme presioni nuk mund të zëvendësojë strukturat legjitime.

Sot, të gjithë ndërkombëtarët që kanë njëfarë lidhje me Shqipërinë, kanë theksuar dhe vazhdojnë të përsërisin se kriza politike dhe institucionale, jo vetëm që po rrezikon seriozisht proceset integruese të vendit, por po shndërrohet në një barrë edhe për jetën e përditshme të qytetarëve.

Zv/ndihmës sekretari i shtetit amerikan për Çështjet e Evropës dhe Euroazisë, Stuart Xhons ka dënuar lëvizjet e pajustifikuara të opozitës, duke e cilësuar grevën e urisë dhe bojkotin si "shumë të dëmshme për perspektivën e Shqipërisë në integrimin evropian".



Presidenti i grupit parlamentar popullor në Këshillin e Evropës e ka cilësuar si artificiale dhe sterile opozitën e rrugës që po ndjek Edi Rama, ndërkohë që ka theksuar se vijimi i protestave dhe i bojkotit veç do e skualifikojë këtë forcë politike, që po injoron rekomandimet e Këshillit të Evropës

Ish-presidenti Rexhep Meidani, po ashtu, është shprehur në mënyrë të prerë kundër grevës së deputetëve socialistë dhe simpatizantëve të kësaj partie. Socialisti Mejdani theksoi se: "Futja e grevës së urisë si element në protestën e PS-së për hapjen e kutive është një element i cili nuk i shërben stabilitetit demokratik të vendit. Ky element i fundit për mendimin tim është i tepërt dhe mund të sjellë shqetësime relativisht serioze për zhvillimet demokratike dhe për stabilitetin politik dhe ekonomik në Shqipëri".

Kriza shqiptare ndodh në një kontekst të rënduar zhvillimesh negative në rajon e Europë. Kjo s'e bën asfare më të mirë pritshmërinë për të ardhmen e afërt. Kriza e borxhit grek, ngjarjet në Maqedoni e Kosovë, janë vetëm koka e listës së peripecive ku ndodhet sot Europa. Kjo grevë vetëm mund t'i përkeqësojë problemet e mëdha që ka vendi dhe jo t'i lehtësojë. Pas vendimit të fundit të Edi Ramës për të dërguar shokët e vet së bashku me disa militantë në grevë urie, duket se zhvillimet politike të vendit kërkojnë një ndërhyrje emergjente, që pastaj të mos ketë sërish nesër grindje se kush i ka përgjegjësitë për vonesat. Opinionet e shqiptarëve janë akoma të ndara në lidhje me ngjarjet e vitit 1997, por është mendimi i shumicës dërrmuese se vendi do të kishte paguar një kosto shumë më të ulët, nëse zgjidhja politike do të ishte dhënë dy-tre muaj ose edhe dy tre javë para 9 marsit të atij viti. Një zgjidhje imediate është e nevojshme, në radhë të parë, për vendin dhe imazhin e tij. ■


Ndodh edhe kjo!

Namik Dokle ia puth dorën këngëtares Elsa Lila, e cila iu bashkua grevës së urisë

Këngëtarja Elsa Lila, e cila jeton në Itali, ka bërë deklaratë paradoksale duke pohuar se as që ka votuar në zgjedhjet e 28 qershorit, por gjithsesi mbronte tezën e njohur "Dua të shoh votën time". Duke folur në emisionin "Ora e intervistës", të gazetarit Alfred Peza, në Ora News, Elsa Lila është ndalur gjatë në shkaqet që e çuan atë të futej në grevën e urisë dhe të ishte e ngujuara e 203-të e opozitës shqiptare. Lila tha se ishte futur në ngujim nën moton e kreut socialist Rama, "Dua të shikoj votën time", por menjëherë më pas pohoi faktin se "unë nuk kam votuar në zgjedhjet e 28 qershorit".

Zgjedhjet serbe në Kosovë, për politikanët e Kosovës, janë të papranueshme

Institucionet vendore nuk i nj



Muhamet JAHIRI

Shteti serb, përmes strukturave të tij në pjesën veriore të Kosovës, ka paralajmëruar se do t'i mbajë zgjedhjet lokale serbe më 30 maj. Një gjest të tillë e kanë mirëpritur banorët dhe përfaqësuesit serbë të asaj pjese, të cilët edhe më tutje nuk i njohin institucionet e Kosovës dhe që nga paslufta kanë vazhduar të jenë nën qeverisjen e Beogradit.

Në anën tjetër, përfaqësuesit e institucioneve të Kosovës e kanë quajtur të papranueshëm organizimin e zgjedhjeve serbe në territorin e Kosovës. Ata e kanë akuzuar shtetin serb, i cili, sipas tyre, po e cenon integritetin territorial të Kosovës dhe po rrezikon edhe destabilizimin e Ballkanit.

Mirëpo, pavarësisht qëndrimit të institucioneve, partitë opozitare kanë akuzuar koalicionin qeverisës, i cili sipas tyre nuk është i interesuar që ta fusë nën kontroll atë pjesë të Kosovës.

Kryetari i Kuvendit të Kosovës, Jakup Krasniqi, ka thënë se mbajtja e zgjedhjeve të organizuara nga shteti serb, në pjesën veriore të Kosovës, është e papranueshme për institucionet e Kosovës. Ai ka theksuar se akte të tilla e dërgojnë rajonin drejt destabilizimit.

"Këto ndërhyrje që po bëhen nga ana e shtetit serb janë ndërhyrje të drejtpërdrejta në sovranitetin e Kosovës dhe kjo situatë nuk provon siguri, por, destabilitet. Prandaj, të gjithë duhet të përpiqen, edhe institucionet e Kosovës edhe ato ndërkombëtare, por, edhe ato të Serbisë, për të siguruar paqen dhe sigurinë në këtë rajon", - ka thënë kryeparlamentari Krasniqi, duke aluduar për organizimin e zgjedhjeve nga ana e shtetit serb në pjesën veriore të Kosovës.

Sipas tij, nuk është e mundur që vetëm shqiptarët ta ruajnë stabilitetin e



rajonit, mirëpo për një gjë të tillë duhet të jenë të angazhuar të gjithë.

"Nuk është e mundur që vetëm ne ta ruajmë paqen dhe sigurinë në rajon. Duhet të jetë një mesazh i qartë për të gjitha vendet e rajonit dhe, në përgjithësi, për të gjithë ata që janë të interesuar që në këtë rajon të ketë siguri", - është shprehur Krasniqi.





Makolli: Zgjedhjet serbe duhet të ndalohen

Por pavarësisht deklaratave të përfaqësuesve të institucioneve, opozita mendon ndryshe.

Ibrahim Makolli, nënkryetar i Aleancës Kosova e Re (AKR), mbajtjen e zgjedhjeve serbe në pjesën veriore të vendit e ka quajtur si të papranueshme. Ai ka thënë se organizimi i zgjedhjeve serbe në territorin e Kosovës duhet të ndalohet pasi që, sipas tij, kjo e cenon sovranitetin e vendit tonë.

"Është dashtë të ndalohej mbajtja e zgjedhjeve të huaja, në këtë rast të Serbisë, brenda territorit të Republikës së Kosovës, e cila nënkupton cenim të sovranitetit dhe të integritetit të vendit", - ka deklaruar Makolli.

Sipas Makollit, nuk është e mjaftueshme vetëm të ketë deklarata se nuk njihen zgjedhje atje, por duhet vepruar me kushtetutë për shtirjen e pushtetit.

"Zyrtarët vendorë dhe ndërkombëtarë kanë deklaruar se nuk do t'i njohin këto zgjedhje por kjo është pamjaftueshme, sepse vetë mbajtja e tyre nënkupton diçka tjetër. Është dashtë që institucionet e vendit të punojnë me Kushtetutë dhe me ligje, në mënyrë që mos të lejojnë që një gjë e tillë të ndodhë edhe pas dy vjetëve të shtetësisë së Kosovës", - është shprehur Makolli.

Nënkryetari i AKR-së ka akuzuar institucionet e vendit, të cilat, sipas tij, edhe dy vite pas pavarësisë së vendit ende po qëndrojnë duarkryq para sfidës në veri.

"Institucionet e vendit edhe më tutje nuk po kanë ndonjë ide se si do të gjinden para situatave të krijuara në atë

...ohin zgjedhjet serbe në Kosovë

pjesë, e cila nuk është nën kontrollin e autoritetit të Prishtinës. Ato duhet që të jenë të vendosura dhe të veprojnë në këtë drejtim, për ta futur edhe atë pjesë nën sovranitet", - është shprehur Makolli.



Ramadani: S'po zbatohet as strategjia për veriun

I të njëjtit mendim është edhe Burim Ramadani, sekretar i përgjithshëm i Aleancës për Ardhmërinë e Kosovës (AAK), i cili ka thënë se mbajtja e zgjedhjeve të shtetit serb në Kosovë tregon më së miri se institucionet e vendit nuk e kanë nën kontroll gjithë territorin.

"Nga kjo që po shihet mund të them se Kosova ende nuk e ka kontrollin shtetëror të vendit. Kjo po ndodh edhe dy vjet pas shpalljes së pavarësisë, dhe mund të themi se është një dështim i jashtëzakonshëm i qeverisë së vendit, sidomos pas propozimit të ICO-së për strategjinë e integrimit të veriut", - është shprehur Ramadani, duke iu bërë thirrje institucioneve të vendit që të mos e lejojnë një gjë të tillë.

"Është koha e fundit që serbëve të Kosovës të mos t'iu lejohet që të bëjnë veprime të tilla, që janë në kundërshtim me kushtetutën e vendit dhe që Serbisë t'i ndalet hovi dhe të mos lejohet që ta cenojnë edhe më tutje sovranitetin e Kosovës", - ka theksuar ai.

Ramadani ka akuzuar, po ashtu, qeverinë e vendit, e cila, sipas tij, nuk ka punuar sa duhet për stabilizimin e pjesës veriore të Kosovës, e ka lënë të lirë zhvillimin e krimit dhe shtrirjen e pushtetit në veri të Kosovës.

"Ne edhe më parë i kemi bërë thirrje qeverisë së vendit që të punojë më shumë për ndalimin e organizimit të zgjedhjeve serbe atje dhe për futjen në kontroll të asaj pjese. Por deri më tani nga ajo që kemi parë mund të themi se kjo qeveri nuk është e interesuar për një gjë të tillë", - është shprehur ai.



Zeneli: Serbia po mundohet ta minojë Kosovën

Ndërkaq, Lulzim Zeneli nga Lidhja Demokratike e Dardanisë (LDD), duke folur për zgjedhjet serbe në veriun e Kosovës, ka thënë se kjo është edhe një tentativë e Beogradit për ta minuar dhe destabilizuar shtetin tonë.

"Është edhe një tendencë e qeverisë së Beogradit për ta minuar pavarësinë e Kosovës, në mënyrë që pjesën e veriut ta largojë nga kyçjet në institucionet tona. Është goditja e radhës që shteti serb po i jep kushtetutës së Republikës së Kosovës", - ka pohuar Zeneli, duke i akuzuar edhe institucionet e vendit për mosgatishmëri për zgjedhjen e çështjes së veriut të Kosovës.

"Edhe institucionet e Kosovës nuk janë paraqitur efikase, në mënyrë që të veprojnë në bazë të ligjit dhe Kushtetutës së Kosovës, prandaj jemi në një situatë për të ardhur keq", - ka theksuar Zeneli.

Kohë më parë, edhe Përfaqësuesi Civil Ndërkombëtar ka deklaruar se nuk do ta njohë rezultatin e zgjedhjeve lokale të organizuara nga Serbia, përderisa institucionet e Kosovës kanë pohuar, disa herë, se këto zgjedhje janë të patolerueshme dhe antikushtetuese. ■



Marko Jakshiq

Jakshiq: Jemi të vendosur për mbajtjen e zgjedhjeve

Ndërkohë, ditë më parë, politikani serb në veri, Marko Jakshiq, ka bërë të ditur se serbët lokalë janë të vendosur për mbajtjen zgjedhjeve serbe në veriun e Kosovës. Ai ka thënë se mbajtja e këtyre zgjedhjeve do të konfirmojë edhe njëherë se serbët në veri dëshirojnë të jenë pjesë e shtetit serb.

"Po mendoj se këto zgjedhje tregojnë edhe njëherë se serbët e veriut të Mitrovicës tregojnë se janë pjesë e shtetit të Serbisë, që qytetarët e saj i respektojnë ligjet e Serbisë dhe dalin në zgjedhjet që organizohen nga Serbia. Mendoj se këto zgjedhje janë shumë të nevojshme dhe ato nuk mund t'i pengojë as bashkësia ndërkombëtare. Mendoj se në zgjedhjet e këtushme lokale duhet të fitojë krahu nacionalist dhe paqedashës", - ka thënë Jakshiq.



As më 21 qershor Kurti nuk do të paraqitet në seancë



Procesi gjyqësor ndaj Albin Kurtit si seri televizive



Qendresa MUSTAFA

Prishtinë – Procesi gjyqësor ndaj liderit të Lëvizjes "Vetëvendosje!", Albin Kurti, kohëve të fundit është shndërruar në një seri televizive. Kështu e ka quajtur gjyqtari ndërkombëtar i EULEX-it, Ferdinando Buatier de Mongeot. Ky i fundit madje i ishte drejtuar publikut në gjykatore me fjalët "Mirë se vini në episodin e dhjetë".

E gjithë kjo kishte ardhur si pasojë e mosparaqitjes së Kurtit në procesin gjyqësor kundër tij për dhjetë herë radhazi. Mungesën e tij në gjykatore lideri i Lëvizjes "Vetëvendosje!", Albin Kurti, e quan të arsyeshme pasi që sipas tij misioni i EULEX-it këtë proces e konsideron me motive politike.

"Nuk do t'i paraqitem gjyqit të EULEX-it pasi që ky mision nuk e njeh Kosovën shtet të pavarur dhe sovran. EULEX-i këtë proces gjyqësor e ka shndërruar në proces politik", - ka thënë Kurti.

Fjalët e tij si duket nuk i kanë bërë përshtypje gjyqtarit Buatier de Mongeot, pasi që në të gjitha seancat gjyqësore ai ka lëshuar urdhër arresti për Kurtin, në mënyrë që ai të sillet në gjykatore dhe procesi gjyqësor ndaj tij të zhvillohet në mënyrë të rregullt.

"Sipas nenit 341 të Kodit të Procedurës Penale të Kosovës urdhëroj që i pandehuri Albin Kurti të sillet në gjykatë nga policia e Kosovës. Prezenca e të pandehurit në seancën gjyqësore është e detyruar si formë e parë e garantimit të procedurës për vetë të pandehurin", - ka thënë gjyqtari Buatier de Mongeot.

Mirëpo në pamundësi të arrestimit të Albin Kurtit, autoritetet vendore kishin marrë mjaft kritika nga gjyqtarët e EULEX-it.

"Policia e Kosovës ka treguar jo seriozitet dhe ka dështuar në arrestimin e të pandehurit Albin Kurti", - ka thënë gjyqtari Buatier de Mongeot.

Procesit gjyqësor ndaj lideri të Lëvizjes "Vetëvendosje!", Albin Kurtit, po i shtohet edhe një seri tjetër, ajo e ndërrimit të avokatëve. Në fillim, Kurti mbrohej nga avokati Ramiz Krasniqi, i cili pati dhënë dorëheqje për shkak se e cilësonte procesin si politik. Pas tij trupi gjykues pati caktuar si avokat Avni Gjakovën, i cili po ashtu sikurse kolegu i tij pati kërkuar dorëheqje nga mbrojtja pas refuzimit të kërkesës së tij që trupi gjykues të përbëhej nga gjyqtarë vendorë e jo ndërkombëtarë.

Ky avokat madje ishte sulmuar me vezë nga Komiteti për aksione i Lëvizjes "Vetëvendosje!" gjersa ai po hynte në objektin e Gjykatës së Qarkut në Prishtinë.

Avokati i tretë u caktua Musa Dragusha. Ai nuk është paraqitur asnjëherë në gjykatore me arsyetim se është i padisponueshëm të jetë mbrojtës i Albin Kurtit.

Duke e parë se ky proces po zvarritet dhe e gjithë pala vendore po jep dorëheqje nga rasti "Kurti", aktivistët e Lëvizjes "Vetëvendosje!" tashmë iu drejtuan edhe prokurorit të çështjes, Ali Rexha.

"Përveç dorëheqjeve të avokatëve, tash është koha që prokurori Ali Rexha t'i tërheqë aktakuzat kundër Albin Kurtit si të pabaza dhe të kërkojë mbylljen e këtij procesi", - ka thënë aktivisti i Lëvizjes "Vetëvendosje!", Glauk Konjufca.

Mirëpo ky prokuror ka vendosur të heqë dorë vetëm nga pika tre e aktakuzës, e cila e ngarkon Kurtin me veprën penale: thirrje për rezistencë, ndërsa për dy veprat e tjera: pjesëmarrje në grup dhe pengim të personit zyrtar në kryerjen e detyrës zyrtare, Raxha vazhdon të hedhë dyshime.

Kundër procesit gjyqësor të liderit të Lëvizjes "Vetëvendosje!" janë nënshkruar 175 mijë peticione. Organizatorët e Këshillit kundër procesit gjyqësor "Kurti" kanë bërë me dije se 148 mijë e 216 nënshkrime janë mbledhur në Kosovë, 13 mijë e 187 në Shqipëri, 11 mijë e 459 në Maqedoni, 1207 në Preshevë si dhe 876 në Mal të Zi.

Ky këshill ka premtuar se peticioni me 175 mijë nënshkrime kundër procesit gjyqësor të liderit të Lëvizjes "Vetëvendosje", Albin Kurti, do t'i dërgohet OKB-së, Këshillit të Evropës dhe presidentit të Shqipërisë, Bamir Topi.

Pas shtyrjes së dhjetë seancave gjyqësore, trupi gjykues ka caktuar që më 21 qershor të mbahet seanca e radhës për rastin "Kurti". Aktivisti i Lëvizjes "Vetëvendosje!", Glauk Konjufca ka thënë për revistën "Paqja" se as kësaj radhe Kurti nuk do të paraqitet në gjykatë. Të njëjtin mendim e ka shprehur edhe avokati Musa Dragusha, duke thënë se "ende vazhdon të jetë i padisponueshëm për ta mbrojtur Kurtin në këtë proces gjyqësor". ■

'Pluhuri i bardhë' që vret në heshtje rininë kosovare!



Astrit VELIQI

Jo vetëm në kryeqendrën e Kosovës, në Prishtinë, po kudo në Kosovë mund të hasësh narkomanë që konsumojnë lëndë të ndryshme narkotike, madje pa u frikësuar nga askush.

Kjo tashmë mund të themi se është bërë një lloj manie. Të rinj e të reja, duke mos çarë kokën nga askush, i konsumojnë këto lëndë, ndërsa e ashtuquajtura "narko-kultura" tashmë ka zënë fill në çdo cep.

Dihet tashmë se narkomanët i kanë vendet, klubet dhe vendtakimet e tyre. E tërë kjo bëhet në sy të institucioneve të cilat po dështojnë me strategjitë e tyre. Fushatat, broshurat, etj. siç duket nuk po arrijnë te këta njerëz, të cilët po vazhdojnë me të vjetrën.

Narkomanët, të cilët janë konsumues të rregullt të lëndëve narkotike, kanë filluar nga joshja, por tashmë disave një jetë e tillë u është bërë e mërzitshme.

I riu D. Berisha, i cili për arsye objektive nuk dëshiron të identifikohet, është vetëm 25 vjeçar dhe shprehet se ka nisur ta konsumojë drogën që në moshën 20 vjeçare.

Rrëfimi i 'narkomanit' 25 vjeçar

Ai, në këtë kohë, është penduar për këtë hap që ka bërë në jetën e tij, ngase siç thotë vetë është e vështirë të jesh i varur gjithnjë pas pluhurit të bardhë.

"Ka raste kur ndihem mirë, por ka momente ankthi, kur unë duhet të marrë patjetër drogën, në të kundërtën nuk mund të qetësohem", - rrëfen ky i ri, i cili, të shumtën e kohës, i mban duart mbi fytyrë për ta justifikuar gjendjen e tij psikologjike.

Edhe pse këtë të ri mëngjesi e zbardh dhe mbrëmja e ngrys me pluhurin e bardh në gji, ai jeton më shpresë se një ditë edhe ai do t'i kthehet jetës normale, sikurse bashkëmoshatarët e tij.

Megjithatë ai ka një apel për të rinjtë e tjerë që mos t'i hyjnë kësaj rruge, e cila mund t'i dërgojë që në fillim në greminë.

Por ky i ri nuk është i vetmi në klubin e ashtuquajtur të narkomanëve kosovarë që, fatkeqësisht, që nga paslufta e këndej janë shtuar vazhdimisht.

Fatin e tyre si të themi ata e kanë në duart e veta, por secili prej tyre e ka kuptuar tashmë se jeta meriton më shumë. Ka vend për gjithçka, duke filluar nga një këshillë e mirë, ndihmë miqësore, buzëqeshje, e deri te një rrezatim shprese, e cila në momentin e fundit edhe mund të reflektojë pozitivisht mbi fatin dhe të ardhmen e tyre.

Por sa në të vërtetë këta narkomanë mund të ndalohen e të rehabilitohen nga institucionet gjegjëse? Zyrtarë të Policisë së Kosovës, duke folur për këtë fenomen, potencojnë faktin se Ministria e Punëve të Brendshme në bashkëpunim me Ministritë dhe institucionet e tjera ka hartuar një strategji kombëtare kundër drogave.

Sipas Brahim Sadriut, zyrtar për informim në PK, kjo strategji ka arritur të japë kontribut të madh në identifikimin, analizimin dhe vlerësimin e kësaj dukurie negative për shoqërinë tonë dhe shtetin në përgjithësi.

PK: Rreth 150 operacione në vit në Kosovë

Sadriu thotë se çdo vit, Policia e Kosovës zhvillon përafërsisht mbi 150 operacione në tërë Kosovën, me qëllim të ndjekjes penale të personave të dyshuar që veprojnë në forma individuale dhe grupore për përdorimin, kultivimin dhe trafikimin e drogës brenda dhe jashtë Kosovës.

Ky zyrtar i policisë theksoi se me qëllimin e parandalimit të shitjes dhe konsumimit të lëndëve narkotike, Policia e Kosovës mban takime të shpeshta me OJQ-të.

"Hetuesit policorë të lëndëve narkotike bëjnë identifikimin e vendeve dhe lokacioneve në të cilat bëhet shitja dhe shpërndarja e lëndëve narkotike, duke mos dashur që të jepen detaje më të thella për publikun, si arsyetim se këto të dhëna nuk mund të jepen për publikun", - u shpreh Sadriu.

Ai shtoi se ndaj personave, të cilët kapen duke i konsumuar këto lëndë, merren të gjitha masat konform ligjit të aplikueshëm në Republikën e Kosovës.

Mirëpo, përkundër këtyre masave, midis atyre të cilët kapen nga policia duke konsumuar lëndë narkotike nuk ka edhe ndonjë të dënuar rëndë.

Gjykata për kundërvajtje, e cila i gjykon këto çështje, mund të shqiptojë dënime prej 60 ditësh burgim, ose dënimin me gjobë deri në 450 euro.

Në Gjykatën për kundërvajtje në Prishtinë janë të regjistruara 47806 lëndë të tilla, prej të cilave 38902 lëndë janë zgjidhur, si dhe 894



Brahim Sadriu



lëndë të tjera kanë mbetur pa u zgjidhur.

Kryetari i Gjykatës Komunale për kundërvajtje në Prishtinë, Mustafë Selimi, ka thënë se gjatë vitit 2009 dhe 2010, në këtë gjykatë janë dorëzuar shumë lëndë të kësaj natyre.

"Në Gjykatën komunale për kundërvajtje në Prishtinë është mjaft shqetësues shtimi i lëndëve narkotike dhe të pandehurit ngarkohen për posedim të paautorizuar të lëndëve narkotike", - është shprehur ai.

40 të pandehur në vitin 2009-2010

Ai thotë se vetëm vjet dhe sivjet në këtë gjykatë janë dorëzuar 35 lëndë të kësaj natyre me 40 të pandehur, të cilët ngarkohen për posedim të paautorizuar të lëndëve narkotike, kryesisht të llojit marihuanë.



Mirëpo, sipas Selimit, pengesë për përfundimin e këtyre lëndëve është numri i vogël i gjyqtarëve në raport me numrin e madh të lëndëve, të cilat vijnë në këtë gjykatë.

"Përkundër numrit shumë të vogël të gjyqtarëve dhe numrit shumë të madh të lëndëve nga të gjithë lëmenjtë e kundërvajtjes, lëndëve të kësaj natyre u është dhënë përparësi", - pohoi Selimi.

Ligji: Narkomanit 60 ditë burg

Ky i fundit nuk e fajëson as Policinë e Kosovës, duke thënë se nuk është se Policia e Kosovës nuk bashkëpunon me gjykatat, por u jep rëndësi më shumë lëndëve penale sesa atyre për kundërvajtje.

Përveç kësaj, pengesë është edhe mungesa e ligjit për caktimin e dënimit në bazë të sasisë së lëndëve narkotike që kapen të poseduara nga këta persona, pasi Kosova ende vepron me ligjin e ish-Jugosllavisë.

Sipas këtij ligji, dënimet për posedimin e lëndëve narkotike janë një gjobë prej 45 deri në 450 eurosh, si dhe burg deri në 60 ditë.

Sido që të jetë narkomania te të rinjtë tanë tashmë është bërë çështje përditshmërie dhe reale ngase, në të shumtën e kohës, këta të fundit e kanë humbur besimin në vetvete dhe nuk e çajnë shumë kokën për fatin e tyre.

Ky devijim i tyre moral, por edhe psikologjik, sipas shumë psikologëve del në pah në momentet kyçe të adoleshencës së tyre, periudhë kjo kur të rinjtë, në përgjithësi, mund të devijojnë nga rruga e drejtë dhe e rrokullisin fatin e tyre si të parëndësishëm.

Motivet që e shkaktojnë këtë apati të thyer dhe shumë të rrezikshme shpirtërore të këtyre të rinjve janë të natyrave të ndryshme, si: psikologjike, familjare, sociale etj. ■

Trafikimi

"Trafikimi te ne ka qenë një temë e përfolur pas luftës. Kemi pasur një fluks të madh vajzash të trafikuara nga vendet fqinje. Ky trend ka ndërruar shumë në tre vjetët e fundit. Tash, kryesisht, janë vajza të Kosovës, të vendeve rurale të Kosovës"."Problemi është se këto vajza janë shumë shpesh të mitura, 16-vjeçare, të mashtruara nga njerëz që u premtojnë se do të dalin të gjejnë punë në qytet", - thotë sociologia, Linda Gusia.



Fatos SHALA

Trafikimi i qenieve njerëzore vazhdon të mbetet një ndër problemet kryesore me të cilin ballafaqohet shoqëria kosovare. Për dallim nga vitet e pasluftës, kur viktima të trafikimit kanë qenë kryesisht femrat nga Moldavia, Rumania, Bullgaria, Ukraina, në tre vjetët e fundit është rritur numri i femrave kosovare që trafikohen, - thotë Arben Paçarizi, shef i sektorit të hetimit të trafikimit të qenieve njerëzore në Policinë e Kosovës. "Nga viti 2006 e deri më tash, numri i viktimave kosovare, të identifikuara nga policia, është në rritje. Nga analizat tona rezulton se pas zgjerimit të Bashkimit Evropian, ka rënë



i qenieve njerëzore – në rritje



numri i femrave të huaja të trafikuara në Kosovë", - thotë Paçarizi.

Viktimat janë kryesisht vajza të mitura

Ai pohon se autoritetet e rendit tashmë kanë hartuar një strategji nacionale kundër trafikimit 2008-2011. "Është krijuar sekretariati, grupi ndërministror, procedura standarde e intervistimit të viktimave të trafikimit, si dhe kujdesi minimal i viktimave". "Në momentin që identifikohet viktima, ajo strehohet në strehimore të ndryshme derisa të kryhet faza e parë në gjykatë. Nga ana e policisë është e siguruar. Pastaj për socializmin e tyre inkuadrohen Ministria e Punës dhe Mirëqenies Sociale dhe Ministria e Drejtësisë," - shpjegon Paçarizi. Në anën tjetër, Linda Gusia, sociologe, thotë se shumica e vajzave, viktima të trafikimit, janë të mitura. Sipas saj, shkaku kryesor është gjendja e rëndë ekonomike. Edhe zonja Gusia pohon rritjen e numrit të vajzave kosovare, të cilat janë viktima të trafikimit. "Trafikimi te ne ka qenë një temë e përfolur pas luftës. Kemi pasur një fluks të madh vajzash të trafikuara nga vendet fqinje. Ky trend ka ndërruar shumë në tre vjetët e fundit. Tash, kryesisht, janë vajza të Kosovës, të vendeve rurale të Kosovës". "Problemi është se këto vajza janë shumë shpesh të mitura, 16-vjeçare, të mashtruara nga njerëz që u premtojnë se do të dalin të gjejnë punë në qytet", - thotë Gusia. Problem në këtë aspekt ajo sheh mungesën e strehimoreve, ku viktimat do të mund të rehabilitoheshin për të shpëtuar nga rrjeti i trafikantëve. "Strehimoret kanë qenë të dizajnuara për riatdhesimin dhe për akomodimin e vajzave që nuk janë nga Kosova, ndërsa nuk ka strehimore që merren me vajza të trafikuara të Kosovës, edhe pse gjithmonë dyert kanë qenë të hapura edhe për vajzat tona", - shprehet Gusia.




Rreth 600 viktima të ndihmuara

Ndërkaq, organizata për luftën kundër trafikimit të qenieve njerëzore, që vepron në Kosovë, ka për qëllim që t'i ndihmojë viktimat e trafikimit, të parandalojë kushtet që nxisin trafikimin e tyre dhe t'i rehabilitojë viktimat. Teuta Abrashi, zyrtare në këtë organizatë, thotë se që nga viti 2005 organizata është koncentruar për t'i ndihmuar veçanërisht vajzat kosovare të trafikuara, meqë numri i tyre çdo ditë është në rritje. "Në fushën e rehabilitimit kemi ndihmuar rreth 600 viktima potenciale të trafikimit", -thotë ajo. Zonja Abrashi përmend si sfidë vetëdijesimin e vajzave për t'iu shmangur rrjetit të trafikimit. Për autoritetet kjo ka qenë sfidë më vete që prej fillimit, posaçërisht te viktimat potenciale nga mosha 12 deri në 18-vjeçare. ■

"Paqja Studentore" ngadhënjen në zgjedhjet studentore

Shkelzen NUZA



Studentët e Universitetit të Prishtinës kanë votuar për të zgjedhur përfaqësuesit e tyre për Parlamentin Studentor dhe Këshillat e Studentëve sipas njësisë akademike për dy vjetët e ardhshme, duke shpërndarë votat në 11 organizata studentore. Me këtë rast votat e studentëve nxorën fitues organizatën Studentore, Paqja Studentore (PS-UP). Sipas rezultateve preliminare të publikuara të premten nga Komisioni Qendror i Zgjedhjeve i UP-së, kjo organizatë ka marrë rreth 20,5 për qind të votave. Pas saj renditen lista studentore "Reforma" me 10,4 për qind, Unioni i Studentëve Shqiptarë me 10,3 për qind, Unioni i Pavarur i Studentëve të UP-së me 10,2 për qind. Më pak se nga 10 për qind kanë marrë Unioni i Studentëve Proevropianë, Lëvizja Studentore për Integrim, Unioni i Pavarur i Studentëve të Kosovës, Asociacioni Studentor dhe Vizioni Studentor. Ndërkaq, pragun prej 5 për qind nuk kanë mundur ta mbërrijnë organizatat: Integrimi i Studentëve Shqiptarë dhe Zëri Studentor.

Paqja Studentore në Këshillat e Studentëve për njësi akademike, bazuar në rezultatet e publikuara nga UP-ja, është radhitur e para në Fakultetin Ekonomik, Fakultetin e Inxhinierisë Mekanike, Fakultetin e Kulturës Fizike dhe të Sporteve dhe në Fakultetin e Shkencave Teknike Aplikative në Mitrovicë.

Për Këshille dhe për Parlamentin e Studentëve kanë votuar mbi 11 mijë studentë, ose 25 për qind e tyre që kanë pasur të drejtë të marrin pjesë në zgjedhje.

Ky konfirmim i fuqishëm nga ana e studentëve në këtë rrjet social, i shënuar për një kohë relativisht të shkurt kohor, konfirmon qartë se "Paqja Studentore" është organizata e parë dhe më e denjë në përfaqësimin dhe mbrojtën e të drejtave të studentëve të Universitetit të Prishtinës. "Paqja Studentore, falë përkrahjes dhe votëbesimit të studentëve të UP-së ka konfirmuar sërish se tanimë është bërë organizata më e madhe, më aktive dhe me më ndikim në mbrojtjen e të drejtave dhe lirive të studentëve në Universitetin e Prishtinës, në afirmimin e studentëve të UP-së si brenda ashtu edhe jashtë vendit.

Paqja Studentore e Universitetit të Prishtinës duke qenë se është organizatë e vlerave dhe duke qenë se i çmon dhe i vlerëson lart vlerat e çdo studenti dhe studenteje; që nga themelimi i saj ka bërë përpjekje të vazhdueshme dhe maksimale për mbrojtjen e të drejtave të studentëve si dhe përfaqësimin e tyre në mënyrë të denjë në Parlamentin e Studentëve dhe në Senatin e Rektoratit të UP-së.

Sukseset e "Paqes Studentore" janë dëshmuar se janë në të mirën e studentëve të UP-së dhe të shoqërisë sonë në përgjithësi, të cilat kanë qenë të vazhdueshme që nga themelimi i "Paqes Studentore" më 2005 e deri më sot, sepse puna dhe angazhimet e kësaj organizate studentore janë dhe vazhdojnë të jenë të suksesshme deri në nivelin maksimal.

Por ajo që mund të thuhet, e që shpeshherë nga opinioni publik është parë edhe përmes mediave të shkruara dhe vizive, është se aktivitetet e "Paqes Studentore" janë gati pothuajse nga të gjitha fushat e jetës; duke realizuar kështu aktivitete të përjavshme dhe mujore nga shkenca, kultura, letërsia, sporti, humanizmi dhe nga fusha të tjera me interes për studentët dhe shoqërinë në përgjithësi.

"Paqja Studentore" përmes të gjitha këtyre aktiviteteve, rinisë dhe shoqërisë sonë të re i ka dhuruar një vizion të ri se në ç'mënyrë mund të organizohet shoqëria jonë, për të arritur jo vetëm realizimin e synimeve në studimet tona, por edhe arritjen e synimeve edhe më të vështira dhe më komplekse, siç janë integrimet euroatlantike për shtetin tonë të ri. ■



Ideali për studim

Autobusët e stërmbushur, vijnë e shkarkohen çdo të hënë në Prishtinë nga studentët e shumtë, të cilët i kthehen studimeve pas një ose dy ditësh vikendi në ngrohtësinë e familjes. Një fat të tillë e kanë edhe qytetarët e Prizrenit, të cilët duhet të udhëtojnë për në Universitetin e vetëm Publik në Kosovë, atë të Prishtinës. Mirëpo, e vetmja gjë që i mban ata me shpresë, thonë se është ideali për t'u shkolluar dhe motivi për dituri. Mirëpo si duket, kësaj shumë shpejt do t'i vijë edhe fundi, ngase në Prizren që nga 1 tetori i këtij viti do të startojë edhe një Universitet Publik, ai i Prizrenit



Drita VITIA

Jetë e ftohtë në Prishtinë!

"Këtu të përcjell një jetë e ftohtë. Zgjohesh në mëngjes, shkon në ligjërata, bibliotekë, del me shoqëri dhe deri në mbrëmje e përfundon çdo aktivitet. Ndërsa, kur kthehesh në shtëpi-konvikt të pret një jetë e ftoftë, pa familje, pa rrethin e ngushtë, pa të afërmit, miqtë, ... ftohtë". Kështu e nis rrëfimin Festim Rizanaj, student në vitin e parë në Degën e Gazetarisë në Fakultetin e Filologjisë dhe vitin e tretë në Fakultetin Teknik, Dega e Makinerisë, duke shpjeguar vështirësitë, të cilët i has një student nga qytetet e tjera gjatë kohës së studimeve në Prishtinë. Festimi, i cili vjen nga qyteti i Prizrenit, është një ndër studentët e dalluar në të dyja drejtimet që studion. Edhe pse i studion ato njëkohësisht, Festimit nuk i paraqesin problem për arritjen e suksesit. Mirëpo, atë e përcjell një problem tjetër në studime. Vështirësia më e madhe për të është largësia dhe rrugëtimi i gjatë për të arritur deri në vendin e dijes, Universitetin e Prishtinës. Festimi banon në Prishtinë tash e katër vjet si student dhe, edhe pse tani më thotë se është adaptuar me rrethin, i kujton mirë ardhje-vajtjet e para nga qyteti i tij i lindjes, ai i Prizrenit, për në kryeqytet, për të përmbushur njërin nga qëllimet e tij jetësore siç shprehet ai, shkollimin. "Në fillim kur jam regjistruar në fakultet dhe kam filluar të banoj në Prishtinë, e kam pasur shumë problem të qëndroja vetëm. Madje një gjë e tillë ka ndikuar edhe në suksesin tim në atë kohë. Pa dyshim kam pasur një sukses jo të mirë në studime. Mirëpo, me kalimin e kohës kam filluar të adaptohem edhe këtu, edhe pse mungesa e familjes nuk më përmbushet kurrë", - thekson Festimi, duke kujtuar me mall çdo çast që nga dita e parë e studimeve.

Shpenzimet, një problem tjetër

Krahas vështirësive dhe pengesave me të cilët ballafaqohen studentët të cilët vijnë nga komunat e tjera të Kosovës dhe studiojnë në Universitetin e Prishtinës, është edhe ajo e shpenzimeve që duhen bërë. Së paku Festimit një gjë e tillë i kushton hiç më pak se dyqind e pesëdhjetë euro në muaj. Mirëpo, sipas Festimit, kjo është shuma më





e ulët, e cila mund të shpenzohet gjatë qëndrimit njëmujor në Prishtinë, ngase sipas tij, me këtë shumë të hollash nuk mund të llogarisësh asnjë luks përveç shpenzimeve bazë për jetesë. Mirëpo, kur i shtohen këtyre shpenzimeve edhe ato për pagesën e semestrit në fakultet, rrugës ose librave të ndryshme, të cilat duhet blerë krahas atyre që gjenden në bibliotekë, kuota e studimeve bëhet gati e papërballueshme. "Është problem sepse në familjen time jemi tre studentë. Është motra që studion në Fakultetin e Edukimit, Dega në Prizren, ndërsa unë dhe vëllai që studiojmë dhe banojmë në Prishtinë, gati të gjitha shpenzimet na i mbulojnë prindërit", - thotë Festimi.



Dy orë rrugë për në fakultet

Një nga sfidat më të mëdha për Festim Rizanajn është edhe rruga, të cilën duhet ta bëjë së paku çdo dy javë për të parë familjen dhe rrethin ku është lindur. Për Festimin nuk është shumë shqetësuese pagesa që duhet bërë për të vizituar prindërit dhe motrën në Prizren, sa është koha dhe mundi që duhet për ta bërë një gjë të tillë. Ai kujton një nga rastet më interesante e njëkohësisht edhe sfiduese që është përballur si pasojë e rrugëtimit të gjatë. Festimi për shkak të rrugës edhe studimet i ka filluar me gjysmë ore vonesë, ngase nuk e ka arritur provimin pranues me kohë. Ai kujton rrugën që ka bërë për të arritur në Prishtinë në provimin pranues në Gazetari, ku për shkak të problemeve në rrugë ka filluar me gjysmë ore vonesë provimin për pranim në këtë degë. Mirëpo, ai falënderon profesorët që nuk i kanë humbur mundësinë e testimit edhe pse me vonesë. "Është e lodhshme të shkoj për çdo javë në Prizren, sepse atë ditë që shkoj duhet automatikisht të pushoj gjatë gjithë ditës për shkak të lodhjes nga rruga. Ndërsa, shpeshherë të nesërmen duhet të kthehem, ose, edhe nëse qëndroj dy ditë, një ditë nuk mund të jem aktiv në fakultet ose duhet të pushoj nga ligjëratat, gjë që më shkakton pasoja në studime", - ka theksuar Festimi, duke paraqitur vetëm disa nga vështirësitë me të cilët ai përballet për të studiuar në Prishtinë. Kurse, koha më e papërshtatshme për të, është ajo e verës kur mbahen provimet, pasi që, për shkak se Festimi banon në një konvikt privat, duhet ta lirojë atë në fund



të muajit maj. Për të qenë në rrjedha me provimet dhe ndryshimet e datave kur mbahen ato, atij i duhet shumë mund duke udhëtuar gati çdo ditë për të qenë më i informuar rreth këtij orari.



Studentët shpresojnë në Universitetin e Prizrenit

Studimi në kryeqytet është sfidues edhe për Shpejtim Kastratin, i cili po ashtu vjen nga Prizreni dhe është student i vitit të parë në Degën e Gazetarisë në UP dhe në vitin e dytë, në atë juridik. Ai përshkruan rrugën e së premteve dhe të hënave kur autobusët janë të stërmbushur me studentë, të cilët përgatiten për të filluar javën në konvikt ose vikendin në shtëpi. "Çdo të diel mbrëma, e të hënën në mëngjes autobusët e relacionit Prizren–Prishtinë janë plot e përplot. Bagazhet janë të stërmbushura me rroba, turshi e ajvar", përshkruan Shpejtimi kështu vetëm disa nga momentet e rrugës. Mirëpo, të gjitha këto ai i arsyeton me idealin që kanë studentët për ta bërë një gjë të tillë. "Pse studentët e mundojnë kaq shumë veten? Për asgjë tjetër, veçse për idealin që e kanë ushqyer me vite të tëra. Ata janë gjithnjë të motivuar për të nxënë dituri, kudo qoftë ajo", - thotë Shpejtimi. Ai tregon të ketë shumë mund, shpenzime dhe vështirësi për të arritur këtë ideal, mirëpo, qëndron me shpresën më të madhe që ka: hapjen e Universitetit të Prizrenit, i cili pritet të startojë në këtë fillim të vitit akademik. "Neve na u mundësua shkollimi në Universitetin Publik të Prishtinës, por, si duket gjërat do të ndryshojnë për gjeneratat pas nesh", - shprehet Shpejtimi.

Fundi i udhëtimit për prizrenasit

Tema kryesore që zhvillohet gjatë rrugës në autobus Prizren-Prishtinë, sipas Shpejtimit, është hapja e universitetit të dytë publik në Kosovë. Ai tregon ëndrrën e gati të gjithë studentëve, nisja për në fakultet vetëm me libra. "Kur do të nisemi në fakultet veç me libra? Pa pasur nevojë të ngarkohemi me valixhe njëjavore, dy e më shumë për banim në Prishtinë. Veç kësaj, Shpejtimi shpreson se ndikimi i universitetit në qytetin e Prizrenit do të jetë jetik, pasi që sipas tij, shumë gjëra do të duken ndryshe. "Pesë mijë studentë të cilët sigurisht që nuk do të jenë vetëm vendës, por edhe nga rrethina, në mos më shumë do ta gjallërojnë këtë qytet të bukur. Të gjithë prizrenasit janë të vetëdijshëm që në Prishtinë është Kosova, atje është gjallëria atje është administrata, universiteti dhe ambasadat. Që të paktën ta ruajnë "kapitalin" brenda, një universitet është fillim i mbarë", - shprehet Shpejtimi me fanatizëm për qytetin e tij të lindjes.



Universiteti i Prizrenit starton me studime pa pagesë

Nga ana tjetër, janë qeveritarët ata të cilët kanë premtuar se më 1 tetor 2010, Universiteti i Prizrenit do të jetë i gatshëm të pranojë rreth pesë mijë studentë në vitin e parë të studimeve si dhe të startojë me studime pa pagesë në disa fusha të studimit si të ekonomisë, ekonomi dhe matematikë, menaxhment, marrëdhënie me publikun etj. Ministri i Arsimit, Enver Hoxhaj, ka deklaruar kohë më parë se ky universitet do të shtrihet në rreth njëzet hektarë tokë. Deri më tani, Ministria e Arsimit ka shpallur edhe konkursin rreth përzgjedhjes së stafit akademik për këtë universitet si dhe rektorin, i cili do ta udhëheqë i pari UPz-në. ■

Intervistë me ministren e Energjisë dhe Minierave, Justina Shiroka – Pula

Strategjia për Energji do të

Intervistoi: Qëndresë MUSTAFA

Është njëra nga hartueset e Strategjisë së Energjisë për Kosovën dhe optimiste se do ta përmirësojë gjendjen energjetike në vend. Zotohet se Strategjia për Energji, e miratuar nga Qeveria e Kosovës, do të ketë standarde evropiane dhe do t'i sjellë të mira vendit tonë. Ajo ka bërë të ditur se në institucionin që drejton, objektiv parësor është transformimi dhe ristrukturimi i sektorit të energjisë, në mënyrë që të tërheqin investimet e nevojshme private. Ajo thotë se kjo strategji do ta shndërrojë sektorin energjetik në një sektor të qëndrueshëm dhe të vetë financueshëm, i cili do të ofrojë shërbime cilësore energjetike për qytetarët e Kosovës.

Edhe pse e vlerëson gjendjen momentale të energjisë si të qëndrueshme, ajo kërkon që konsumatorët në Kosovë të ndërgjegjësohen rreth pagesës së energjisë së harxhuar. Në të kundërtën do të përballen me ligjin. Ajo premton se nëse qytetarët e Kosovës do ta paguajnë rregullisht energjinë elektrike, do të kenë rrymë pa ndërprerë.

Gjithashtu, ajo tregon se privatizimi i Korporatës Energjetike të Kosovës (KEK) është një masë e nevojshme për t'i shndërruar bizneset e kësaj korporate, jo vetëm fitimprurëse por edhe tërheqëse, në investime private.

Ajo thotë se vetëm KEK-u mund të furnizojë dhe të shpërndajë energji elektrike në Mitrovicën e Veriut dhe se veprimet e Serbisë në atë rajon janë të jashtëligjshme. Ajo tregon se borxhet e konsumatorëve në Mitrovicën e veriut janë të mëdha. Flet ekskluzivisht për Revistën "Paqja", Ministrja e Energjisë dhe e Minierave, Justina Shiroka – Pula.

PAQJA: ***Znj. Shiroka–Pula! Kuvendi i Kosovës ka miratuar strategjinë për energjinë. A mund të na tregoni më gjerësisht rreth kësaj strategjie?***

SHIROKA - PULA: Në përputhje me kërkesat e Ligjit për Energjinë Elektrike gjatë vitit 2009, Ministria e Energjisë dhe Minierave (MEM) rishikoi Strategjinë e Energjisë 2005-2015, dhe bazuar në atë përgatit Strategjinë e Rishikuar të Energjisë për Periudhën 2009-2018.

Kjo Strategji bazohet në programin e Qeverisë për sektorin e energjisë, si dhe në platformën e politikës energjetike të Kosovës të mbështetur edhe nga Banka Botërore, Komisioni Evropian dhe USAID-i.

Strategjia e Energjisë 2009-2018 bazohet në një analizë të plotë që ne e kemi kryer për situatën e sektorit energjetik dhe nevojave për energji për periudhën 10-vjeçare (2009-2018).

Bazuar në këtë analizë, duke njohur nevojën për pjesëmarrje të sektorit privat, duke pasur parasysh obligimet që Kosova i ka në kuadër të Traktatit për Komunitetin e Energjisë, ne i identifikuam sfidat me të cilat përballemi dhe vendosëm objektivat strategjike që duhet t'i arrijmë për dhjetë vjet (2009-2018). Më këtë rast propozuam politikat, masat dhe programet ose projektet kryesore që do të duhet t'i zbatojmë në mënyrë që t'i arrijmë objektivat për sektorin energjetik.

Qeveria dhe MEM kemi si objektiv parësor që ta transformojmë dhe ristrukturojmë sektorin energjetik, ashtu që të tërheqim investimet e nevojshme private. Ndërkohë, integrimi i këtij sektori jetik me sistemet energjetike rajonale dhe evropiane përbën një tjetër prioritet të punës sonë. Vetëm kështu do të mund të plotësohen objektivat strategjike për përmirësimin rrënjësor të sigurisë së furnizimit të konsumatorëve vendorë me shërbime energjetike ekonomikisht të përballueshme dhe konkurruese.

Strategjia përfshin një periudhë kohore dhjetëvjeçare. Synimet dhe masat e parashikuara në të përbëjnë një vizion të qartë për disa aspekte kyçe me interes të lartë për zhvillimin e sektorit energjetik gjatë dekadës 2009-2018. Strategjia është e ndarë në dy pjesë.

Pjesa e parë përmban një paraqitje komplete, analizë të situatës aktuale dhe një analizë të progresit të arritur në sektorin energjetik gjatë periudhës 2006-2008.

Po ashtu, aty përfshihen edhe politikat e zbatuara deri më tani, siç janë kuadri ekzistues ligjor dhe rregullator; institucionet dhe ndërmarrjet ekzistuese energjetike; analiza e konsumit, prodhimit, bartjes dhe shpërndarjes së furnizimit të energjisë; progresi në sektorin e ngrohjes, gazi natyror, efiçiencës së energjisë dhe burimeve të ripërtërishme; mbështetja financiare publike; progresi në përgatitjen për ndërtimin e Termocentralit Kosova e Re si dhe progresi i arritur në fushën e integrimeve rajonale dhe evropiane.

Pjesa e parë e Strategjisë përfundon me një përmbledhje të analizës SWOT për sektorin energjetik të Republikës së Kosovës. Nga analizat e paraqitura në pjesën e parë të Strategjisë, janë identifikuar sfidat përpara sektorit energjetik, sfida këto ku mbështeten objektivat strategjike të shënuara në pjesën e dytë të dokumentit.

Pjesa e dytë e Strategjisë përmban parashikimin e nevojave për energji dhe mbulimin e tyre për periudhën 2009-2018, në total dhe për secilin sektor ekonomik; misionin dhe vizionin e Strategjisë; objektivat strategjike; politikat dhe masat priori-



ë ketë standarde evropiane

tare për realizimin e objektivave strategjike; perspektivën e integrimeve evropiane dhe bashkëpunimin ndërkombëtar; nevojën dhe masat për ngritjen e kapaciteteve institucionale vendore; dhe masat e parashikuara për zbatimin e kësaj Strategjie.

Strategjia synon përgatitjen e një kuadri të plotë ligjor dhe rregullator që do të mundësonte tërheqjen e investimeve të konsiderueshme private në sektorin tonë energjetik. Korniza rregullatore e sektorit energjetik të Kosovës synohet të jetë e plotë dhe e qartë në mënyrë që të arrihet besimi i investitorëve të huaj në të.

Është e rëndësishme të theksohet se edhe vizioni i Strategjisë, nëpërmjet investimeve private, do të mund të eliminonte jo vetëm barrën aktuale që sektori energjetik përbën për buxhetin e Kosovës, por mund të arrijë ta përmirësojë ndjeshëm sigurinë e furnizimit me energji dhe cilësinë e tij në periudhën afatmesme në vijim.

Strategjinë për Energjinë 2009-2018, MEM e ka përgatitur në bashkëpunim me Zyrën për Rregullatorin e Energjisë (ZRE), KOSTT, KEK, ngrohtoret e qyteteve, Ministrinë e Ekonomisë dhe Financave (MEF) dhe Ministrinë e Tregtisë dhe Industrisë (MTI).

PAQJA: ***Znj. Shiroka –Pula, a mund të na thoni çfarë të mire do t'i sjellë Kosovës kjo strategji?***

SHIROKA – PULA: Me masat që parashikojmë t'i ndërmarrim, një pjesë të të cilave kemi filluar t'i përgatisim, jemi të bindur se ky sektor energjetik do të arrijë të shndërrohet në një sektor të qëndrueshëm dhe të vetëfinancueshëm që do të ofrojë shërbime cilësore energjetike, ekonomikisht të favorshme për konsumatorët në Kosovë. Arritja e këtij objektivi parësor kërkon avancimin e reformave në sektor, për të mundësuar kështu tërheqjen e investimeve private, mbrojtjen e mjedisit dhe integrimin sa me të plotë dhe më të shpejtë të sistemeve energjetike të Kosovës me ato rajonale dhe evropiane.

Fokus të veçantë në Strategji ka arritja, sa më parë të jetë e mundur, e sigurisë së furnizimit të qëndrueshëm e cilësor me energji elektrike. Për këtë, rëndësi e veçantë i është kushtuar ndërtimit të kapaciteteve të reja gjeneruese të energjisë elektrike dhe rehabilitimit në kohën e duhur të TC Kosova B, të dyja këto me pjesëmarrjen e sektorit privat. E njëjta gjë parashikohet edhe për sigurimin e mjaftueshëm dhe të qëndrueshëm me linjit të kapaciteteve ekzistuese dhe atyre të reja gjeneruese në të ardhmen.

PAQJA: ***Znj. Shiroka –Pula, sa do të kushtojë zbatimi i kësaj strategjie dhe a ka nisur punën kjo strategji?***

SHIROKA – PULA: Puna për zbatimin e Strategjisë së Rishikuar të Energjisë ka filluar. Një pjesë e projekteve dhe programeve janë vazhdimësi e punës prej vitit 2006, kur ka filluar të zbatohet Strategjia e Energjisë 2005-2015. Një grup tjetër i masave dhe i projekteve të rëndësishme është duke u përgatitur sipas planit të paraparë në kuadër të Programit të Zbatimit të Strategjisë për periudhën afatmesme 2009-2011.



PAQJA: ***Znj. Shiroka –Pula, a mendoni se kjo strategji do të ketë standarde evropiane kur kemi parasysh se në çfarë gjendje janë termocentralet aktuale?***

SHIROKA – PULA: Patjetër që po. Strategjia synon zbatimin e masave që do të mundësojnë arritjen e standardeve evropiane mjedisore në Termocentralin Kosova B dhe patjetër respektimin e këtyre standardeve në Termocentralin Kosova e Re. Ndërsa Termocentralin Kosova A parashikojmë ta dekomisionojmë me futjen në punë të bllokut të parë nga Termocentrali Kosova e Re.

Plotësimi i obligimeve që rrjedhin nga Traktati i Komunitetit të Energjisë dhe procesi i integrimeve evropiane është një tjetër dimension i rëndësishëm i kësaj Strategjie të Rishikuar të Energjisë. Zbatimi i qasjes evropiane, sa i takon energjisë, mjedisit dhe konkurrencës, është në vëmendjen e kësaj Strategjie. Kjo do të mundësojë integrimin e sektorit energjetik të vendit tonë në sistemet energjetike evropiane. Vëmendje e veçantë po i kushtohet mbrojtjes së mjedisit nga emetimet ndotëse prej stabilimenteve energjetike.

PAQJA: ***Znj. Shiroka –Pula, partitë opozitare të Kosovës e kanë kritikuar strategjinë për energji dhe kanë kërkuar rrënimin e termocentralit "Kosovës A". Si e komentoni këtë?***

SHIROKA – PULA: Unë i kam falënderuar të gjithë ata që kanë kontribuar në finalizimin dhe miratimin e kësaj Strategjie. Mbështetja e Strategjisë sonë energjetike ka qenë e gjerë edhe nga opozita politike, e cila ka pasur disa komente, të cilat mendoj se në pjesën më të madhe janë përfshirë në atë që Kuvendi i Kosovës e miratoi si Strategji të Energjisë për 2009-2018. Sa i takon Termocentralit Kosova A, Qeveria është deklaruar tashmë për të. Mendoj se të gjithë dakordohen me atë që e kemi shënuar në Strategjinë e Energjisë, pra me parashikimin që këtë termocentral do ta largojmë nga puna gradualisht në periudhën afatmesme dhe plotësisht pasi të jetë futur në punë njëri nga blloqet e Termocentralit Kosova e Re. Vetëm kështu mund të sigurohet kostoja më e vogël e mundshme e furnizimit me energji elektrike në Kosovë, pra duke importuar sa me pak të jetë e mundur.

PAQJA: ***Znj. Shiroka – Pula, cili është statusi i kompleksit mineral të Trepçës në Mitrovicë?***

SHIROKA – PULA: Trepça është ndërmarrje në varësi të Agjencisë Kosovare të Privatizimit. Trepça po punon dhe rritja e çmimeve për produktet e saj në bursat e metaleve ka ndikuar pozitivisht në biznesin e saj.

Strategjia Minerale 2010-2025, që e kemi miratuar si Qeveri dhe që do ta përcjellim edhe në Kuvendin e Kosovës, parashikon ristrukturimin e Trepçës dhe përgatitjen e saj për tërheqjen e investimeve private në formën e partneriteteve

publike-private, duke filluar kjo me bizneset që do të rezultojnë se kanë potencialet më të mëdha fitimprurëse për vendin tonë. MEM ka iniciuar krijimin e një grupi punues ndërinstitucional për të përgatitur një propozim për Qeverinë, me disa opsione të mundshme dhe më të favorshme për ristrukturimin e Trepçës dhe përgatitjen e saj për të tërhequr investime.

PAQJA: ***Znj. Shiroka –Pula, çfarë përfitimesh sjell privatizimi i KEK-ut për zhvillimin ekonomik të vendit?***

SHIROKA – PULA: Privatizimi i KEK-ut nuk është qëllim në vetvete, por një masë e nevojshme për t'i shndërruar bizneset e kësaj korporate jo vetëm në fitimprurëse, por edhe për të tërhequr në sektorin e elektroenergjisë investimet e mëdha private që kërkohen për të rehabilituar dhe modernizuar stabilimentet elektroenergjetike.

Në këtë kuadër, synohet përfundimi i ristrukturimit të KEK-ut në përputhje me direktivat e KE-së dhe legjislacionit vendor në fuqi, ashtu që sektori elektroenergjetik të bëhet jo vetëm i vetëqëndrueshëm nga pikëpamja financiare, por të tërheqë investime private, pa të cilat nuk mund të përmirësohet ndjeshëm cilësia dhe siguria e furnizimit me energji elektrike, dhe të arrijë të kontribuojë ndjeshëm në zhvillimin e shpejtë ekonomik e social të vendit.

PAQJA: ***Znj. Shiroka –Pula, cila është gjendja momentale energjetike në vendin tonë?***

SHIROKA – PULA: Gjendjen momentale energjetike mund ta përshkruaj si të qëndrueshme. Kjo për faktin se të gjithë konstatojmë se gjatë vitit 2009 patëm furnizim më të mirë me energji, krahasuar me vitin 2008 dhe më të mirë akoma po ta krahasojmë me vitin 2007. Me mbështetjen financiare të Qeverisë, KEK-u ka arritur të sigurojë furnizim të qëndrueshëm me linjit të kapaciteteve ekzistuese gjeneruese, falë kjo edhe e punës të punonjësve të mrekullueshëm të kësaj korporate, si të atyre që punojnë në mihjen e linjitit, ashtu edhe të atyre që operojnë dhe mirëmbajnë termocentralet A dhe B. Por duhet edhe të them se gjendja energjetike mund dhe duhet të përmirësohet në të ardhmen. Për këtë po punojmë intensivisht që t'i përfundojmë reformat dhe ristrukturimin e KEK-ut dhe të ofrojmë sa më parë edhe investimet private të domosdoshme.

PAQJA: ***Znj. Shiroka –Pula, a mund të na thoni sa është borxhi momental i konsumatorëve ndaj KEK-ut?***

SHIROKA – PULA: Mendoj se më e rëndësishme se sa është borxhi aktual i konsumatorëve ndaj KEK-ut është fakti se konsumatorët duhet të ndërgjegjësohen për ta paguar energjinë që e konsumojnë. Sa më shpejt të arrijmë këtë, aq më mirë do të jetë. Pagesa e energjisë së harxhuar përbën detyrim ligjor, ndryshe ajo quhet thjesht vjedhje dhe si e tillë duhet të dënohet. Mospagesa e energjisë e bënë KEK-un të jetë me humbje dhe kështu, vetëm me mbështetjen financiare të Qeverisë, KEK-u mund të operojë. Duhet ta kuptojnë të gjithë se paratë e Buxhetit të Qeverisë që shkojnë për KEK-un, janë paratë e tyre që mblidhen nga taksat që ata i paguajnë. Kjo gjendje nuk mund të vazhdojë akoma. Kjo është njëra nga arsyet pse do të privatizohet KEK-u. Konsumatorët duhet të ndërgjegjësohen. Ata që nuk e paguajnë energjinë e harxhuar duhet ta paguajnë atë, përndryshe do duhet të përballen me ligjin dhe shkyçjen e mundësisë për të pasur energji. Për ata që nuk kanë vërtet mundësi për të paguar kujdeset Qeveria. Për të tjerët duhet dhe do të kujdeset ligji.

PAQJA: ***Znj. Shiroka –Pula, ditëve të fundit banorët në veri të Mitrovicës po hasin edhe në një problem, si dërgesa e faturave nga Korporata Energjetike e Serbisë. A mund të na thoni çka ka bërë ministria që ju udhëhiqni në këtë drejtim?***

SHIROKA – PULA: Më duhet të përsëris se politika energjetike që ne si ministri e kemi përgatitur parashikon që sistemi elektroenergjetik i Kosovës është një dhe i pandarë. Vetëm KEK-u mund të furnizojë dhe të shpërndajë energji elektrike në Mitrovicën e Veriut. Veprimet e Serbisë në atë rajon janë të jashtëligjshme. Të gjithë konsumatorët, përfshirë ata në veri të Mitrovicës, detyrohen ta paguajnë energjinë që e harxhojnë vetëm në KEK. Borxhet e konsumatorëve në Mitrovicën e Veriut janë të mëdha. KEK-u po punon për të rivendosur gjendjen në atë pjesë të sistemit të tij shpërndarës të energjisë elektrike. Institucionet ndërkombëtare janë në dijeni të plotë të asaj që po ndodh atje. Unë shpresoj se Serbia do të tërhiqet nga veprime të tilla, që nuk i shërbejnë askujt.

PAQJA: ***Znj. Shiroka –Pula, sa është e rrezikshme ndotja e ambientit nga djegia e linjitit?***

SHIROKA – PULA: Djegia e linjitit është njësoj si djegia e burimeve të tjera energjetike konvencionale. Qymyret gjatë djegies prodhojnë me shumë CO_2 se nafta ose gazi. Nga djegia e qymyreve prodhohet më se 50 % e energjisë në ShBA. Teknologjitë e djegies se linjitit sot janë mjaft moderne në botë. Të tilla do të jenë ato edhe në Termocentralin Kosova e Re.

PAQJA: ***Znj. Shiroka –Pula, shumë banorë të fshatrave dhe qyteteve përreth termocentraleve ankohen se kanë vështirësi për të jetuar në shtëpitë e tyre për shkak të ndotjes së ambientit. A keni ndonjë strategji për t'u dalë në ndihmë këtyre banorëve?***

SHIROKA – PULA: Unë bashkohem me shqetësimet e qytetarëve tanë që jetojnë pranë termocentraleve. Qeveria është mjaft e ndjeshme për këtë, prandaj po zbatohen edhe disa projekte të rëndësishme për mbrojtjen dhe rehabilitimin e mjedisit në rajonet pranë termocentraleve. Kërkohet kohë dhe shumë investime për t'i eliminuar të gjitha efektet negative mjedisore, sidomos të atyre të trashëguara. Por Qeveria e ka bërë të qartë se asnjë teknologji që ndot ose dëmton mjedisin në mënyrë të pariparueshme nuk do të lejohet të përdoret në të ardhmen.

PAQJA: ***Znj. Shiroka –Pula, a do të kenë qytetarët e Kosovës energji pandërprerë gjatë këtij viti?***

SHIROKA – PULA: Të themi të vërtetën, nëse qytetarët e paguajnë energjinë që harxhojnë, atëherë ajo nuk mungon. Në përgjithësi, furnizimi me energji ka qenë më i mirë në dimrin që sapo e kaluam dhe kjo tregon se mund të kemi energji të mjaftueshme nëse e paguajmë më mirë atë. Ajo që qeveria po kërkon nga KEK-u është që të shkyçen ata që nuk e paguajnë energjinë dhe të furnizojë akoma më mirë, pra pa asnjë ndërprerje, ata që e paguajnë atë.

Pra, energji ka dhe do të ketë edhe më shumë, por ajo duhet të paguhet. Përndryshe, kuptohet se për ata që nuk e paguajnë nuk do të ketë energji.

Ndërsa, me ndërtimin e kapaciteteve të reja gjeneruese, me investimet e shumta që po kryejmë në sistemin e bartjes të energjisë elektrike dhe me investimet që priten të kryhen nga investitori privat pas privatizimit të shërbimit të shpërndarjes së energjisë elektrike, cilësia dhe siguria e furnizimit do të përmirësohet ndjeshëm. ■

Roli i shoqërisë civile në mirëqenien e qytetarëve



Iljasa SALIHU

Në historinë e njerëzimit nuk janë të rralla rastet kur objekt ndërtimi dhe shembjeje ka qenë pikërisht shoqëria e thjeshtë civile. Ndërtimi i sistemit monist dhe shkatërrimi i po këtij sistemi, lulëzoi dhe u vyshk si rrjedhojë e shoqërisë civile. Ndërtimi i sistemit demokratik, duke u mbështetur edhe në vetë nocionin e tij, dukshëm ka të bëjë me faktorizimin e shoqërisë, me vendimmarrjen e shoqërisë, si dhe me lokalizimin e të mirave drejt shoqërisë së thjeshtë civile. Megjithatë, këtë të vërtetë vetëm në letër, ende sot e kësaj dite nuk kemi arritur ta shohim dhe ta shijojmë. Përkundër asaj se jetojmë në vende që flasin për demokraci po përballemi me raste që shpeshherë i përkasin edhe diktaturës, por sidoqoftë të paktën në këtë sistem (në pritje të ndonjë sistemi më të mirë) në vendet që deri-diku e respektojnë sistemin në fjalë, kemi jehonë të zërave të qytetarëve për ndryshime pozitive që nuk kërkojnë më derdhje të gjakut, por derdhje të djersës dhe harxhim të ngjyrës së penës.

Po e njëjta shoqëri, njëherësh kishte qenë edhe pastruesja e faturave të fëlliqura, fatura që i krijonin oligarkët barkmëdhenj, ashklat e së cilëve detyrimisht i gëlltitke populli.

Edhe ndër shqiptarët, zëri i shoqërisë civile nuk qe i venitur, zë i cili ndër vite u shoqërua me likuidime, burgosje, internime dhe dëbime. Pas tri luftërave "çlirimtare" shqiptare, kundrejt sllavëve barbarë, edhe në trojet tona - nga radhët tona, në cilësinë e shoqërive civile, nisi të ngrihet zëri kundër padrejtësive ekonomike, sistemore, politike, juridike, kombëtare e të ngjashme. Tanimë, për hir të epitetit, "vende demokratike" nuk po likuidohen këta thirrës të ndershëm, porse, kundrejt tyre në mënyrë institucionale po punohet për izolimin të tyre. Por, nga dita në ditë, jemi dëshmitarë të kohës së zhgënjimit qytetar, kur qytetarët pakënaqësinë e tyre e shprehin me mosdaljen në votime. Kjo aludon për fitoren e shoqërisë civile. Mosdalja në zgjedhje dëshmon pakënaqësinë me mishmashet e qeverisjes aktuale. Tash së fundi, dëgjuam prej ndërkombëtarëve një thirrje jo të zakonshme, duke ia bërë me dije qytetarëve se ka ardhur koha që vetë ta luftojnë korrupsionin, sepse parandalimi dhe luftimi prej lart ende qenka në fazën e sterilitetit.

Për më tepër rreth kësaj teme, ekskluzivisht për revistën "Paqja", do t'i japim hapësirë personave, të cilët në mënyrë permanente merren dhe mishërohen me brengat e qytetarëve, por jo në atë mënyrë si merren politikanët, por brengë e cila ndahet në terren me vetë qytetarët.



Arsim Sinani

Arsim Sinani, kryetar i Akademisë Diplomatike Shqiptare, dega në Maqedoni, në lidhje me temën, "Roli i shoqërisë civile në mirëqenien e qytetarëve" shprehet kështu: "Roli i shoqërisë civile është shumë i rëndësishëm, sepse shoqëria civile është një korrektor i pozitës dhe opozitës. Në rastin tonë, shoqëria civile mundohet të luajë rolin e vet, por duket se në të shumtën e rasteve i mungon pavarësia.

Një shoqëri e shëndoshë, bie fjala, nuk do të lejonte që në Maqedoni nga 1300 administratorë të punësuar mbi një mijë të qëndrojnë në shtëpi, një shoqëri civile s'do të duhej të lejonte diskriminim që u bëhet shqiptarëve në institucione të ndryshme. Në mbi 150 institucione nuk ka asnjë shqiptar të punësuar. Një shoqëri civile s'do të lejonte eksperimentet që bëhen dhe tentojnë të bëhen me fëmijët tanë. Përfundimisht, shoqëria civile do të duhet të jetë një mur i pakalueshëm për politikën ditore, por kjo nuk ndodh fatkeqësisht.

Një shoqëri civile do të duhej të kundërshtonte plogështinë e ministrave, zëvendës ministrave, drejtorëve, rektorëve, dekanëve, shefave të ndryshëm etj. Kjo te ne nuk ndodh, ose kur ndodh, ajo doemos vjen nga një OJQ e afërt me njërën parti.

Edhe pse shoqëria civile realisht nuk ka pushtet ekzekutiv roli i saj është shumë domethënës në shoqëritë moderne. Te ne duhet që OJQ-të të fillojnë të mendojnë pak më ndryshe, të dalin nga klishetë e përditshmërisë, t'i kundërshtojnë partitë politike dhe drejtuesit e institucioneve të ndryshme kur e kanë gabim. Servilizmi nuk i shkon askujt për shtati dhe e gjithë shoqëria humb nga kjo gjendje amorfe. Përfundimisht, mendoj se roli i shoqërisë civile nuk duhet të jetë roli i një qengji të butë që thith edhe donacione të ndryshme ndërkombëtare edhe donacione të fshehta nga partitë politike e pushteti që buron nga ta. Shoqëria civile duhet të luajë rolin e korrektorit, i cili i heton gabimet dhe të metat e pushtetit qoftë pozitar, qoftë opozitar. Heshtja nuk prodhon asgjë vetëm se i përkeqëson gjërat. Dalja nga kjo gjendje kërkon marrjen përsipër të rrezikut nga ana e vetë shoqërisë civile dhe individëve të caktuar, përndryshe këtë situatë nuk mund të vijë askush që të na e ndryshojë për të mirë.

Me projekte konkrete mund të ndikohet në ndërrimin e mentalitetit dhe në vetëdijesimin e popullatës dhe mendimit. Nëse nuk punohet në këtë drejtim, shoqëria jonë nuk do të lëvizë në asnjë drejtim dhe do të mbetet shoqëri pa perspektivë.



Bashkim Aliu

Ndërsa teologu dhe publicisti, Bashkim Alium në lidhje me këtë temë, mes të tjerash thotë: "Shoqëria civile në vendet me demokraci të zhvilluar kon-

siderohet zëri më i fortë i kërkesave të qytetarëve gjatë gjithë kohës, e jo vetëm në kohët e zgjedhjeve, siç ndodh shpesh me partitë politike. Shoqëria civile është zbuluese e anomalive, të cilat e ndjekin qeverisjen e pushteteve dhe si zakonisht ajo e ngre zërin për çështjet mjaft të ndjeshme, të cilat neglizhohen shpesh nga pushtetet për shkak të llogarive të tyre gjatë mandatit të qeverisjes, e që po ashtu neglizhohen edhe nga opozita si rezultat i mosgatishmërisë së saj që të prekë çështje të tilla të ndjeshme, të cilat edhe mund t'i kushtojnë shtrenjtë për karrierën e tyre politike. Zëri i shoqërisë civile është buria përmes së cilës qytetaret lëshojnë alarm për trajtimin jo adekuat të problemeve të tyre, e që ndodh të mos preken, edhe nga mediat si rezultat i trysnive politike, të cilat janë dukuri e zakonshme në hapësirat e Ballkanit dhe në shumë hapësira të tjera ende të pademokratizuara. Zëri i këtillë i fuqishëm i shoqërisë civile nuk e lë rehat "bosin" e kolltukut qeveritar, por domosdo e nxit t'i rishqyrtojë pozicionet e veta dhe të ndërmarrë diçka karshi kritikave që i drejtohen nga shoqëria civile.

Në hapësirat tona, zëri i shoqërisë civile vazhdimisht është duke u dëgjuar dhe duke fituar fuqi, duke prekur kështu çështje, të cilat politikanët, qofshin të pushtetit a të opozitës, nuk kanë guxim t'i prekin. Kjo shihet qartë në Maqedoni, Kosovë, Shqipëri e gjetiu. Krerët qeveritarë, në të shumtën e rasteve, nuk janë ngushtuar nga sulmet e oponentëve të tyre politikë, por pikërisht nga protesta e shoqërisë civile.

Por, domosdo duhet pranuar se, te ne, shoqëria civile akoma nuk është e konsoliduar dhe tërësisht e pa ndikuar nga politika, siç është në shume vende të tjera me demokraci të avancuar.

Vështruar nga aspekti islam, shoqëria civile inkorporohet në thëniet e të dërguarit të Allahut, Muhamedit, paqja dhe mëshira e Allahut qoftë mbi të, për domosdoshmërinë e thënies së të vërtetës para pushtetarit të drejtë; po ashtu nevojën e këshillimit të masës dhe elitës politike për lëshimet e bëra; si dhe detyrimin e luftimit të të keqes në tri format e njohura: me aktivitet konkret fizik, me fjalë dhe, së fundi, me ndjenja.

Sot, shoqëria civile është e fokusuar më së tepërmi në çështjen e mbrojtjes së të drejtave të grupeve të margjinalizuara; mbrojtjes së ambientit dhe demaskimin e politikave imperialiste të fuqive ekonomike".


Metush Sulejmani


Në lidhje me këtë temë, morëm prononcim edhe prej profesorit universitar dhe sociologut Metush Sulejmani, i cili mes të tjerash u shpreh: "Koncepti për shoqërinë civile, që nga paraqitja e saj në mendimin politik anglez në shek. XVI-të, ka pasur shumë kuptime. Në kushtet dhe kontekstin e tanishëm, shoqëria civile kuptohet si një hapësirë politike, e cila manovrimin e saj e përqendron jashtë partive politike, në formimin e rregullave që udhëheqin jetën shoqërore. Në shoqëritë demokratike dhe në kushtet e zhvillimit të demokracisë parlamentare, shoqëria civile luan një rol jashtëzakonisht të madh në ekuilibrimin dhe dinamizimin e proceseve shoqërore me tendencën e zgjidhjes së shumë problemeve shoqërore. Shoqatat me karakter joqeveritar i ndërlidhin qytetarët mbi një bazë vullnetare, që t'i modelojnë ligjet formale, rregullat dhe normat joformale në mënyrë që t'i rregullojnë marrëdhëniet shoqërore. Shoqëria civile, përmes shoqatave joqeveritare, i bashkon njerëzit të cilët i ndajnë bashkërisht përpjekjet për shumë çështje konkrete politike, ekonomike, sociale, ekologjike, etj. Aktiviteti i këtyre shoqatave qeveritare të shoqërisë civile shpeshherë përqendrohet në kampanjën kundër varfërisë, dukurive sociopatologjike, kriminalitetit shtetëror, kundër ndotjes së ambientit, etj. Shoqëria civile, veçanërisht, është efektive dhe produktive në shoqëritë që kanë dalë nga ish-sistemet socialiste-represive dhe totalitare, sepse këto shoqëri akoma nuk janë reformuar dhe transformuar në shoqëri demokratike. Këto tipe të shoqërive kanë nevojë për kufizimin e fuqisë së shtetit dhe pushtetit, me qëllim që të respektohen liritë dhe të drejtat elementare të njeriut dhe për funksionimin e shtetit juridik. Sistemi shumëpartiak dhe demokracia parlamentare nuk mund të jenë funksionale pa veprimin dhe aktivitetin e shoqërisë civile. Këto shoqëri civile ndikojnë në korrektimin e gabimeve të partive politike, të cilat janë pjesë e pushtetit. Përmes shoqërive civile, qytetarët vetëdijesohen për të drejtat dhe liritë e tyre, kufizohet pushteti absolut dhe thellohet demokracia si formë e qeverisjes politike. Shoqëritë civile kanë struktura joqeveritare, të cilat e pasqyrojnë mendimin e lirë dhe të pavarur të qytetarëve në drejtim të përmbushjes së nevojave dhe interesave të tyre. Shoqëria civile iu mundëson qytetarëve formimin e organizatave dhe shoqatave joqeveritare me qëllimin e plotësimit të kërkesave të tyre, duke bërë presion në qendrat e vendosjes politike. Këto shoqëri, në qendër të vëmendjes, kanë individin dhe plotësimin e kërkesave të tij. Qytetari, në përgjithësi, paraqet një kategori mjaft komplekse ku shteti shpeshherë edhe nuk i plotëson interesat e tij, prandaj shoqëria civile



dhe organizatat joqeveritare janë të një rëndësie të veçantë. Pa një shoqëri të zhvilluar civile, edhe demokracia është jofunksionale dhe e brishtë, sepse zëri i qytetarëve duhet të dëgjohet dhe respektohet nga ana e elitës politike dhe shtetit. Kur bëhet fjalë për shoqërinë civile në Ballkan mund të thuhet se kësaj hapësire i ka munguar aktiviteti i kësaj shoqërie, sepse në të kaluarën shtetet më tepër janë përqendruar në ruajtjen e interesit global politik, duke i anashkaluar interesat parciale të qytetarëve. Në kushtet e udhëheqjes së shoqërisë nga ana e etatizmit, kur udhëheqësia bazohej në pushtetin centralist, shoqëria civile funksiononte në varshmëri dhe e ndikuar nga shteti. Prandaj kjo praktikë e qeverisjes politike, pas rënies së sistemit monist, mundësoi daljen në sipërfaqe të shoqërisë civile dhe organizatave joqeveritare. Në kushtet e tanishme të zhvillimit të botës bashkëkohore dhe të paraqitjes së një policentrizmi më të madh, shoqëria civile e riorienton aktivitetin e saj në një kah tjetër, aktivitet nga i cili përfitojnë qytetarët, duke bërë përpjekje të solidarizohet dhe t'i dalë në mbrojtje qytetarëve të saj.


Sajmir Lleshi

Rreth kësaj teme morëm prononcim edhe prej gazetarit dhe publicistit nga Tirana Sajmir Lleshit. "Jetojmë në kohën ku është përhapur kaq shumë dija, e megjithatë dituria e vërtetë duket se është një fantazmë që endet nëpër qytetet e tejmbushura, gjithsesi me plot njerëz të vetmuar. E nisa nga dija për të dalë më tej te roli i shoqërisë civile, pasi mendoj se vetëm me anë të ideve çelen "tunelet" pa dritë të shoqërisë njerëzore. Ndryshe ngase ndodhte më parë, ku njerëzia drejtohej nga fiset, sot, krejt tjetër, madje gjer në paradoks, qytetarët tanë janë anëtarësuar ose angazhuar në shoqata, me të njohur e me të panjohur. Kur në qendër vendoset e drejta e individit, atëherë "fisit" i humbet automatikisht e drejta për të vendosur si dikur. Tani, në epokën tonë të "ndritur", bashkimi i individëve të panjohur bëhet mbi interesin e përbashkët. Deri këtu, e gjithë përpjekja duket e drejtë. Një pyetje lind gjithmonë, edhe atëherë kur të gjitha përgjigjet duken se janë dhënë. A është edhe "shoqëria civile" pjesë e të gjitha mekanizmave që janë krijuar për të manipuluar historinë? Përgjigja është e gjatë dhe nuk rrekem për t'i gjetur një fund. Çdo individ në këtë qytet milionësh soj, ka të drejtën e tij që të ketë qëllime. Të kesh qëllim do të thotë të tentosh të arrish një objektiv. E nga kjo, në epokën moderne, individët organizohen në shoqata dhe në grupime shoqërore, ku nuk përfshihet e gjithë shoqëria, por segmente të saj intelektuale dhe vendimmarrëse. Një shoqatë, një organizatë, një forum, që të gjitha janë ngritur mbi qëllime. Bukur fort! Ndryshimet midis tyre janë parimet dhe konceptet me të cilat orientohen. Për mua kjo është "historia" që duhet trajtuar, sepse këtu nis gjendja e "konfliktit" midis individëve brenda së njëjtës shoqëri. Ne jemi që të gjithë qytetarë, por që të gjithë urrejmë të paktën një rregull të këtij qyteti. Kjo ka nisur në histori, por tani është bërë më e pranishme, veçse nuk ndeshen demonët, por përplasen idetë. Megjithatë, nihilizmi në kohën tonë është absurd dhe i kaluar. Ndaj, nuk duhet mohuar kurrsesi roli i shoqërisë civile, pasi vetëm duke u organizuar, njeriu arrin të gjejë suksesin dhe t'i heqë pengesat e barrierat e shumta që vetë shoqëria krijon. Në këtë mënyrë, luftohet edhe kundërshtari, ai "tjetri", që bie ndesh me idenë dhe qëllimin tonë. Fjala bie, një organizim fetar detyrimisht është i orientuar nga morali i shoqërisë. Por, plot organizime të tjera ku në përbërje është shoqëria civile kanë shkuar më tej, duke lobuar fort e madje edhe në sukses që qëllimet e grupeve të caktuara të interesit, të bëhen normë për shoqërinë. Lufta për barazinë e gruas me burrin, është njëra prej ideve të mëdha që po i injektohet vazhdimisht shoqërisë civile, e më tej masave të gjera. Kjo është një përpjekje e mirë në pamje të parë, por më tej bart pasoja të mëdha për shoqërinë njerëzore, ku familja tradicionale po rrënohet çdoherë e më shumë, ndërkohë që po i jepet rëndësi femrës karrieriste dhe beqare për një kohë të gjatë. Kjo është vetëm njëra prej pasojave dhe jo vetëm. Individi familjar dhe i dashur tashmë është bërë i ftohtë dhe social. UNI individual është shndërruar në një Un social, megjithëse pretendohet se të gjithë individët janë të



lirë dhe gjithashtu pretendohet se këta individë ndërmarrin vendime personale në jetën e tyre. Në fakt, kjo nuk ndodh dhe beteja për liri është shndërruar për pasojë në bumerang për individin, i cili tashmë më shumë se kurrë më parë ndodhet në "sulmin" e vazhdueshëm nga mediat, të cilat janë zëri i shoqërisë civile. Të shpërqendruar dhe, për pasojë, në pamundësi të një "vegle" kritike, ata janë dorëzuar, bërë njësh. Pyesim nëse shoqëria civile e ka rritur mirëqenien e shoqërisë? Një "PO" nuk do të kisha zemër ta thosha dhe as një "Jo", gjithashtu nuk mund të marrë guximin, paçka se mund të anoj disi nga kjo e fundit. Mungesa e vendosjes së një sistemi ideal, d.m.th, të gjithëpranueshëm, është një nga arsyet që qytetari modern po endet i shpërqendruar në pamundësi për të gjetur binarët që vetë shoqëria i ka çorientuar. E kështu, detyrimisht drejtohet për të gjetur "strehë" në shoqata, e prej andej për të transmetuar zërin e tij të dobët. Duket se individit po i jepet vlerë, por në fakt po zhvleftësohet edhe më, duke vënë si parësore dëshirat e tij të ulëta, atë lumturi të jashtme dhe jo lumturinë e vërtetë, atë që gjithë dijetarët e njerëzimit e kanë vlerësuar, pra lumturinë e shpirtit". ■



Mr. Muhamed J. KAJOLLI

Arbitrazhi

Meqë Aliu r.a. i përkiste familjes së Pejgamberit dhe ishte bartës i dijes dhe unitetit të muslimanëve, ai asnjëherë nuk pajtohej me realitetin e ndarjes së shtetit. Ai, deri në vrasjen e tij, u përpoq që t'i bashkonte muslimanët dhe për këtë shkak urdhëroi mobilizim të ri, me synimin që të marshonte sërish në drejtim të Sham-it, kundër prefektit të rebeluar, Muavi Ibën Ebi Sufjan-it

T'i nënshtrohemi gjykimit të Allahut të Lartmadhëruar! 'Fjalë ose koncept i bukur!' Por si do të zbatohej ky gjykim? Kjo gjë ka qenë dhe do të jetë gjithmonë e vështirë ndër njerëzit që kanë mendime kundërthënëse. Kush do të gjykonte me këtë Kur'an? Do të gjykonte drejtpërdrejt Allahu i Lartmadhëruar, apo do të dërgonte të tjerë që nuk i përkisnin qenies njerëzore, si p.sh. melekët? Jo, as njëra e as tjetra, sepse shpallja e Kur'anit ishte përmbyllur me vdekjen e Resulullahit s.a.v.s., i cili nuk kishte lënë ndonjë mesazh se gjykues i problemeve të njerëzve do të ishte drejtpërdrejt Allahu i Lartmadhëruar, ashtu siç kishte vepruar me popujt e mëhershëm të Ad-it, Themud-it, Musait etj., por gjykues të problemeve do të ishin njerëzit e përzgjedhur nga ummeti, të cilët do të gjykonin me anë të *Ligjeve të Kur'anit* dhe traditës së *Pejgamberit s.a.v.s.*

Këtë e kuptonin shumë mirë krerët e ushtrive ndërluftuese dhe disa komandantë[1], por nuk e kuptonin të gjithë komandantët e Aliut r.a. dhe masa e gjerë e besimtarëve luftëtarë. Një numër i madh i elitës së besimtarëve dhe disa sahabë me ndikim, ishin larg këtyre trazirave që të mund të jepnin kontributin e tyre në këtë moment vendimtar për ummetin. Aliu r.a., i detyruar nga injoranca e komandantëve të tij, u detyrua të pranonte ofertën e Muaviut. Pasi që Muaviu kishte një ushtri të disiplinuar, i buzëqeshi faktit kur nga pala e Aliut erdhi lajmi se pranonin të gjykonin sipas Kur'anit.

Meqenëse oferta ishte nga Muaviu, atëherë Aliu r.a. iu desh të dërgonte përfaqësuesin e vet, që të mësonte se çfarë kërkonte në realitet. Aliu r.a. dërgoi El Esh'ath Ibën Kajsin, ndërsa Muaviu i tha atij: Le të kthehemi tek urdhrat e Allahut, prandaj të dy palët le të zgjedhim nga një përfaqësues, të cilët do t'i zbatojnë urdhrat e Tij. Pa e zgjatur bisedën me të, Ibën Kajsi u kthye tek Aliu r.a., pasi vlerësoi se kërkesa e Muaviut ishte logjike dhe e pranoi atë.

Përçarja e ushtrisë së Irakut

Muaviu e kishte të gatshëm përfaqësuesin e vet. Ai ishte Amër Ibën As, këshilltari tij, i cili, me zgjuarsinë e tij, e nxori Muaviun nga humbja e madhe, pa asnjë ferrë në këmbë. Fatkeqësisht nuk ndodhi kështu në palën e Aliut r.a. Në momentin kur u ndërprenë luftimet, u pa se ushtria e Aliut r.a. ishte heterogjene dhe e padëgjueshme. Sa herë që jepej një propozim prej Aliut r.a., refuzohej nga ndonjëra prej palëve ndikuese. Injoranca e komandantëve të tij e la Aliun r.a. në udhëkryq. Përfundimisht, disa nga komandantët e Aliut r.a., me në krye me Esh'athin, u përcaktuan për Ebu Musa Eshariun. Pas një orvatje të re të Aliut për të caktuar ndonjë tjetër, ata ngulën këmbë dhe Aliu r.a. u detyrua të pranonte.



Për shkak të mosprezencës së Ebu Musait në Siffin, takimi i negociatave midis dy përfaqësuesve u shty për dhjetë ditë të tjera derisa erdhi Ebu Musa El Esharij. Ndërkohë ushtritë ishin pozicionuar secila në vendin e vet dhe uronin të merreshin vesh. Ebu Musa njihej si një person shumë i devotshëm dhe i ditur, por disa historianë këtë personalitet e nxjerrin si njeri që merrte me vështirësi vendime të prera. Më 17 Sefer të vitit 37 hixhri, ose gusht të vitit 657-të, u nënshkrua marrëveshja "...që Ali Ibën Ebi Talibi[2] me ushtrinë e tij, ashtu sikurse Muavije Ibën Sufjani bashkë me ushtrinë e tij, do t'i binden gjykimit të Kuranit. Do të marrin gjithçka që ai urdhëron dhe do të lënë gjithçka që ai ndalon.

Dy negociuesit, Ebu Musa dhe Amër Ibën As, qëmtonin fakte nga Kurani fisnik, të cilave iu duheshin përmbajtur. Nëse nuk mund të gjenin ndonjë ligj për zgjidhjen e këtyre mosmarrëveshjeve nga Kur'ani, atëherë do të hulumtonin thëniet dhe traditën e Pejgamberit s.a.v.s, duke shfrytëzuar çdo shans për të gjetur zgjidhjen e bashkimit e jo të përçarjes". Dita e takimit për fillimin e negociatave do të mbahej pas shtatë muajsh, në qytezën e quajtur Devmetul Xhendel një vend neutral midis Shamit dhe Kufes. Kjo datë përkiste me muajin e Ramazanit të po atij viti. (Taberij 5/35)

Këtë marrëveshje e parapëlqyen të gjitha palët[3], sepse dhanë garancitë e tyre se kjo marrëveshje do të respektohej për hir të bashkimit të umetit. Në këtë takim u caktuan edhe komisionet që do të kishin në përbërje nga dhjetë anëtarë për se-

cilën palë. Këto do të merreshin me varrosjen e të vrarëve dhe të plagosurit, si dhe mënyrën e tërheqjes.(Bidaje: 5/509) Pasi mbaruan, ushtritë u kthyen andej nga kishin ardhur. Ushtria e Muaviut u kthye në Sham, pa ndonjë përçarje në mesin e tyre, ndërsa ushtria e Aliut r.a. u kthye, por shumë e përçarë.[4] Më vonë, midis tyre lindën mendime dhe drejtime të reja, të cilat nuk përkonin me konceptin islam. Gjatë gjithë kësaj periudhe të armëpushimit, Aliu r.a u përpoq që t'i konsolidonte radhët e veta, por sa herë pendoheshin, dilte një grup i ri që kundërshtonte.[5]



Devmetul Xhendel

Erdhi koha e takimit në Devmetul Xhendel. Biseda do të zhvillohej midis Ebu Musa El Esharijut, i cili ishte në krye të katërqind ithtarëve të Aliut r.a.[6], por i cili nuk mund të thuhet se ishte militant i tij dhe Amër Ibën Asit, i cili gjithashtu ishte në krye të katërqind ithtarëve të Muaviut, por për dallim nga Ebu Musa ai ishte një militant i besueshëm i Muaviut.

Midis tyre si palë neutrale[7], të cilët do të dëgjonin se çfarë do të bisedohej dhe se çfarë do të vendosej aty, ishin caktuar:

Abdullah Ibën Omeri
Abdullah Ibën Zubejri
Abdurrahman Ibën Abdu Jeguth El Zuhrij
Abdurrahman Ibën Harith Ibën Hisham El Mehzumij,
Ebu Xheh Bin Hudhejve El Adevij
Mugire Ibën Shu'bete El Thekafij[8]

Dy palët ranë dakord që të shkruanin për çdo gjë që do të merreshin vesh dhe që asgjë të mos shkruhej pa pëlqimin e dy përfaqësuesve. Takimi zgjati disa ditë. Pas hyrjeve dhe argumenteve që prezantuan, të dy palët ranë dakord që Aliu r.a. të shkarkohej nga të qenit prijës i besimtarëve, gjithashtu edhe Muaviu të shkarkohej nga të qenit prefekt i Shamit. Pas pëlqimit për shkarkimin e këtyre dy figurave të dhembshme për të dy palët, u shtrua pyetja se cili do të ishte Kalif i ri i muslimanëve.

Abdullah Ibën Omeri tha Ebu Musa[9]. Ai filloi ta argumentonte mendimin e tij, duke e arsyetuar atë si njeriun më të aftë dhe më meritorin nga të gjithë të tjerët. Ai kishte qëndruar larg trazirave dhe me këtë qëndrim u përpoq të përcillte mesazhin e unifikimit të umetit. Amër Ibën As nuk kundërshtoi në parim dhe u ndanë. Në takimin tjetër të radhës tha: 'po sikur të bëhej Kalif djali im, sepse edhe ky është sahabij dhe është po aq meritor sa edhe Abdullah Ibën Omeri'.[10]

Djali i tij vërtet respektohej shumë në elitën muslimane. Ai shpeshherë e kishte këshilluar babën e tij që të tërhiqej nga kjo katrahurë midis muslimanëve, por ai shihte atë që dëshironte të shikonte. Për shkak se djali tij i kishte qëndruar pranë Muaviut në kohën e trazirave, Ebu Musa e refuzoi këtë propozim të tij.

Për fat të keq, në këtë takim nuk arritën të përcaktohen se cili do të ishte kandidati i vetëm për kalif. Situata e krijuar kërkonte që ata të dilnin me një kandidat, sepse ishte situatë shumë delikate. Megjithatë ata u shpërndanë prej atij takimi, duke mos u përcaktuar për Kalifin e tyre.[11] S'do mend se këtu kemi të bëjmë me mosnjohjen e sistemit të zgjedhjeve.

Sikur të kishin qenë të durueshëm dhe të mos shpërndaheshin nga ai takim, ata do të detyroheshin ta zgjidhnin problemin dhe me siguri që do ta gjenin shtegun e daljes nga ai ngërç politik. Ata e kishin modelin e zgjedhjes së Ebu Bekrit. Atyre vetëm ju duhej ta zbatonin atë formë të përzgjedhjes dhe kështu do të bëheshin gjenerata e parë njerëzore në botë, që do të kishte filluar ta praktikonte përzgjedhjen e shefit të tyre me anë të votës së lirë. Ky mospërcaktim do t'iu kushtonte shumë muslimanëve, aq sa prej asaj dite e deri më sot, mbase asnjëherë nuk do të arrinin më të zgjidhnin Kalifin ose prijësin e tyre me vota të lira.[12]

Kur Aliu r.a. mori vesh për rezultatet e takimit u zemërua tej mase. Ai nuk mund të besonte se ata paskëshin qenë aq të cekët, sa të pajtoheshin të dilnin nga ai takim pa marrëveshje ose, të paktën, pa përcaktuar kandidatin për Kalif të ri. Ai do të mbante fjalimin e tij përpara masës së gjerë, "duke ua përkujtuar atyre se çfarë do të thoshte që në momente të vështira të mos dëgjohej fjala e prijësit të tyre. Ai ju tha se po të dëgjohej në Siffin, ai do ta kishte zgjidhur atje këtë problem, por kur nuk respektohet fjala e të parit, do të ketë mjerim. Për këtë arsye Aliu r.a. takimin e Devmetul Xhendel e quajti të pa vlerë." (Bidaje: 5/515)

I këtij mendimi ishte edhe Muaviu. Edhe ai e quajti takimin e Devmetul Xhendelit të pavlerë, por tani pozicioni i tij në krahasim me Aliun ishte shumë më i favorshëm. Aliu kishte probleme të mëdha brenda territorit ku ai sundonte, ndërsa Muaviu në Sham kishte qetësi të plotë. Pas mossuksesit të këtij takimi, lirisht mund të thuhet se shteti i muslimanëve po shkonte drejt ndarjes së përgjithshme në dy shtete. Në një mënyrë, të dy personalitetet do të përpiqeshin ta zgjeronin epërsinë e tyre nëpër territoret e regjioneve brenda këtij shteti me territor shumë të madh.

Meqë Aliu r.a. i përkiste familjes së Pejgamberit dhe ishte bartës i dijes dhe unitetit të muslimanëve, ai asnjëherë nuk do të pajtohej me realitetin e ndarjes

së shtetit. Ai deri në vrasjen e tij do të përpiqej që t'i bashkonte muslimanët[13] dhe për këtë shkak do të urdhëronte mobilizimin e ri, i cili do të synonte të marshonte sërish në drejtim të Sham-it, kundër prefektit të rebeluar Muavi Ibën Ebi Sufjan-it. ■

Në numrin e ardhshëm: Lindja e sekteve

---

1 Nëse bazohemi në tregimin e Jakubit, do të mësojmë se ai që tradhtoi ishte Esh'ath Ibën Kajs. Muaviu i paska dërguar mesazh se do ta bënte prefekt të Jemenit, nëse do ta ndihmonte në ndalimin e betejës. Kur u ngritën Kur'anët, Aliu tha se kjo është një hile, sepse këta nuk e njohin Kur'anin dhe nuk punojnë sipas tij. Esh'athi i tha: Duhet të pranojmë atë që shohim. Në të kundërtën unë do të iki, ose do të mbaj anën e tyre. Filloi një grindje midis Esh'athit dhe Eshterit saqë nuk plasi lufta midis tyre. Kur Aliu e pa këtë skenar, ai u detyrua që të pajtohej me mendimin e Esh'athit, i cili edhe i përzgjodhi për negociator Ebu Musa Eshariun, e jo Abdullah Ibën Abasin. (Jakubi: 188/189) Tregim të përafërt kanë rrëfyer edhe Dinuri: 128 dhe Taberiu nga transmetimet e Ebi Mihnef-it.

2 Gjatë marrëveshjes u tha që: Marrëveshja lidhet midis Emirit të besimtarëve Ali Ibën Ebi Talib dhe Muaviut. Në këtë rast Amri tha: 'Jo! Sikur ta pranonim si Kalif nuk do ta luftonim, por shkruaje midis Ali bin Ebi Talibit dhe Muavi Ibën Sufjanit'. Kështu kishte ndodhur kohë më parë edhe në marrëveshjen e Hudebijes, prandaj Aliu pranoi të shkruhej ashtu siç kishte kërkuar Amri, sepse ai vetë e kishte shlyer thënien midis Muhamedit të Dërguarit të Allahut dhe..., prandaj buzëqeshi sepse ra në të njëjtën pozitë që kishte rënë Resulullahi s.a.v.s. (Taberij 5/34)

3 Përfshirë këtu të gjithë ata komandantë që thyen urdhrin e Aliut r.a.

4 Brenda këtij afati kohor të armëpushimit, prej mbi shtatë muajsh, midis palës së Muaviut dhe Aliut nuk do të kishte fërkime, por brenda radhëve të Aliut do të lindnin fraksione të reja, të cilat do të bëheshin shkaktare të trazirave shumë të përgjakshme, për të cilat do të shkruajmë në temën tjetër.

5 Disa analistë theksojnë se Aliu r.a. kundërshtohej si rezultat i frikës ndaj marrëveshjes midis palëve rivale. Sa më të përçarë që ishin Shami dhe Iraku, aq më të qetë ishin vrasësit e Osmanit r.a. dhe përkrahësit e tyre në mënyrë verbale. Për këtë arsye lindën fraksionet fetare tek irakianët e jo gjetiu.

6 Meqenëse Aliu nuk kishte besim të plotë tek Ebu Musai, ai do të caktonte Abdullah Ibën Abasin si prijës të namazit për katërqind ithtarët e tij. Njëkohësisht ai do të luante rolin e këshilltarit të parë.

7 Shumë pak janë ata historianë të cilët thonë se midis tyre ishte pala neutrale, ose mund të thuhet se historianët e tjerë nuk i kanë dhënë rëndësi palës neutrale. Sidoqoftë, mendimi i atyre që kanë sjellë emrat mund të jetë më i saktë (Allahu e di më së miri).

8 Këta janë emrat e theksuar nga Ebi Mihnef, në Tarihu El taberij 5/44.

9 Në një letër të cilën ia ka dërguar Ibën Omeri Ebu Musasë thuhet: "...më propozove pa e ditur mendimin tim. Vërtet mendoje se do të pranoja postin, të cilin ma ka ndalur babai im dhe vërtet mendoje se do të pranoja të dilja përpara Aliut, kur ai qëndron më lart se unë me të gjitha cilësitë e tij. Veprimi yt ishte i papërgjegjshëm dhe dole si humbës. Kështu hidhërove Aliun dhe Muaviun." (Dinuri:139)

10 Duke qenë se Amër Ibën Asi ishte militant i besueshëm i Muaviut, ai ishte i interesuar që takimi të përfundonte pa rezultat dhe ia arriti qëllimit. Këtë mendim e bazoj në këshillën e Muaviut që ia dha Amrit: "...paraqite forcën e Shamit dhe tregohu se ithtarët tanë qëndrojnë prapa një fjalë. Ndërsa kur të flasësh për palën e irakianëve, paraqiti si të pavlerë dhe përçarës..." (Dinuri: 135)

11 Versionet e dhëna nëpër librat kryesorë të historisë islame rreth paraqitjes së dy personaliteteve, kur ata dolën përpara ithtarëve të tyre që të tregojnë për marrëveshjen e arritur, se Amër Ibën Asi e tradhtoi Ebu Musanë, si duket nuk qëndrojnë. Por një gjë dihet fare mirë se paraqitja e kësaj marrëveshje nëpër librat e historisë, sipas versionit të tyre, ka shkaktuar vëllavrasje dhe ndryshim të parimeve të Islamit midis sunitëve dhe shiitëve. Gjenerata jonë dhe shpresoj edhe gjeneratat e ardhshme nuk duhet t'i marrin për bazë përplasjet e kësaj kohe, por le të përqendrohen në afrimin e medhhebeve të bazuar në Kur'an dhe vetëm në hadithet e vërteta. Neve, si besimtarë, nuk duhet të na përçajnë ngjarjet historike. Bile këto ngjarje duhet të na forcojnë më shumë që ta largojmë ndikimin e shejtanit midis nesh.

12 Këtu do të veçoja disa shtete, të cilat kohët e fundit kanë dhënë provat e tyre në zgjedhjet parlamentare ose presidenciale dhe lokale, sikurse që janë Malajzia, Pakistani, Irani, Turqia dhe Libani. Të gjitha shtetet e tjera kanë zgjedhje të brishta, ose nuk i mbajnë fare ato, sikurse që kemi rastin e shteteve monarkiste.

13 Përgjigja e Aliut (Zoti e fisnikëroftë fytyrën e tij) dhënë vëllait të tij Akilit: "...Sa i përket interesimit tënd lidhur me mendimin tim për luftën, me të vërtetë, deri sa ta takoj Allahun tim, do të jem në anën e atyre të cilët këtë luftë e konsiderojnë legjitime. Shumësia e njerëzve përqark nuk më jep fuqi plotësuese, as shpërndarja e tyre nuk më shkakton aspak vetmi. Mos e konsideroni, pra, birin e babait të vet kurrsesi të ligsht ose të frikësuar, edhe nëse të gjithë e braktisin, ose përkulen me përvujtni para drejtësisë, ose i dorëzojnë frerët e tyre në dorë të atij i cili i tërheq zvarrë, ose lejojnë që kalorësi të hipë në shpinë të tij. Ngase ai është, siç tha vëlla Benu Selimi:

Nëse më pyet "Si je?" le ta dinë bota mbarë
ndaj stinëve të kohës jam i fortë dhe durimtar!
që në fytyrë t'më çahet pikëllimi nuk lejoj:
Sa e gëzoj shpirtligun, shokun e pikëlloj. (Nehxhul Belaga: 264)

Një zonë ... edhe nga...

Arsim JONUZI

Çeçenia e zhytur në mjerim e luftë vazhdon të mbetet si duket kompromisi i heshtur në mes Rusisë dhe komunitetit ndërkombëtar. Ky vend i lënë në harresë me vite të tëra përballet me kërdi, tmerre e llahtari të mëdha, por që mbeten të papublikuara nga një terr informativ që ka pllakosur rajonin.

Luftimet dhe vrasjet në Kaukazin Verior po vazhdojnë edhe më tej. Krahas Ingushetisë, në rrëmujë është zhytur edhe Dagestani. Edhe pse zyrtarët rusë dhe evropianë ende nuk po e shohin këtë fakt, situata vazhdon të jetë tejet shpërthyese. Presidenti pro-rus i Çeçenisë, Ramsan Kadyrov, po tenton të krijojë përshtypjen se e ka nën kontroll situatën në Çeçeni. Njësitë e Ministrisë së Brendshme dhe ato të shërbimit të fshehtë janë angazhuar në luftë kundër një grupi kryengritësish. Presidenti Kadyrov, ka ofruar ndihmën e tij. Njerëzit e tij janë të gatshëm t'u bashkohen forcave të sigurisë në Ingusheti dhe të përfshihen në këtë "operacion special". Së paku, në dukje të parë, Kadyrov e ruajti optimizmin e tij. "Pjesa më e rëndësishme e bandave kryengritëse është shkatërruar. Tani lufta po zhvillohet kundër elementeve të shkapërderdhura të këtyre bandave," - i tha Kadyrov agjencisë ruse të lajmeve Interfax. Ai me këtë rast, me gjasë, harroi se të njëjtën gjë e kishte thënë edhe vitin e kaluar. Edhe pse askush nuk e di numrin e saktë të kryengritësve, sipas Kadyrovit, në Çeçeni ai nuk është më i madh se disa dhjetëra. Pra, pse të bisedohet me ta?! Kadyrov vitin e kaluar kishte theksuar se numri i kryengritësve është rreth 70. Që nga ajo kohë, agjencitë e lajmeve kanë njoftuar në vazhdimësi për vrasje të kryengritësve, por numri i kryengritësve thjesht nuk po zvogëlohet. Ka gjasa që numri i kryengritësve të jetë shumë më i madh. Vaha Umarov, i vëllai i kryesuesit të kryengritësve çeçenë,



e harruar a lajmet

Doku Umarov, thotë se vëllai i tij vetëm në Çeçeni komandon 3 mijë luftëtarë. Sipas tij, në Kaukazin Verior veprojnë gjithsej 5 mijë kryengritës të armatosur. Vaha Umarov thotë se ata financohen dhe furnizohen me armë nga njerëzit e afërt me Kadyrovin. Umarov sjelljet e tyre i arsyeton me faktin se ata dëshirojnë të sigurohen, nëse ndodh që Kadyrovi një ditë të eliminohet. Doku Umarov tani synon që emiratin e tij ta shtrijë në gjithë rajonin e Kaukazit, e deri te republikat në Vollgë. Në Moskë ky synim i tij është cilësuar si qesharak. Megjithatë, Gjykata Supreme e Rusisë e ka njohur në mënyrë indirekte emiratin e Umarovit, duke e ndaluar veprimtarinë e organizatës, e cila zyrtarisht nuk ekziston. Dhe jo pa arsye. Kryetari i Komitetit Islamik të Rusisë, Gaidar Xhemal, e cilësoi emiratin si një "strukturë me ndikim dhe një organizatë efektive", e cila operon në Ingusheti, Dagestan, Çeçeni dhe në disa republika të tjera në Kaukaz. Organizata po mbështetet nga të rinjtë, të cilët po i bashkohen asaj, për shkak të papunësisë dhe varfërisë ekstreme. Shërbimi i fshehtë i Rusisë tenton ta lidhë këtë organizatë edhe me Al Qaidën. Për Kadyrovin naiv nuk ka asnjë dyshim se Umarovi mbështetet nga shërbimet e fshehta perëndimore. Sipas tij, ato po e financojnë kryengritjen e tij për të dobësuar dhe shkatërruar Rusinë. Kadyrov është i mendimit se pa mbështetjen e Perëndimit, organizata e Umarovit do të ishte shkatërruar që moti. Megjithatë, ai si duket nuk e kupton se copëtimi i Rusisë nuk është aspak në interes të Perëndimit. Nëse shpërthen Kaukazi, atëherë pasojat do t'i ndiente Evropa. Pra, stabiliteti në Kaukaz është në interes të evropianëve, të cilët me interesim po e përcjellin punën e të dërguarit të ri të presidentit Dimitri Medvedev në rajon. Alexander Chloponin, i dërguari i ri i Medvedevit në Kaukaz, është zyrtari i parë civil, i cili është përgjegjës për vendosjen e rregullit dhe për rindërtimin e rajonit. ■

Parimet e dialogut dhe afrimi ndërmjet rrymave islame[1]

Dr. Jusuf el-KARDAVI

Pas ngjarjes së 11 shtatorit të vitit 2001, shumë njerëz, si në Lindje ashtu edhe në Perëndim, bënë thirrje për dialogun midis feve, veçanërisht asaj krishtere dhe islame.

Shumica iu përgjigj kësaj thirrjeje dhe si rezultat i kësaj muslimanët dhe të krishterët u takuan gjatë kongreseve të shumta, që u mbajtën nëpër disa vende të ndryshme anembanë botës.

Unë, personalisht, kam prezantuar në dy kongrese të tilla. Njëri prej tyre u mbajt në Romë, me ftesën e një organizate të njohur botërore. Ishte ky një kongres, i cili për shkak të rëndësisë së atyre që morën pjesë në të, nga të dy palët, u quajt *"Kulmi islamo-krishter"*.

Kongresi i dytë u mbajt në Kajro, me ftesën e Këshillit më të Lartë Botëror për Propagandë dhe Ndihmë dhe Shoqatës së Dialogut Islam. Ky kongres u përqendrua më tepër te të krishterët e Lindjes. Po ashtu, kam marrë pjesë edhe në disa kongrese e tubime të tjera, ndonëse ato ishin në një shkallë më të ulët se këto dy që përmendëm.

Brenda botës islame, shumë njerëz klithin me zë të lartë: Përse nuk bashkëbisedojnë muslimanët ndërmjet tyre? A nuk është kjo më primare? A nuk thotë i Dërguari a.s: "Fillo me vetveten, pastaj me atë për të cilin përkujdesesh?"

Le të analizojmë: A ekziston ndërmjet neve muslimanëve mospajtim më i madh se sa ndërmjet neve dhe feve të tjera? Përse, pra, atëherë nuk bashkëbisedojmë, me qëllim të mirëkuptimit dhe afrimit të ndërsjellë?

S'ka dyshim se logjika e fesë dhe e diturisë, si dhe realiteti, vërteton se muslimanët duhet t'i kushtojnë më tepër rëndësi dialogut ndërmjet tyre, sesa me të tjerët që u përkasin feve të ndryshme.

Nëse e kemi parasysh faktin se ne jemi të obliguar të bashkëbisedojmë me ithtarët e feve të tjera, sipas fjalës së të Lartësuarit që thotë:

"...Dhe diskuto me ata në mënyrën më të mirë!" (En-Nahl : 125), a thua nuk është më primare të bashkëbisedojmë me ata me të cilët na bashkon besimi i vetëm, kibla e vetme dhe fjala: *"La ilahe il-lall-llah, muhammedun resul-ull-llah"*?

Për këtë arsye, besoj se përqendrimi ynë lidhur me dialogun islamo-krishter nuk guxon ta anashkalojë vëmendjen tonë mbi dialogun islamo-islam, e posaçërisht dialogun ndërmjet dy grupeve më të mëdha: sunni dhe shi'ij, me qëllim të afrimit midis tyre nga e vërteta.

Takimi, dialogu dhe këmbimi i mendimeve na ndihmon që ta kuptojmë njëri-tjetrin, na afron ndërmjet vete, e largon vrazhdësinë, krijon dashurinë, qartëson shumë turbullira, mënjanon shumë dyshime. E tërë kjo do të arrihet vetëm atëherë kur të pastrohen qëllimet, kur të vërtetohen synimet, kur të forcohen vullnetet, kur të ngadhënjejë mendja mbi pasionet, urtësia mbi nxitimet, si dhe mesatarja mbi teprimet.

Vlen të përmendet fakti se ekziston një faktor i rëndësishëm, i cili e thërret tërë botën islame në përgjithësi, me të gjitha rrymat, shkollat, ideologjitë dhe fraksionet e saj – të afrohet, të bashkohet dhe të njësohet ndërmjet vete. Është ky një faktor i cili paraqet rrezik permanent për tërë botën islame, në përgjithësi dhe i cili synon ta shkatërrojë atë në tërësi, nëse nuk i del në pritë.

Ai është një rrezik të cilin e përbëjnë së bashku: hebrenjtë, të krishterët dhe politeistët. Ndonëse ndërmjet tyre ekzistojnë mospajtime të shumta, ata i ka bashkuar armiku i përbashkët, që është Islami. Të vërtetën e ka thënë Allahu i Lartësuar:

"... Mizorët janë mbrojtës të njëri-tjetrit, kurse Allahu është mbrojtës i të devotshmëve". (El-Xhathije : 19)

Edhe nëse botës islame i është lejuar – e në të vërtetë kjo nuk i lejohet – të ndahet në kohën e paqes dhe stabilitetit, ajo assesi nuk guxon të ndahet në kohën e luftës dhe fatkeqësisë, pasi që vështirësitë i bashkojnë të përçarët, sprovat i bashkojnë të ndarët, ndërsa rreziqet i afrojnë të largëtit.

Allahu e mëshiroftë poetin e njohur e të madh arab, Ahmed Shevkiun, i cili kishte thënë:

"Fatkeqësitë i tubojnë fatkëqijtë!"

Nga arabishtja: Jahja Hondozi

1. Pjesë e shkëputur nga tema: "Parime mbi dialogun dhe afrimin ndërmjet rrymave islame", e Jusuf El-Kardavit, të cilën e mbajti në kongresin që mban titullin: "Afrimi mes doktrinave islame dhe ndikimi i tij në realizimin e unitetit të popullit islam". Ky kongres u mbajt në Mbretërinë e Bahrejnit, më 20-22/9/2003.

Gruaja muslimane - shqiptare

Emine A. VEZAJ



Tash kur jemi në një vit jubilar, 1400 vjetorin e Kur'anit, po edhe në 25 vjetorin e përkthimit të Kur'anit në gjuhën shqipe, përkthimit të parë dhe të plotë nga prof. dr. Feti Mehdiu, duket se është me interes të flitet edhe për rolin e gruas shqiptare në ruajtjen, kultivimin dhe mësimin e Kur'anit te gjeneratat e reja.

Praktika islame e pjesëmarrjes së gruas në mësimin e fesë ndërmjet të kaluarës dhe të tashmes:

Të gjitha të dhënat historike, që nga koha e Pejgamberit a.s. dhe e shokëve të tij besnikë, faktojnë se gruaja muslimane i ka kryer obligimet e saj ndaj Allahut të Madhërishëm me përpikëri dhe përkushtim të thellë fetar. Përveç kësaj, ajo gjithsesi gëzon edhe të drejta të garantuara nga Vetë i Madhi Zot. Spekulime të tilla nga qarqe jo islame se gruaja në Islam duhet të jetë një bashkëshorte nën urdhrat e burrit dhe se duhet të izolohet brenda mureve të shtëpisë, sa janë të pabaza, po aq janë edhe të palogjikshme. Islami i dha gruas një vend meritor në shoqëri, duke e respektuar si bashkëshorte, si nënë, si motër, por pa harruar asnjëherë edhe pozitën të cilën ia caktoi në jetën e saj sociale.

"... Unë nuk ia humb mundin asnjërit prej jush, mashkull qoftë a femër. Ju jeni nga njëri-tjetri..." (Ali Imran, 195). Ajete si ky dhe të ngjashëm me të, në të cilët i Madhi Zot në mënyrë të veçantë i drejtohet dy gjinive, duke mos përjashtuar asnjërën palë në shpërblim, sqarojnë se sa përgjegjëse është gruaja në kultivimin e një shoqërie të shëndoshë dhe sa përgjegjësi ka ajo në edukimin e brezit të ri.

Në kohën e Pejgamberit a.s., rreshtat e fundit në xhami gjithmonë iu janë rezervuar femrave, nëse nuk kishte ndonjë anë tjetër brenda xhamisë ku ato do të mund të kryenin ritualet e tyre fetare. Në fillim ato hynin dhe dilnin nga e njëjta derë e xhamisë nga e cila dilnin edhe burrat, por pas konsultimit të Pejgamberit a.s. me Ibën Umerin, grave iu caktua një derë e posaçme nga e cila hynin në xhami për t'i kryer ritualet. Madje edhe sot e kësaj dite kjo derë, e cila gjendet në xhaminë e Pejgamberit a.s në Medine quhet *"dera e grave"* (babu – n - nisa). Nuk duhet të na e humbë aspak kontrollin edhe ndonjë hadith antagonist që dëgjojmë në lidhje me rastin, por Pejgamberi a.s. u kishte thënë botërisht sahabëve të tij: *"Mos ua ndaloni shërbëtoreve të Zotit (grave) shtëpitë e Zotit (xhamitë)"*. Tradita profetike na mëson se, përveç namazeve që gratë kanë bërë në xhami, ato kanë qenë pjesëmarrëse edhe në ligjëratat, të cilat janë mbajtur nga Pejgamberi a.s. Umu Seleme rrëfen se si ishin ankuar një grup grash te Pejgamberi a.s: *"Meshkujt na e kanë bërë të pamundur pjesëmarrjen (për shkak të kallaballëkut) në ligjëratat e tua, prandaj caktoje një ditë vetëm për ne"*.

Sot, gruaja muslimane, e edhe gruaja shqiptare, duhet të jetë e prirë të ndjekë praktikën e hz. Ajshes, gruas së Pejgamberit a.s dhe koloses së dijes. Për hir të së vërtetës, duhet bërë publik fakti se nga ajo u transmetuan 2210 hadithe. Ajo ishte gruaja më pedante dhe më inteligjente e shoqërisë muslimane. Duke qenë gruaja e Pejgamberit a.s,, s'ka diskutim se sa pedanteri dhe sa kujdes kishte ajo në transmetimin e haditheve dhe në shpërndarjen e dijes te të gjithë muslimanët. Me këtë,sidoqoftë, nuk duam vetëm të pasqyrojnë një realitet të gruas muslimane, por duam të theksojmë edhe një numër grash të tjera të shoqërisë islame që kanë kontribuar dhe ende kontribuojnë në mesin në të cilin jetojnë. Shembulli i hz. Ajshes, mund të jetë shembulli më i mirë sepse krahas kësaj, duke parë se mësimet e fesë, dhe në veçanti të mësuarit e Kur'anit gjeneratave të reja, jo vetëm që është privilegj, por vetë Kur'ani garanton shpërblim për ata që kontribuojnë në mësimin dhe lartësimin e fjalës së të Madhit Zot. Nga kjo, shumë gra filluan të shpërndajnë dijen dhe të jenë pjesë e pandashme e thirrjes dhe udhëzimit në fe. Pejgamberi a.s thotë: *"Më i miri prej jush është ai që e mëson Kur'anin, e njëherësh ua mëson edhe të tjerëve"*, madje shpërblimi që ka garantuar i Madhi Zot për lexuesit e Kur'anit shumëfishohet për çdo lexim. Pejgamberi a.s. na garantoi se: *"Ai që e lexon një shkronjë nga Libri i Allahut, shpërblimi për të s'është një, por një shpërblim (tek Allahu) është i barabartë me dhjetë"*.

Nëse sot shohim një gjendje relativisht të mirë në mësimin e Kur'anit, meritën duhet t'ia kushtojmë jo vetëm hoxhallarëve, të cilët kanë kontribuar në xhamitë e tyre, por edhe përkthyesve të parë të Kur'anit në gjuhën shqipe, atyre të cilët tashmë fjalën e Zotit nuk e lanë vetëm në dispozicion të ligjëruesve nëpër xhami që iu përkthenin dhe iu shpjegonin besimtarëve pjesë nga Kur'ani, por që kontribuuan që çdo njeri i interesuar të ketë mundësi të takohet me fjalën e Zotit dhe që t'i kuptojë edhe në gjuhën e tij këto porosi

dhe kontakti i saj me Kur'anin

e urtësi të Allahut Fuqiplotë. Besimtarët muslimanë shqiptarë që e përdornin Kur'anin në jetën e tyre të përditshme gjatë ushtrimit të riteve kishin nevojë që këtë libër të shenjtë ta kishin edhe brenda dy kopertinave në gjuhën e tyre. Fragmente të Kur'anit në gjuhën shqipe i hasim qysh herët në letërsinë e bejtexhinjve, pra nga shek. XVII-të për të vazhduar më vonë në shek. XVIII-të e sidomos në atë të XX-të ku në përgjithësi mbretëronte përkthimi i verseteve të caktuara për nga tematika. I tillë është p.sh. *"Libri i të falmës"* i Hfz. I. Dalliut. Me rëndësi të madhe është të theksohet se ndër aktivitetet intelektuale, teologjike dhe kulturore, në përgjithësi, edhe përkthimet e Kur'anit, të bëra aty këtu në këto periudha, kontribuuan në zhvillimet e mëtejshme të traditës së të punuarit me Kur'an. Me këtë u hap një horizont shumë i gjerë dhe mundësi e shpejtë si për leximin e teologjisë, ashtu edhe për zhvillimin e saj në një mënyrë më të shpejtë. Për këtë punë, natyrisht përkthyesit janë renditur në radhët e "dëshmorëve" të teologjisë muslimane shqiptare. Teologu shqiptar çdoherë do t'u mbetet borxh këtyre punëtorëve.

Më 1921, Ilo Mitko Qafëzezi bëri botimin e parë të përkthimit të tekstit të Kur'anit në shqip, ku përfshihet afërsisht 1/3 e tij. Një hap më tutje në fushën e përkthimit të Kur'anit e bëri Hfz. Ibrahim Dalliu. Ai, në vitin 1929, botoi *"Ajka e kuptimeve të Kur'ani Qerimit"*, që konsiderohet një përkthim me kompetencë teologjike. Një përkthim tjetër ka ndërmarr edhe Hfz. Ali Korça, pjesë të të cilit janë botuar edhe në shtypin shqiptar. Përkthimi i plotë i Kur'anit në gjuhën shqipe, për shumë arsye, u arrit të bëhej vetëm në mesin e viteve '80, por ky përkthim nuk u botua për shkaqe të ndryshme.

Botimi i parë i plotë i Kur'anit në gjuhën shqipe u bë në vitin 1985, në Prishtinë, nga Feti Mehdiu. Ky përkthim, për vlerat e veta të veçanta në aspektin gjuhësor, pati jehonë të madhe në publicistikën kosovare dhe më gjerë. Ishte rasti i parë që Kur'ani me përkthim në gjuhën shqipe ishte i plotë në duart e besimdrejtëve. Përkthimi dhe botimi i dytë i plotë i Kur'anit u bë në vitin 1988 nga profesor Hasan efendi Nahi nga Kosova. Përkthimi i tretë i plotë i Kur'anit është bërë nga H. Sherif Ahmeti, po më 1988, nën kujdesin e Kryesisë së Bashkësisë Islame të Prishtinës. Tani kemi edhe një përkthim të katërt në gjuhën shqipe. Ai është i Muhamed Zekeria Khanit i vitit 1990. Ndërkohë që ekziston edhe një Kur'an i kompletuar në gjuhën shqipe për personat e verbër, përkthimi i H. Sherif Ahmetit me alfabet Brait, i dalë nga shtypi në prill 2008.

Qëllimisht i përmenda të gjitha përkthimet e Kur'anit në gjuhën shqipe, por për fat të keq jam e detyruar që për këtë çështje shumë të rëndësishme të shkruaj përmes një ankimi për teologun e hapësirës sonë, sepse më duket se në aspektin e kulturës teologjike jemi tejet të varfër, në fakt, siç thotë Dr. Ismail Bardhi "të pastrehë". Njohës të gjuhës arabe kishte mjaft si në Shqipëri, por edhe Kosovë, por vështirësia ose "pakujdesia" ndaj Kur'anit duket se ishte gjetiu. Ata (teologët) nuk ishin origjinalë; pse i braktisën trojet tona, pse shkruan në gjuhë të "huaj", pse lejuan që teologu ynë të jetë i varur nga faktorët e jo-teologjisë; pse lejuan që respekti ndaj teologut të komercializohet ose të humbasë fare, pse lejuan që fuqia e teologëve tanë të bëhet vetëm fuqi eskatoligjike... edhe pse në të kaluarën tonë figurojnë shumë emra të shquar të kulturës fetare ose teologë me nam, si hoxhë Tahsini, Vehbi Dibra, Hafëz Ali Korca, hafëz Ibrahim Dalliu, Mulla Idrizi, Sherif Ahmeti Ataullah Efendiu, etj... Ne megjithatë nuk guxojmë të jemi të kënaqur vetëm me emrat dhe veprat e tyre. Teologjia shqiptare, prej vitit 1935 e deri në vitin 1988, ka qenë krejtësisht "e pensionuar". Kjo paraqet një periudhë relativisht të gjatë kohore, e cila lë pasoja shumë të dëmshme për kulturën fetare, jo vetëm për vetë këtë kulturë, por edhe për kulturën në përgjithësi, të cilën për çdoherë do ta shohim konfrontuese... (Dr. I. Bardhi)

Sidoqoftë, pas kësaj kthese radikale me përkthimin e Kur'anit në gjuhën shqipe, kontakti i gruas me librin e





shenjtë, nuk ishte më një "mollë" e ndaluar, sepse tash është vetë gruaja, e cila e mban Kur'anin më afër se çdo gjë tjetër, i bën vendin më të bukur në vitrinë, e fut në ndonjë sirtar ku nuk mund ta kapë asnjë pluhur, e vendos mbi çdo libër të rëndomtë. E gjithë kjo, sigurisht se ishte një ogur i mirë për gratë muslimane shqiptare. Qëndrimi i heshtur, mospërfillës dhe mohues ndaj arsimimit dhe edukimit të gruas në mësimin e Kur'anit, mjerisht, në të shumtën e rasteve vinte nga vetë hoxhallarët, të cilët nuk i jepnin hapësirë grave dhe bijave të tyre të vizitonin xhamitë, t'iu mësonin leximin e Kur'anit, t'i udhëzonin në Islamin burimor. Madje duhet pranuar se shumica e grave muslimane, pavarësisht riteve fetare që i kanë mësuar aty-këtu, fatkeqësisht i kanë mësuar me shumë gabime, pavarësisht veshjes islame që kanë mbajtur, kanë qenë më shumë të detyruara nga tradita sesa nga mësimet e fesë. Kontakti i gruas muslimane-shqiptare me mësimet e fesë "falë" rasteve që rridhnin nga jeta familjare si syneti, mevlude, qelime e të pame, në mungesë të leximit të plotë të Kur'anit, nuk ishte edhe shumë shpresëdhënës. Edhe sot, paraqitja e disa modifikuesve të "devotshëm" të normave burimore fetare, gjegjësisht e disa "efendilerëve" që mëtojnë ta privojnë gruan nga participimi në bashkësinë muslimane, kam frikë se është analogji e tmerrshme nga e kaluara.

Sigurisht, medalja ka dy anët e saj. Në kontekst të kontributit të gruas muslimane-shqiptare në mësimin dhe leximin e Kur'anit gjeneratave të reja duhet përmendur Binaze Kacabaçi – Dauti, pseudonimi i së cilës ishte "hoxhe hanëm". Qytet i lindjes së saj ishte Prizreni, por duke qenë e detyruar të ndiqte prindërit e saj, ajo bëri një jetë endacake. Shkollën fillore e kreu në Edrene dhe atë normale e bëri në Stamboll, ku edhe shërbeu për pesë vjet. Më vonë u shpërngul në Gjilan. Në vitin 1920, ajo hapi një shkollë për vajza në shtëpinë e saj në Gjilan. Edhe pse në mënyrë klandestine, vullneti i saj nuk mungoi asnjëherë. Krahas kësaj, duhen kujtuar edhe shumë vajza të tjera që kishin mësyrë Sarajevën, pikërisht për faktin që mësimet e Kur'anit t'i kenë platformë për jetën e tyre. Të tilla mund të përmendim si Lumnije Sinani – Ibrahimi, Ikballe Berisha – Huduti, Meleq Lezi, Emine Huduti – Ballëk, Sabahate Lezi, Resmije Ajeti, Hasibe Talaj, etj.

Duke qenë se besimtarët muslimanë dita-ditës ngjeshin radhët e tyre, çdo ditë e më shumë vetëdijesoheshin për rolin e pazëvendësueshëm që zë gruaja në një shoqëri të hapur. Me unanimitet të plotë, në vitin 1997, nën patronatin e Bashkësisë Islame të Kosovës, në bashkëpunim dhe koordinim të plotë edhe më Medresenë e Prishtinës, vendosën që krahas medresesë së djemve, edhe vajzat të kenë një vatër të dijes, nga e cila do të mësonin fjalën e bukur islame dhe do ta përcillnin edhe te brezat e rinj. Me zgjerimin e Medresesë, duke hapur edhe një paralele për vajza, u mor vendim që edhe Prizreni, si vend i historisë dhe kulturës islame, të ketë një paralele të ndarë fizike nga ajo e Prishtinës. Medreseja e Prizrenit deri më sot ka nxjerrë një numër të konsiderueshëm vajzash teologe të mirëfillta, të cilat jo vetëm që tashmë e shkruajnë dhe e lexojnë bukur Kur'anin, por i njohin edhe shkencat e tjera islame. Sot, Medreseja në Prizren, që nga viti 1997 kur edhe filloi gjenerata e parë, numëron 411 nxënës të regjistruar në këtë shkollë, me 152 të diplomuar. Ky angazhim rezultoi me faktin që në qershor të vitit 2005, në Fakultetin e Studimeve Islame në Prishtinë, diplomuan kuadrot e para të gjinisë femërore; studente të dalluara dhe të vyeshme sikur Ardiana Alishani, Ilire Halimi, Esma Morina, Mirije Xhezairi – Xhoxhaj dhe Emine Vezaj. Ngjarjet si këto s'do mend se u mirëpritën sigurisht me gëzim të madh nga të gjithë besimdrejtit.

Vërtet që në përmasa pak më të gjëra dhe në krahasim me disa popuj të tjerë që kanë kontribuar shumë më shumë për kulturën dhe qytetërimin islam, kjo që është bërë te ne as edhe nuk mund të krahasohet madje, por megjithatë zhvillimet e këtilla të mirëfillta, japin mundësinë e shpresës dhe uratës se edhe te ne (qoftë edhe me vonesë) ka një prirje drejt ripërtëritjes së mendimit islam. Kjo tregon idenë e çiltër të gruas muslimane shqiptare në nduarnduarjen e plotë me urtësitë e Kur'anit.

Shikuar nga perspektiva e sotme (edhe pse ajo që kemi arritur deri tani është e pamjaftueshme) vërehen përparime dhe aktivitete. Sot kemi teologe shumë të vyeshme, të cilat xhaminë e kanë shtëpi të dytë, ndërsa nxënësit i kanë familje jobiologjike. Krahas punës së vazhdueshme që bëjnë në xhami, me punën e tyre janë dëshmuar edhe në shumë tribuna anë e mbanë Kosovës. Gruaja muslimane shqiptare, sot, është nënë e shkëlqyer, mësuese e brezave të ri dhe akademike në fakultet.

Allahu nuk ia humbet mundin askujt. Le ta dëshmojmë atë me nijet të pastër! ■

Ministria e Arsimit nuk i njeh ligjet për të drejtat e njeriut

Hekuran AVDYLI

Duke u bazuar në ligjin e Ministrisë së Arsimit, Shkencës dhe Teknologjisë, në rregulloren e të cilës tërthorazi ndalohet bartja e shamive në shkollat fillore e të mesme, drejtori i shkollës së mesme "Pjetër Bogdani" në Ferizaj, Isuf Çelaj, përjashtoi nga shkolla nxënësen Arlinda Zekaj, duke vepruar kështu kundër Kushtetutës së Kosovës, kundër Konventës Evropiane për mbrojtjen e të drejtave dhe lirive themelore dhe kundër dokumenteve të tjera të rëndësishme botërore që merren me rregullimin e të drejtave të njeriut. Të pakënaqur me këtë vendim, qindra qytetarë nisën marshin protestues nga ndërtesa e Qeverisë së Kosovës për t'u ndalur para ndërtesës së Ministrisë së Arsimit, Shkencës dhe Teknologjisë. Organizatorët e protestës mbajtën edhe një fjalim rasti, ku u sqaruan shumë dobësi dhe gabime në rastin e marrjes së vendimit për largimin nga shkolla të vajzave me shami. "Rasti i fundit i largimit të nxënëses Arlinda Zeka, dhe i shumë nxënëseve të tjera në të kaluarën e afërt, nga procesi i rregullt mësimor 'arsyetohet' në bazë të një paragrafi të një udhëzimi administrativ të Ministrisë së Arsimit, Shkencës dhe Teknologjisë të Kosovës, që thotë se ndalohet bartja e uniformës fetare. Fakti që na irriton edhe më tepër ka të bëjë me vendosjen e këtij citimi në udhëzimin i cili ka të bëjë me krime të rënda, si trafikimi i qenieve njerëzore, terrorizmi etj." - tha Arsim Ajvazi, drejtues i kësaj proteste. Sot në Kosovë, edhe pse liria e shumëpritur dhe e paguar shtrenjtë erdhi, ajo nuk po zbatohet për të gjithë qytetarët e saj. Një rast i tillë është edhe mohimi i të drejtës së shkollimit të nxënësve që bartin shaminë, siç është rasti i Arlindës. Kushtet në të cilat ndodhet tani Kosova bëjnë që vendi ynë, me mbi 95% të përkatësisë fetare islame, të përkufizohet si shtet laik (sekular – feja nuk ka të drejtë vendimmarrjeje në shtet), por kjo nuk nënkupton se duhet të luhet me ndjenjat e popullit. Ky parim në Kosovë është duke u keqpërdorur dhe, për pasojë, kemi shkeljen e vrazhdë të të drejtave elementare të njeriut, siç janë liria e edukimit fetar në shkollat publike, si dhe liria e respektimit të normave fetare në rastin e veshjes që bartet në institucionet publike. Pra, "laicizmi ose ndarja e fesë nga shteti nuk nënkupton ndarjen e vlerave fetare nga institucionet publike, por ndarjen e institucioneve fetare prej vendimmarrjes së çështjeve shtetërore". Kjo nuk mund të justifikohet për ta ndaluar një të drejtë elementare dhe të natyrshme për nxënësit muslimanë, porse ky manipulim i rëndë, që i ka rrënjët në interpretimin komunisto-ateist të parimit të laicizmit, ka shkaktuar dhe vazhdon të shkaktojë pasoja të rënda në shtetin tonë. Se janë shkelur të drejtat themelore të njeriut, mund ta shohim edhe nëse i hedhim një sy dokumenteve më prestigjioze evropiane e botërore për liritë dhe të drejtat e njeriut.

Kështu:

1. Në nenin 9 të Konventës Evropiane për Mbrojtjen e të Drejtave dhe Lirive Themelore të Njeriut, e hartuar më 4 nëntor 1950, përpos të tjerash thuhet: "Çdo person gëzon lirinë për të shfaqur fenë e vet ose bindjet e veta individualisht ose kolektivisht, publikisht ose privatisht nëpërmjet kultit, arsimit, praktikave, etj". Në pikën që theksohet arsimi, ligji ynë për arsim bie ndesh me këtë konventë.

2. Sipas Konventës Amerikane për të Drejtat e Njeriut "Pakti i San Hozesë", themeluar më 22 nëntor 1969, në nenin 12, pika 4, pos të tjerash thuhet: "Prindërit ose kujdestarët kanë të drejtë të sigurojnë arsimin fetar dhe moral të fëmijëve ose të atyre që janë nën përkujdesjen e tyre". Sipas ligjit tonë, prindërve dhe kujdestarëve iu është mohuar një e drejtë e tillë.



3. Në Konventën për luftën kundër diskriminimit në fushën e arsimit, miratuar nga Konferenca e Përgjithshme e Organizatës së Kombeve të Bashkuara për Arsim, Shkencë dhe Kulturë, themeluar më 14 dhjetor 1960, në nenin 5, pika b), pika 2, pos të tjerash thuhet: "Vendet duhet të bëjnë që të sigurohet arsimi fetar dhe moral i fëmijëve, konform bindjeve të tyre…. ".

4. Protokolli në konventën evropiane për mbrojtjen e të drejtave të njeriut, themeluar në 20 mars të vitit 1952, pos tjerash thotë: "…E drejta për shkollim dhe e drejta e prindërve në dhënien e këtij arsimimi në përputhje me bindjen e tyre fetare dhe filozofike".

5. Në Deklaratën për eliminimin e të gjitha formave të mosdurimit e të diskriminimit në bazë të fesë dhe bindjes, e miratuar në Asamblenë e Përgjithshme të Kombeve të Bashkuara, themeluar më 25.11.1981, në nenin: 1/1, pos të tjerash thuhet: "Gjithkush gëzon të drejtën e lirisë…… dhe të mësimit fetar".

Kjo na bën të kuptojmë se qeveria jonë, e cila synon ndryshimin e ligjeve të sistemeve të kaluara të imponuara, në realitet vetëm se i mbështet ato pa i ndryshuar aspak. Kjo na bën të pyesim se: A s'jetojmë në Evropë? A jemi duke shkuar drejt Evropës? Pse ata që janë kompetentë nxjerrin ligje që janë në kundërshtim me vetë konventat e Evropës? Deri dje kemi jetuar me frikë në shpirt dhe me shpresë të shuar për të shprehur lirshëm edukimin, shkollimin, fjalën, fenë, etj. E sot kur jemi të lirë, në vendin tonë, në shtëpinë tonë, në shtetin tonë, në atdheun tonë, të na mohohet liria më shumë se kurrë më parë?! Siç duket, qeveritarët tanë po na sjellin ligje që, në fakt, janë në kundërshtim me kushtetutën dhe me shtatë konventat ndërkombëtare për lirinë dhe të drejtat e njeriut. E me çka tjetër jo?!!! .. ■

Vullkanet më rrezik se t



Agim AVDIU



Nga mesi i majit, hapësira ajrore në veri të Italisë u mbyll sërish. Kësaj radhe përkohësisht, si pasojë e reve vullkanike që përfshinë këtë pjesë të vendit. Vendimi për mbylljen e hapësirës ajrore u mor nga Enac (Enti italian për trafikun ajror). Mirëpo të hapura, megjithatë, qëndruan aeroportet e Venecias, Triestes dhe Riminit. Edhe në buletinin e Eurocontrolit (Enti evropian për trafikun ajror) theksohej se një pjesë e hirit vullkanik ka përfunduar mbi hapësirën ajrore të Italisë Veriore dhe se është kërkuar ndalimi i fluturimeve. Reja e hirit vullkanik mbuloi edhe pjesët jugore të Francës dhe të Zvicrës, duke shkaktuar mbylljen e disa aeroporteve dhe duke penguar fluturimet në gjithë kontinentin. Reja e hirit gradualisht dobësohej, gjatë përhapjes së saj në pjesët jugore të Gjermanisë, Çekisë dhe të Austrisë. Reja e hirit ishte e pranishme edhe në Spanjë dhe Portugali, me ç'rast e pengoi dukshëm punën e aeroporteve në Porto, La Korunja, Vigo dhe Santiago. Austria, Belgjika, Kroacia, Republika Çeke, Danimarka, Estonia, Britania e Madhe, Lituania, Letonia, Finlanda, Hungaria, Holanda, Norvegjia, Serbia, Sllovenia, Polonia, Rumania, Zvicra, Ukraina, etj, ishin shtetet ku trafiku ajror ishte plotësisht i paralizuar nga hiri vullkanik që shpërtheu në Islandë.

Pra vullkanet, krahas dëmeve të tjera të njohura, mund të bllokojnë edhe fluturimin e avionëve, për shkak të hirit që lirojnë në lartësi të mëdha.

Në botë janë rreth 1500 vullkane aktive. Rreth 50 janë aktualisht në erupsion, por vetëm 11 janë konsideruar si shumë të rrezikshme, sipas një liste të hartuar nga Universiteti i Karolinës së Veriut, që llogarit si fuqinë e vullkanit ashtu edhe praninë e njerëzve afër kratereve. Në këtë listë, krahas Pinatubos, që në vitin 1991 nxori shumë gaz dhe hi saqë ndikoi në klimën e planetit për dy vitet pasardhëse, ekspertët kanë futur edhe Vezuvin. Eyjafjallajokull arriti të bllokonte trafikun ajror, por konsiderohet i rrezikshëm vetëm në rast të erupsionit të "vëllait" të tij më të madh, Katlas, të vendosur vetëm pak më tej. Lista përfshin edhe vullkane si Chaiten në Kili, që është nën vëzhgim të rreptë sidomos pas tërmetit të shkurtit, Krakatoa dhe Merapi në Indonezi, ose Mount Rainer në Uashington. Male të tjerë në prag të një erupsioni të rrezikshëm gjenden në Kongo (Nyirangongo), Kolumbi (Nevada del Ruiz), Meksikë - Popocatepetl dhe mali Fuxhi, kërcënues për Tokion. Një raport i agjencisë ajrore evropiane në vitin 2007 ka llogaritur se 500 milionë persona në botë jetonin shumë pranë një vullkani aktiv për t'u konsideruar të sigurt. Rreth 90 për qind e 1500 vullkaneve aktive është përqendruar në 400 mijë kilometrat e "unazës së zjarrit" në Paqësor. Por tym dhe llavë del vazhdimisht edhe nga dy vullkanet italiane Stromboli dhe Etna, të monitoruar nga Instituti Kombëtar i Gjeofizikës dhe Vullkanologjisë. Erupsioni më i theksuar u vërejt një javë më parë, 1500 metra nën nivelin e detit, mes Fuxhit dhe Samoas. Për të inspektuar vullkanin ishte e domosdoshme ndërtimi i një telekamere të aftë për t'iu rezistuar temperaturave në brendësi. Eyjafjallajokull konsiderohet një 'personazh' i dorës së dytë në botën e vullkaneve, edhe pse tregoi se ishte i aftë të nxirrte 300 metër kub dhe 750 ton llavë, duke ngritur në qiell një re gjigante hiri, që për tri ditë arriti 140 milionë metër kub dhe kaloi lartësinë prej 10 kilometrash, për t'u vendosur më pas në një lartësi



tërmetet

Vullkanet

Vullkanet për t'u mbajtur nën vëzhgim

- Fuxhi (Japoni)
- Katlas (Islandë)
- Chaiten
- Krakatau
- Merapi
- Vezuvi
- Pinatubo
- Mount Rainier
- Nevada del Ruiz
- Popocatepl
- Nyirangongo (Kongo)

prej 4-5 mijë metrash, duke krijuar një situatë të paprecedent për shkak të rrezikut që mund të paraqesë për avionët. Në zonat e prekura, ajri është shumë i ngarkuar me elektricitet sa mund të krijojë një rrufe spektakulare çdo katër orë. Por lajmi i vetëm i mirë në rastin e vullkaneve qëndron në faktin se ato, ndryshe nga tërmetet, mund të parashikohen nga gjeologët, pasi japin vazhdimisht sinjale alarmi. Përreth kratereve më të rrezikshme gjeologët kanë ndërtuar një rrjet monitorimi për të parë deformimin e tokës, daljen e gazit nga nëntoka, tronditjet e vogla dhe ndryshimin e rrjedhës së ujërave. Zakonisht erupsioni ndodh kur toka poshtë vullkanit nis të fryhet sikur merr frymë, ndërsa korja tendoset. Nga qielli satelitët vëzhgojnë deformimin, qoftë ky edhe pak centimetra, që akumulohet ditë pas dite. Pastaj mali nis të dridhet. Vullkani pëson një sërë lëkundjesh që sizmografët i regjistrojnë. Më vonë vjen shpërthimi, i cili shoqërohet me një zhurmë që nxjerr në sipërfaqe shumë nga përbërësit prej thellësisë së tokës. Për t'i regjistruar ato janë shpikur aparatet me infratinguj që përdoreshin për të kontrolluar eksperimentet bërthamore në zonat më të largëta të globit. Tani janë "stetoskopët" e vendosur në gjoksin e vullkanit. "Mjekët" që merren me evoluimin e vullkaneve në këtë moment janë shumë të shqetësuar. Jo për shkak të Eyjafjallajokullit, aktiviteti i të cilit duket i qëndrueshëm tashmë. Ajo që nuk i lë të qetë është aktiviteti i vëllait të tij të madh, Katlas, i vendosur rreth 20 kilometra më në lindje, 5 herë më i madh, 100 herë më i fuqishëm, që mund të arrijë të krijojë në ajër re gjigante hiri të rrezikshme. Çdo ditë, në krah të tij, sizmologët regjistrojnë mesatarisht 3 mijë lëkundje të vogla, me një magnitudë që shkon deri në 3.1 të shkallës Rihter. Në janar tronditjet e përditshme ishin një ose dy në ditë. Përreth vullkaneve islandezë u regjistrua edhe një ndryshim i vazhdueshëm i rrjedhës së lumenjve. Pikërisht ishte ky ndryshim në prag të shpërthimit të Eyjafjallajokullit ai që i bindi autoritetet islandeze të evakuonin mijëra banorë që jetonin në afërsi të kësaj zone të rrezikshme. Tani veprimi i tij po shtrihet drejt Katlas. "Historia ka treguar se shumë rrallë Eyjafjallajokull lëviz pa aktivizuar edhe Katlan", shkruan raporti i "Globval Alliance for Disaster Reduction", i Universitetit të Karolinës së Veriut që ka hartuar listën e vullkaneve më të rrezikshme në botë. Vullkani më i madh, sipas ekspertëve amerikanë, është aq i mbushur me llavë saqë mund ta ngopë atmosferën me hirin që përmban shumë silic. Në rast të një erupsioni të tejzgjatur, përveç anulimit të fluturimeve pritet edhe një fenomen i quajtur: dimri vullkanik. Edhe situatat e mëparshme e konfirmojnë këtë: në vitin 1612 dhe 1821 erupsionet e Eyjafjallajokullit u pasuan brenda një kohe të shkurtër edhe nga rizgjimi i Katlas. Aktiviteti i njëkohshëm i dy vullkaneve islandezë nuk duket të jetë një rastësi. Shkrirja e akujve ka lehtësuar presionin që ushtrohej në ishullin e zjarrit, duke i dhënë mundësi magmës të dalë në sipërfaqe. Teza u pasurua nga vullkanologu Freysteinn Sigmundsson, i Universitetit të Islandës, në revistën "Geophysical Research Letters". "Për vitet e ardhshme në Islandë priten erupsione më të shpeshta dhe më të fuqishme. Ngrohja globale bën që akujt të shkrijnë më shpejt. Ky fenomen ka pasoja edhe te lëvizja e magmës në nëntokë", shpjegon gjeologu. Fundi i epokës akullnajore i ndodhur 10 mijë vjet më parë, koincidoi me një intensifikim të aktivitetit vullkanik në ishullin e akullit dhe zjarrit. Shkaku më i mundshëm është pikërisht shkrirja e shtresave të akullit në sipërfaqe dhe rifryrja e magmës në nëntokë. Ndërkaq, vullkani filipinas ka arritur te e gjashta nga një matës me tetë njësi që mat "treguesin e shpërthimit vullkanik". Erupsioni islandez nuk i afrohet fare kësaj shkalle dhe përveç mbylljes së aeroporteve nga Eyjafjallajokulli nuk priten pasoja të tjera. Dalja e gazrave dhe pluhurave të ndryshme në stratosferë konsiderohet nga shumë njerëz si një mënyrë e mirë për të ndalur ngrohjen globale. "Në rastin e Eyjafjallajokullit nuk mund të themi asnjë të tillë, sepse niveli i erupsionit ka qenë i vogël për të pasur ndikime te klima", - ka shpjeguar Olav Hygen, i Institutit Meteorologjik Norvegjez. Maksimumi, në 12-14 muajt e ardhshëm, veriu i Evropës mund ta shohë perëndimin me ngjyrë të kuqe të ndezur, që nuk është parë kurrë më parë. ■



Kurorëzimi i një artisteje

Imer TOPANICA

Natyrshmëria e artit është kërkesa për të gjetur të bukurën, prandaj artisti ka barrën më të rëndë nga të gjithë të tjerët. Dhe kur artisti e gjen rrugën e tij më të mirë për të dhënë atë më të mirën nga vetja, për ta realizuar veprën në mënyrën më të përkryer, ne e kuptojmë se ka sjellë diçka të mirë, por pa e kuptuar thellësisht si dhe në çfarë mënyre. "Para nji vjershe a një kuadri gjenial të gjithë thrrasim: "sa bukur", por vetëm ndonjëri din me tregue pse asht e bukur" - shkruan Arshi Pipa tek eseja brilante: "Shpirti kritik". Duke iu referuar kësaj thënie të Arshi Pipajt do të provojmë të arsyetojmë kurorëzimin me dekoratën e fundit Artiste e Merituar, të mbretëreshës së muzikës shqiptare, znj. Nexhmie Pagarusha. Epitetet e tilla që i janë veshur kësaj figure të rëndësishme të botës së muzikës, në realitet, duken të pamjaftueshme. Secili prej këtyre epiteteve përmbush tjetrin, duke plotësuar mozaikun e përkryer që ka historia e suksesshme e Nexhmie Pagarushës. Ajo është shndërruar në një shenjë të rëndësishme në historinë e kulturës muzikore shqiptare dhe në një ikonë të kësaj muzike. Dorëzimi i këtij titulli para pak ditësh, nga Presidenti i Kosovës, është një ngjarje e veçantë në historinë e re të Kosovës. E veçantë sepse kjo po ndodh në ditët e para të jetës së re të vendit tonë. Thënë ndryshe, historia e Kosovës ka shenjat e veta kulturore, si gjurmë të hapave të saj drejt lirisë. Njëra prej këtyre gjurmëve mban emrin: Nexhmie Pagarusha.

Retrospektivë

Nexhmie Pagarusha u lind në vitin 1933, në një familje me kulturë. Ajo pati një mbështetje të fuqishme, fillimisht nga familja e saj, nga i ati i saj që ishte me profesion mësues dhe gjatë gjithë karrierës, nga njerëzit që e rrethuan dhe bashkëpunuan me të. Kur ajo arriti t'i bënte hapat e parë, çdo gjë ishte e lehtë. Ajo shkëlqeu në secilën këngë që interpretoi. Zëri i saj ishte 'fajtor' që mori epitete aq të shumta, si: Bilbili i Kosovës, Mbretëresha e Këngës Shqipe, Primadona e Melosit Popullor, Ema Sumak Shqiptare, Madam Baterflaj, Fyti i Kristaltë e të tjera.

Mbeten të pashlyeshme interpretimet e këngëve si: Baresha, Ani mori nuse, Çil njat zemër plot kujtime, Kur më shkon si zog n'hava dhe shumë të tjera, ose thënë më drejt, krejt veprimtaria e saj ishte e tillë, shkëlqyese, si e një ylli që shpon qiellin dhe nuk shuhet më.

Ajo ishte aktive në skenë për afro 40 vite dhe gjatë kësaj karriere mori çmime të shumta, ndër të cilat këngëtare e shekullit, për hir të interpretimeve të papërsëritshme në muzikën popullore dhe opera. Mendohet të ketë interpretuar mbi njëqind e pesëdhjetë këngë nëpër koncerte të ndryshme të mbajtura në Kosovë, Shqipëri, Bullgari, Izrael, etj. Ajo i interpretoi po aq me sukses edhe veprat, e përkthyera në shqip, e kompozitorëve të mëdhenj botërorë, si Bethoven, Puçin, Verd, etj. Interpretimi më i mirë dhe kryevepra e saj konsiderohet kënga Baresha, një këngë e kompozuar nga bashkëshorti i saj i ndjerë, Rexhep Mulliqi. Tekstin e kësaj kënge e shkroi mjeshtri i penës, poeti Rifat Kukaj. Fatkeqësisht, shumë pak është regjistruar dhe ruajtur nga interpretimet e saj. Për herë të fundit, ajo u shfaq në skenë në vitin 2000, me këngën 'Për ty', e nxitur fillimisht nga këngëtari Ardit Gjebrea. Ka qenë pjesë e jurisë në 'Kënga Magjike 2005'. Aktualisht punon si këshilltare e lartë për muzikë në Radio Kosovë dhe Radio Blue Sky.

Disa ditë më parë, me rastin e pranimit të dekoratës 'Artiste e merituar' nga Presidenti i Kosovës, z. Fatmir Sejdiu, legjenda e gjallë e muzikës shqiptare znj. Nexhmie Pagarusha, shprehu modestinë e saj, duke thënë se ndihej e prekur sepse ka shumë artistë që e kanë merituar këtë dekorim. Kjo ceremoni dhe një varg aktivitetesh të tjera që do të mbahen këtyre ditëve për nder të mbretëreshës së muzikës shqipe, po bëhen në prag të datëlindjes së 77-të të saj.

Siç edhe është thënë, ajo është pjesë e identitetit të ri kosovar dhe një gjurmë e pashlyeshme në kulturën shqiptare në përgjithësi. Meqë është e pamundshme që me pak fjalë të përshkruhet bukuria e artit që ka kultivuar ajo, në përmbyllje të këtij shkrimi, ne i urojmë asaj datëlindjen dhe i urojmë, gjithashtu, një pleqëri të qetë dhe me plot shëndet. Gjithsesi, ne jemi mirënjohës dhe krenarë me veprimtarinë e saj të bujshme që ka lënë pas. Vepra e saj është kurorëzim i arritjeve dhe aspiratave të një artisti. Zëri i saj kumbon ende i freskët dhe i bukur edhe në ditët tona. ■



Lajme nga kultura

Ndërron datën Video festi



Video fest ka ndërruar datën e mbajtjes nga 10 në 31 maj. Kjo u bë e ditur në web faqen e këtij evenimenti. Edhe kësaj radhe organizatori Eroll Belegu, së bashku me bashkëpunëtorët e tij: institutin për kulturë dhe sport INKUS dhe KTV, do të organizojnë këtë ngjarje kulturore. Kohëve të fundit janë duke u realizuar videoklipe të shumta nga këngëtarët shqiptarë, ashtu siç ka qenë edhe gjatë tërë vitit. Klipet janë realizuar nga produksione të ndryshme, si nga Kosova, Shqipëria dhe Maqedonia. Por produksioni që kohëve të fundit është më i zgjedhuri nga artistët e këngës shqipe është ENTERMEDIA. Në videofest jepen çmime për kategori të ndryshme si videospoti më i mirë në kategorinë e femrave, videospoti më i mirë në kategorinë e meshkujve, videospoti me regjinë më të mirë, çmimi i publikut, videospoti më i mirë i vitit, e shumë çmime në kategori të shumta që kanë të bëjnë më videoklipet.

ABC, këtë muaj e pasuruar me filma

Në muajin maj, Kino ABC shënon dhjetëvjetorin e saj dhe ky muaj do të jetë i pasuruar me disa premiera, por edhe me shfaqjen e filmave më të shikuar të këtij viti në Kino ABC. "Kemi filluar në muajin maj si muaj filmi, duke pasur parasysh që më 24 maj të këtij viti do të jetë dhjetëvjetori i kino ABC dhe, në këtë pikë, në muajin maj kemi paraparë një numër filmash të zhanreve të ndryshme. Kemi filma evropianë, do të ketë edhe filma holliwoodian", - u shpreh Miradije Vllahiu, menaxhere e Kino ABC-së. Sipas Vllahiut, ky muaj ka filluar me filmin "Yuri's Day". Më datë 11 u vazhdua me një film tjetër: "Libertas", që do të ketë premierën në të njëjtën kohë me kinematë botërore.

"Më datë 24 do të shënohet përvjetori i kinemasë që do të shënohet si ditë e filmit humanitar dhe atë ditë do të shfaqet një numër filmash, të cilët kanë qenë të suksesshëm viteve të fundit. Të hollat që do të grumbullohen gjatë shfaqjeve të filmave më 24 maj, do të jepen për çështje humanitare. Kjo është tradicionale dhe bëhet që dhjetë vite me radhë", - u shpreh Vllahiu

Filmi "Yuri's Day" ka për temë një këngëtare të famshme operash. Kjo është Ljuba, e cila shkon për vizitë në qytetin e largët Jurijev. Duke dashur ta shesë tërë pronën e saj, ajo shfrytëzon rastin t'ia tregojë djalit të saj vendin ku ishte rritur dhe ku kishte kaluar fëmijërinë e saj. Nëna dhe djali i saj shëtisin nëpër këtë qytet të huaj për ta, kur djali humbet pa asnjë gjurmë.

Rolet kryesore: Kseniya Rappoport, Yevgeniya Kuznetsova, Sergei Sosnovsky, Roman Shmakov, Sergei Medvedev, etj. Film i regjisorit: Kirill Serebrennikov. Producent: New People Film Company; Co-Production: Rohfilm. I takon zhanrit dramë, një dramë ruso-gjermane. ■

F. Maloku

Aktorët, dikur ikona, sot në varfëri

Pozita e aktorëve të teatrit dhe të filmit nuk është përkeqësuar vetëm në aspektin e punës krijuese, por edhe të pozitës së tyre shumë të rëndë materiale

Aktorët e filmit dhe të teatrit dikur janë cilësuar si personalitetet më të rëndësishme, por tani ata janë në vështirësi, me prodhimtari të kufizuar dhe paga të ulëta. Njëra prej aktoreve më të njohura në Kosovë, Safete Rugova, thotë se statusi që kanë aktorët sot është "i turpshëm"."Pozita dhe shpërblimi i aktorëve sot është i mjerueshëm" – shprehet ajo."Është e turpshme sepse arti, megjithatë është gjëja më e bukur dhe aktrimi profesioni më i bukur, prandaj edhe kemi ndenjur në teatër për gjithë këto vite". Zonja Rugova thotë se ka shpresuar që me kalimin e viteve diçka do të ndryshojë, por sipas saj duket se gjërat po shkojnë gjithnjë e më keq. Kosova aktualisht ka tre teatro profesioniste dhe po kaq eksperimentalë, një shtëpi filmike dhe një qendër të kinematografisë, por prodhimi i tyre është në shkallën më të ulët të mundshme. Ndërsa teatrot mund të thuhet se brenda vitit i vendosin në skenë një ose dy premiera, shtëpitë filmike ka vite që mezi e mbajnë veten pa prodhuar asnjë film. Në fakt, kjo ka bërë që aktorët në Kosovë të mos jenë as të angazhuar dhe statusi i tyre të bjerë nën nivelin që do të duhej të ishte. Aktori i Teatrit Profesionist të Gjakovës, Jahja Shehu, thotë se kriza e përgjithshme e shoqërisë nuk ka lënë pa prekur as aktorët. "Aktori në sytë e publikut ishte si një ikonë, mirëpo aktori sot po e përjeton në mënyrën më të keqe dhe më të paimagjinueshme veprimtarinë e tij si një ndër krijuesit më të rëndësishëm të popullit dhe të kombit," – shprehet Shehu. Pozita e aktorëve të teatrit dhe të filmit nuk është përkeqësuar vetëm në aspektin e punës krijuese, por edhe të pozitës së tyre shumë të rëndë materiale. Zonja Rugova thotë se pagat e aktorëve janë shumë të vogla. "Tashmë jam afër pensionit dhe e di se pensioni do të jetë akoma më keq" - thotë ajo. Aktori nga Gjakova, Jahja Shehu thotë se ka ndodhur shpesh që përfaqësuesit e pushtetit të marrin pjesë në prerjen e shiritave për projekte të ndryshme, por jo edhe të projekteve të teatrove të Kosovës. Kjo, sipas tij, shpjegon peshën shumë të vogël të teatrit dhe të njerëzve të tij. "Ne jemi vetë dëshmitarë se asnjë shirit i ndonjë shfaqjeje nuk është prerë, ndërkohë që u prenë bukur shumë shirita të rrugëve", - thotë ai. "Përderisa nuk ndërron mendësia jonë për teatrin, për dramaturgjinë, kam frikë se teatri do të vazhdojë të jetojë në amulli dhe do të jetojë në krizë", - thotë Shehu. Teatri Kombëtar i Prishtinës po vazhdon të mbahet disi. Teatrot e tjerë, siç është ai i Gjakovës, i Gjilanit, ose edhe i Prizrenit, pothuajse nuk funksionojnë fare. ■



F. Maloku

"Afrika e Jugut 2010"

32 përfaqësueset më të mira në futboll do të ndeshen për të fituar Kupën e Botës, trofeun më të çmueshëm në futboll



Alban BILALLI

Prej 11 qershorit deri më 11 korrik të këtij viti, loja e futbollit do të jetë në qendër të vëmendjes së njerëzve, sepse gjatë 30 ditëve do të zhvillohet Kampionati Botëror në futboll "Afrika e Jugut 2010". Gjatë 1 muaji do të zhvillohen gjithsej 64 ndeshje në oraret ditore 13:30, 16:00 dhe 20:30. Në këtë eveniment të madh sportiv, i cili organizohet çdo të katërtin vit, dashamirët e futbollit do të kenë çfarë të shohin. Do të shohin bukuritë përrallore të Afrikës. Stadiumet më të mira në botë, të ndërtuara enkas për këtë eveniment. Do të shohin magjinë e Mesit me top, yjet e futbollit anglez, me në krye "gjeneralin" Fabio Capello, italianët që kërkojnë ta përsërisin suksesin e botërorit të fundit, brazilianët e favorizuar së bashku me spanjollët. Shkurt, prej 11 qershorit deri më 11 korrik, do të flitet vetëm për një gjë: për futbollin!

Për herë të parë në kontinentin afrikan

Ky kampionat zhvillohet për herë të parë në Afrikë. Afrika e Jugut ka fatin që ta organizojë këtë eveniment të madh sportiv. Qysh para katër vitesh, ky shtet ka filluar ndërtimin e stadiumeve, të hoteleve, rrugëve dhe infrastrukturën e nevojshme, të cilat i kanë kushtuar 65 miliardë euro. Vetëm për ndërtimin dhe renovimin e 10 stadiumeve janë shpenzuar 4.6 miliardë euro.

Ajo që është e mrekullueshme është gjendja dhe pozicioni i ndërtimit të stadiumeve, ku të gjithë që do të jenë të pranishëm do të kënaqen përveç të shikuarit futboll, edhe me pamjet dhe peizazhin e mrekullueshëm që ofron panorama afrikane. Stadiumi më i madh është "Soccer City", i cili ka një kapacitet prej 94.700 vendesh. Është një stadium ndër më të bukurit në botë. Këtu do të luhet ndeshja hapëse e Botërorit dhe, gjithashtu, edhe finalja e madhe. Ndërsa stadiumet e tjera janë relativisht të vegjël për nga kapaciteti, por nuk janë të tillë për nga vendosja dhe bukuria e tyre. Stadiumi "Green Point" është një impiant që të lë "pa frymë", siç shprehen edhe gazetarët që e kanë parë nga afër, pasi gjysma e këtij stadiumi është e vendosur në oqean dhe gjysma tjetër në tokë, me një kapacitet prej 69.070 vendesh. Një "mrekulli" tjetër është stadiumi "Nelson Mandela", i cili është i vendosur në brigjet e një liqeni dhe ka ngjashmëri të mëdha me stadiumin e Bajernit të Mynihut, "Allianz Arena", edhe pse ka një kapacitet prej vetëm 48.000 vendesh. Shumica e stadiumeve janë ndërtuar posaçërisht për këtë Botëror dhe të gjithë janë inauguruar. Por ka edhe stadiume që janë të vjetër, siç është Loftus Versfeld Stadium, i cili është ndërtuar në vitin 1906 dhe është inauguruar në vitin 2008, më një kapacitet prej 50.000 vendesh. Rruga që do të bëjnë skuadrat do të jetë në nëntë qytete dhe dhjetë stadiume, që nga Johanesburgu dhe do të vazhdojë në të gjithë qytetet, nga miniera e Rustenburgut, në detin Durban dhe Cape Town.

Por, si duket, jo çdo gjë po shkon si është parashikuar për afrikano-jugorët. Lakmia për para po rrezikon investimet miliardëshe të qeverisë afrikane. Siç raporton BBC-ja, çmimet e biletave për udhëtim me aeroplan janë trefishuar për periudhën e botërorit. Kurse akomodimi në hotel është rritur deri në 100 për qind. Shumë shikues që kanë blerë biletat me çmime të larta, deri në 650 euro, kanë paralajmëruar se nuk do të udhëtojnë për në Afrikën e Jugut, nëse çmimet nuk ulen, si për udhëtime po ashtu edhe për banim. Kështu, Afrika e Jugut rrezikon të humb miliona euro nga turistët nëse nuk ulen çmimet. Qeveria afrikane ka nisur një hetim kundër 6 kompanive ajrore që i kanë rritur çmimet e biletave të udhëtimit për periudhën e botërorit.





Të gjithë fituesit pjesëmarrës

Ky botëror pritet të jetë ndër më të mirët, ngase marrin pjesë të gjitha shtetet që e kanë fituar më parë kampionatin botëror. Brazili e ka fituar 5 herë, Italia 4 herë, Gjermania 3 herë, Uruguai 2 herë, Argjentina 2 herë, Anglia 1 herë dhe Franca 1 herë. Pjesëmarrja e të gjithë fituesve në këtë kampionat është gjë e rrallë, ngase dekadave të fundit shumë shtete të vogla kanë ngritur krye dhe kanë shënuar suksese në futboll dhe i kanë lënë në hije shtetet të cilat njihen për futboll shumë cilësor. Shembull kemi kampionatin e fundit evropian, në të cilin Anglia nuk arriti që të kualifikohet. Sllovakia është shteti i vetëm që debuton në Kampionatin Botëror.

Përveç pjesëmarrjes së të gjithë kampionëve, ky kampionat veçohet se do të ketë në përbërje futbollistët më të shtrenjtë të të gjitha kohërave, që vlejnë hiç më pak se 5.6 miliardë euro. Futbollistët më të shtrenjtë i ka Spanja, që kapin vlerën e 565 milion eurove, e ndjekur nga Brazili me 515 milion euro, Franca me 450, po aq sa Anglia, kurse futbollistët e kampionit botëror të Italisë vlejnë 400 milion euro.

Grupi G "grupi i vdekjes"

Gjatë fazës eliminatore u zhvilluan 853 ndeshje, në të gjitha konfederatat që bëjnë pjesë në FIFA, derisa prej tyre u përzgjodhën 32. Nga këto 268, ose 31 për qind e ndeshjeve u zhvilluan në Evropë. 200 skuadra morën pjesë në fazën parakualifikuese të Kampionatit Botëror 2010, duke vendosur edhe një rekord për sa i përket pjesëmarrjes. Në fazën eliminatore për "Gjermani 2006" morën pjesë 196 skuadra.

32 skuadrat pjesëmarrëse janë ndarë në 8 grupe. Grupi G, në të cilin bëjnë pjesë Brazili, Koreja e Veriut, Bregu i Fildishtë dhe Portugalia, konsiderohet si "grupi i vdekjes" ose si grupi më i vështirë. Sfida e artë e grupeve është ajo mes Brazilit dhe Portugalisë, ku vlera e futbollistëve në fushë do të jetë rreth 895 milionë euro, ndërsa ndeshja ndërmjet Brazilit dhe Bregut të Fildishtë do zbresë në fushë futbollistë që kanë një vlerë të përbashkët prej 695 milionë eurosh.

Italia, fituese e Botërorit të fundit, do të ketë përballë në grupin F: Paraguain, Zelandën e Re dhe Sllovakinë. Italia është favorit në grup dhe pritet ta kalojë pa problem grupin, por nuk duhen harruar befasitë, sidomos ajo e Botërorit para 8 vitesh që u mbajt në Koren e Jugut dhe Japoni, kur Franca si kampion botëror nuk mundi ta kalonte grupin. Spanja që llogaritet favorit kryesor për ta fituar botërorin do të ketë përballë Zvicrën, Hondurasin dhe Kilin. Anglia e Fabio Capellos do ta zhvillojë ndeshjen e parë kundër SHBA-s, dhe llogaritet favorit në këtë ndeshje dhe në tërë grupin, ku bëjnë pjesë edhe Algjeria dhe Sllovenia.

Përplasja e skuadrave pas grupeve

Skuadra që renditet e para dhe dyta në grup do të kalojnë në çerekfinale. Skuadra që përfundon e para në grupin A do të ndeshet me të dytën e grupit B, kurse e dyta e grupit A me të parën e grupit B. Kështu ndodh edhe me grupet C-D, E-F dhe G-H.

Spanja favorit

Nga ekspertët më të mëdhenj të futbollit dhe kompanitë më të mëdha të basteve, kampioni i Evropës, Spanja, është përzgjedhur si favoriti kryesor për ta fituar Kampionatin Botëror në Afrikën e Jugut. Pas saj renditet Brazili, Anglia, Argjentina, Gjermania, kurse Italia, kampione e botës në fuqi, renditet e gjashta sipas parashikimeve.

Shpërblimet

FIFA për këtë Kampionat ka rritur çmimet 61 % për dallim nga Kampionati i fundit. Në Kampionatin e fundit, të mbajtur në Gjermani më 2006, FIFA kishte ndarë 261 milionë dollarë, kurse për këtë Kampionat ajo ka ndarë 420 milionë dollarë. Fituesi i Kampionatit Botëror në Afrikën e Jugut, do të shpërblehet me 30 milionë dollarë. Vendi i dytë do të marrë 24 milionë dollarë, po aq sa do të marrë edhe vendi i tretë. Vendi i katërt 20 milionë dollarë. Secila përfaqësuese do të marrë nga 1 milion dollar për shpenzimet e akomodimit. Po ashtu, FIFA ka ndarë edhe 40 milionë dollarë për klubet që kanë futbollistët në këtë kampionat. Një futbollist do të paguhet 1600 dollarë në ditë.

Futbollistët shqiptarë në Botëror

Në këtë Botëror pritet që të luajnë edhe disa futbollistë shqiptarë. Duket se vendin e sigurt për pjesëmarrje në këtë kampionat e kanë Valon Behrami dhe Xherdan Shaqiri me përfaqësuesen e Zvicrës. Kandidat për një vend janë edhe Albert Bunjaku dhe Blerim Xhemajli, po ashtu me përfaqësuesen e Zvicrës. ■

Vëllezërit me profesion dhe besim të njëjtë







Vëllezërit Kolo Ture, Jaja Ture dhe Ibrahim Ture, nga Bregu i Fildishtë, e kanë të njëjtë si profesionin, ashtu edhe besimin në Zot. Ata janë futbollistë shumë cilësorë dhe të njohur. Ata janë muslimanë që besojnë në Një Zot të Vetëm. Falin namazin, agjërojnë Ramazanin, si edhe kryejnë shumë rite të tjera islame. Por ata nuk e kanë të njëjtë pozitën në fushën ku luajnë. Kolo Ture luan si mbrojtës, Jaja luan si mesfushor, kurse Ibrahimi luan si sulmues.

Kolo Ture, vëllai i madh, mbrojtës i qendrës te klubi anglez Mancester City, është një praktikues i devotshëm i Islamit. Ai, të gjitha sukseset, ia dedikon Islamit. "Unë jam ai që jam për shkak të fesë sime. Islami ka ndryshuar jetën time dhe unë jam vërtet i lumtur që jam musliman",- është shprehur Kolo Ture. Kolo Ture jeton me gruan e tij Awo dhe dy fëmijët: djalin Yassin dhe vajzën Sania, në qytetin e Mançesterit.

Kolo Ture e nisi karrierën prej futbollisti në vitin 2000 në Bregun e Fildishtë, te klubi ASEC Mimosas. Pas dy vitesh qëndrimi te ky klub, ai kaloi në Premier Ligën angleze te klubi i Arsenalit, ku qëndroi plot shtatë vite, deri në vitin 2009, kur iu bashkëngjit klubit tjetër anglez Mancester City, duke nënshkruar kontratë 4 vjeçare.

Kolo Ture është i njohur për shpejtësinë dhe forcën në duele me sulmuesit. Ai ka aftësi të mira për të shënuar gola me kokë. Edhe pse luan në pozitën e mbrojtësit, pozitë kjo që e detyron të përballet me sulmues dhe mesfushorë të ndryshëm, ai është shembull për të tjerët se si të ndalet kundërshtari pa faull dhe është ndër lojtarët që më së paku ndëshkohet me kartonë.

Jaja Ture është dy vite më i ri se Kolo Ture. Për dallim nga Kolo që luan mbrojtës, Jaja luan mesfushor te gjiganti katalonas Barcelona. Edhe Jaja është musliman i devotshëm. Ai kryen namazin, agjëron Ramazanin, lexon Kur'an në kohën e lirë, si edhe ndihmon fëmijët e varfër në vendlindjen e tij. Jaja e nisi karrierën prej futbollisti në vitin 2000, duke luajtur në klubin ASEC Abidjan. Pas dy vitesh, u transferua në Belgjikë, te klubi Beveren. Pastaj kaloi në Ukrainë, te Shahtar Donjektcs. Më 2005, ai u transferua në Greqi. Më pas në Francë te Monaco, kurse në vitin 2007 ai nënshkroi kontratë 4 vjeçare me gjigantin spanjoll, Barcelonën. Njihet për mbajtjen e topit, pasimin e saktë, si dhe goditjen e fortë.

Ibrahim Ture është vëllai më i vogël. Ai luan në pozitën e sulmuesit. Është më pak i njohur se dy vëllezërit e tij, por e pret një e ardhme e ndritur në futboll. Ai ka luajtur në Ukrainë, te Shahtar Donjects, si dhe në Francë në klubin e Nicës, kurse tani është pjesë e klubit AL-Ittihad në Premier Ligën Siriane.

Kolo Ture dhe Jaja Ture konsiderohen truri i përfaqësueses së Bregut të Fildishtë në futboll. Ata do të jenë pjesëmarrës në Kampionatin botëror "Afrika e Jugut 2010" që do të fillojë më 11 qershor. ■

Autor: Agim Gashi	GJYMTIM	BANOR I NJË KRAHINE SHQIPTARE	BOTIMET E SËRISHME	EMNAKU I AMIRES	MUZIKTARI DARDAN, KUKUZELI	HAPËSIRA QIELLORE	NOCION ZGJEDHJESH	DUKAT		FOSFORI	PYETJA PUBLIKA E SHUMË NJERËZVE PËR DIÇKA	RESPEKTET	VËNIE E DATËS	ALABAMA
QYTETI NË FOTO *kryeqytet evropian*									LLOJ ARIU KINEZ / ELEMENT KIMIK					
KRJIUESI I ANIMACIONEVE										NDËRPRES / MIRË, BËN				
TËRËSI MINISTRASH, QEVERI								FISHEKZJARRI / RELIGJION						
"HYJ" I DASHURISË TE ROMAKËT					FABRIKË PASTRIMI PËR NAFTËN / METRI									ZEMËRIMI
TAKSA							BOTIMI							
ILIRIANI (dim.)				TOKËZIMET E AEROPLANËVE						ADEM MIKULLOVCI			REPUBLIKA / QË KA BAZA	
NËNË,ËEMË										EMIRATET E BASHKUARA ARABE / AJO QË UDHËHEQ NJË SHKOLLË				
PJESË E LOJËS SË TENISIT / BANORI I NJË QYTETI SHQIPTAR										DIGITAL TELEVISION ADAPTER				VENDËS, ANËS
ENERGJIA		TETOVA / KËRCIMTARJA E BALETIT								RADIUSI		ZARA / JO FETARE		
LIBANI			SHKRONJA E 25-të / MOSHA E RE							SHKRIMTARI, PELIN				
ILAÇI										PJESË E KËMISHËS				
VCARIANT I EMRIT HALIM										TITANI			SEKONDA / NË ATË VEND	
VIT, MOT					FËMIJË I URTË	SHTET AZIATIK	XHINGIS . . .		I BIMËVE	NJËSI E VJETËR PESHE / KLUBI				DËSHTIM SHTATZANIE
QË I MUNGON RITMI								LLOJ KAPELE / MADJE						
NATIONAL INSURANCE ACADEMY				E NJË VENDI ISLAM / EMËR F. ISLAME								JOTABAJTI / TRANSTIRETINI		
KyÇ			NJËZËRI / LL.P.										OKSIGJENI / PËREMËR VETOR	
LLOJ SHAMIE							RREMTAR / FRANCA							
INDIA		PJESË E LARGËT NGA QENDRA E QYTETIT									CEREMONI			